


Dhjetë vjet më parë, në Mexico City, në shtëpinë ku ai jetonte me të shoqen Mercedes, vdiq Gabriel García Márquez. Në një intervistë të vitit 1987, kur gazetari e pyet nëse ka frikë nga vdekja, Márquez përgjigjet: "Nga vdekja jo, nga të vdekurit po. Më shqetëson, si shkrimtar, që ngjarja më e rëndësishme në jetën time, vdekja, është e vetmja për të cilën nuk do të mund të shkruaj kurrë." Çfarë magjie e pabesueshme do të ishte të lexoje për të.

## DHJETË VJET VETMI: bota letrare një dekadë pa G. G. Marquez



(fq. 22)

### IN MEMORIAM LAMTUMIRË, XHEVAT BEQARAJ

Nga Klara Kodra

(fq. 4)

Ushua edhe një yll nga yllësia e shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë, poeti mallakastriot Xhevat Beqaraj, liriku i ëmbël dhe fin që në vargje vizatonte tablo të shumëngjyrëshme të natyrës, duke i parë ato me syrin e mrekulluar dhe naiv të fëmijëve,

### SHËNIME MBI LIBRAT

Enciklopedia naimiane: Gjuha e Naimit (Përgatiti: Mehmet Gëzhilli), Akademia e Shkencave e Shqipërisë

#### GJUHA E VEPRËS SË NAIM FRASHËRIT

Nga Begzat Baliu

(fq. 6)

Le të thuhet së fundi, se botimi i këtij korpusi paraqet një vlerë të madhe shkencore me interes shumëplanësh për lexuesit, prandaj presim që Akademitë tona ta përkrahin kurorëzimin e saj sa më parë, jo vetëm për Naim Frashërin po edhe për rilindësit e tjerë.

#### GJOVALIN SHKURTAJ, GUHËTARI DIALEKTOLOG - LIGJËRUES NË AKADEMINË E ARTEVE PËR TEORINË E DRAMËS

nga Tefë Topalli

(fq. 7)


Gjuhëtarë si prof. Gj. Shkurtaj kanë tashmë një bibliotekë publikimesh, ku libri *Teori drame* do të jetë përsëri tërheqës për t'u lexuar dhe me përfitime letrare e kulturore...

#### AGIM GJAKOVA DHE DYKOHËSIA E SHKRIMIT LETRAR

Nga Behar Gjoka

(fq. 10)

Fati i njeriut është i lidhur mgushtësisht me aktet që kryen në jetë, përkundër fati i shkrimtarit, mbruhet dhe jeton në veprat e shkruara.



### FATMIR TOÇI: Mungesa e një historie të plotë të arbëreshëve, më nxiti të shkruaj këtë libër

Bisedoi Andreas Dushi

Prej gati tri dekadash, jam shpesh i pranishëm mes arbëreshëve për arsytet nga më të ndryshmet, gjithnjë e më tepër si i shtëpisë, si njëri prej tyre dhe nga viti në vit shoh gjithnjë e më pak njerëz që flasin arbërisht midis tyre, shumica të moshuar, të cilët janë rralluar shumë gjatë kësaj periudhe. Brezi i ri, nxënësit e paket të shkollave...

(fq. 2)

Me rastin e dhënies së çmimit "Lumo Skëndo"

#### DASHURIA E MIDHAT FRASHËRIT PËR LIBRIN

Nga Uran Butka

(fq. 5)

Në intervistën e parë televizive që nga sulmi, shkrimtari tregon sesi agresori ishte "gjëja e fundit që syri im i djathtë do të shihte ndonjëherë"

#### "TI PRA QENKE! JA, JE KËTU!": SALMAN RUSHDIE PËRSHKRUAN ÇASTIN E SULMIT

Nga Ella Creamer

(fq. 21)



### BIBLIOTEKË

- Koçi Petriti (fq. 14)  
*Bredh brenga e natës*
- Adelinë Selmani (fq. 11)  
*Lufta*
- Faruk Myrtaj (fq. 12)  
*Ajo ... e Bermudës*
- Dinos Siotis (fq. 13)  
*Kaos*  
(përktheu Ardita Jatru)
- Feride Papeleka (fq. 16)  
*Vetëvrasja e hënës*
- Bruno Alfred Döblin (fq. 18)  
*Lënësja dhe vdekja*  
(Përktheu Elda Gjana Boriçi)
- Pär Lagerkvist (fq. 19)  
*Unë dhe babai*  
(Përktheu Qerim Raqi)
- Arben Meksi (fq. 15)  
*Karikatura e të shtunës*

Në Panairin e Librit Shqip 2024, në SHBA

#### GJUHA – ATDHEUI SHKRIMTARIT

Nga Visar Zhiti

(fq. 20)

**A.D.:** Kur botuat vështrimin historiko-kulturor për arbëreshët me titull "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit", natyrshëm m'u ndërlihd me krahinën e Shën Kozmasë në Kalabri ku, sikundër ju tregoni, që në vitin 1543, një nga mbiemrat më të njohur të zonës ishte edhe Toçi. Nuk e di për sot, por deri në LIIB, personalitete të këtij mbiemri si Francesco Saverio Tocci, Guglielmo Tocci apo edhe Terenzio Tocci luanin një rol në dinamikën politike të brendshme e të jashtme. Ju a keni ndonjë lidhje personale me këtë familje, si p.sh., ajo të jetë shpërngulur nga vendi juaj i origjinës, apo është një rastësi? Pra, a keni ndjerë një lloj thirrjeje nga mbiemri i përbashkët për t'u marrë me një studim kaq të gjerë, që përplotësohet në vëllimin e sapobotuar "Arbëreshët, shqiptarët e Italisë"?

**F.T.:** Toçi (it. Tocci) është mbiemër shumë i përhapur, pothuaj në të gjitha vendbanimet arbëreshe, veçanërisht në Kalabri dhe Sicili, që, çuditërisht, në të shumtën e rasteve, nuk gjejnë lidhje me njëri-tjetrin. Është një tezë e pavërtetuar për prejardhjen e tyre, ndoshta nga Jugu i Arbërisë, arvanitët e Peloponezitet apo ishujt e Jonit në Greqi.

Prof. Matteo Mandalà më ka thënë gjatë një bisede me këtë temë se mendohet që pjesa më e madhe e banorëve të Horës së Arbëreshëve (it. Piana degli Albanesi) kanë ardhur në Sicili nga zona e Himarës, e cila në shek. XV-XVI ishte një krahinë bashkë me Kurveleshin, ku bën pjesë edhe fshati im i origjinës Kuçi, ku mbiemri Toçi është i përhapur. Madje në Horë një nga lagjet më të vjetra, vendosur në një grykë mali si në honet e Himarës, quhet edhe sot e kësaj ditë Himara. Por nuk kam gjetur burime dokumentare bindëse. Gjithsesi, koincidenca e mbiemrit të familjes sime në shumë vendbanime arbëreshe në Itali ka krijuar që në fillim një afinitet të këndshëm me ta, duke më quajtur si një njeri të tyre.

Kam vizituar vendbanimet arbëreshe në Kalabri që pas viteve '90 dhe kam mbetur i mrekulluar nga mikpritja dhe dashuria e tyre, tingëllimi i arbërishtes arkaike, si në kohën e Skënderbeut, riti bizantin dhe liturgjia në greqishten e vjetër apo në arbërishte, veshjet mahnitëse tradicionale dhe Valljet tunduese plot ritëm e gjallëri, kuzhina tipike dhe hareja e zhurmshme e festave që vijnë nga lashtësia... Aty kam parë se sa pak dinim në për historinë dhe jetën e arbëreshëve tanë, një imazh të veshur me mjegull, të mbushur me mite e legjenda për shkak të kontakteve të pakta dhe mungesës e bashkëpunimit e shkëmbimeve të ndërsjella.

Dëshira për t'u bërë shqiptarëve sa më të njohur këtë botë shqiptare, të shkëputur dhunshëm nga trangu për 20 breza më çoi tek ideja për të shkruar këtë libër. M'u duk se do të ishte një punë e lehtë, por m'u deshën mbi 15 vjet për të vizituar mbi 500 vendbanime ekzistuese apo dikur arbëreshe, të shfletuara dhjetëra mijëra faqe, të takuara shumë personalitete të fushës, si profesorët Francesco Altamari, Matteo Mandalà, Pëllumb Xhufi, studiuesin e rëndësishëm dhe rrëmuesin e arkivave Italo Sarro etj. dhe mbi 5 vjet për të shkruar e rishkruar disa herë dy librat për arbëreshët.

**A.D.:** Vëllimi i fundit karakterizohet nga një qasje skrupuloze shkencore, me citime dhe referime të sakta nga burime të besueshme e në të njëjtën kohë, së brendshmi ruan strukturën e një veprë që

# FATMIR TOÇI:

## Mungesa e një historie të plotë të arbëreshëve, më nxiti të shkruaj këtë libër

Bisedoi Andreas Dushi

nuk mëton t'i ofrohet vetëm studiuesve të tjerë, por grish një lexues më të gjerë drejt njohjes së të gjitha përmasave që i duhen për ngulmimet arbëreshe në Itali. Ka qenë kjo një zgjedhje e qëllimtë? Dhe, gjatë procesit të përgatitjes së librit, cilin lexues kishit parasysh?

**F.T.:** Ekziston një bibliografi shumë e pasur me objekt arbëreshët të Italisë, për jetën e tyre, historinë e vendosjes në Itali, veçoritë e kulturës, folklorit, letërsisë, veshjeve, besimit fetar etj. Më e pasur dhe intensive rezultoi kjo veprimtari në gjysmën e dytë të shek.XIX deri në fillimet e Luftës I Botërore, dhe pas Luftës II Botërore deri në ditët tona. Megjithatë, unë nuk kam mundur të gjej kënaqshëm

një histori të plotë të arbëreshëve nga fillimet e vendosjes së tyre në krahinat e ndryshme italiane, kryesisht në Jug e deri në ditët tona. Kjo ka qenë një për mua për të hartuar një vepër përmbledhëse, të shtrirë në mbi 5 shekuj, duke filluar me kalvarin e vuajtjeve dhe odisenë e shpërnguljes së tyre përtej brigjeve të Adriatikut e Jonit, në një vend të huaj me gjuhë e zakone të ndryshme, në fillim krejt të panjohura; për rreziqet e shumta që kanë kaluar në përballjen me elementët e natyrës dhe me vendasit; për përpjekjet e tyre për t'u përshtatur me mjedisin shoqëror në atdheun e ri; për ngulimet në tërësinë të tyre dhe për ato që u mbijetuan furtunave të kohës; për gjendjen e tyre ekonomike, kulturore, arsimore etj.




Dua të theksoj se libri im studimor ka karakter të theksuar informues me një vështrim përmbledhës e të përgjithshëm mbi historinë pesëqindvjeçare të arbëreshëve në aspektet e saj kryesore, duke nisur nga aventura tragjike e kalimit të tyre nga Arbëria drejt Italisë e deri në ditët tona, shpërndarja e ngulimeve arbëreshe dhe kostitimi fetar i tyre.

Në fakt, botimet e studimeve tradicionale të mirëfillta shkencore i drejtohen një lexuesi të kufizuar të fushave përkatëse, si studiues, analistë, kritikë, edhe studentët të fushës me një gjuhë që shpesh është e pakuptueshme dhe jotërheqëse për lexuesin e gjerë. E shoh si tendencë në botimet e këtij fillimshkulli mënyrën e shkrimit për komunikimin me një lexues më të gjerë, pa e ulur nivelin shkencor të veprave që studiuesit ofrojnë. Kjo i ka dhënë më shumë lexues veprave të tyre. Nuk më duket i rastësishëm kthimi i interesit të lexuesve drejt veprave historike të shkruara në mënyrë më divulgative, pa u larguar aspak nga aparati i tyre shkencor dhe pa e ulur nivelin e tyre studimor. Nga autorët historianë më tipikë, shumë të dashur për mua, që kanë shkruar veprat e tyre duke iu drejtuar një lexuesi sa më të gjerë do të përmendja Kristo Frashërin, vepra e të cilit është shumë e qartë, e kuptueshme dhe, pa dyshim shumë e saktë shkencërisht, për të përcjellë te lexuesi atë për të cilën shkruan. Sot do të veçoja me kënaqësi prof. Pëllumb Xhufin, i cili është edhe një personazh publik mjaft interesant e karizmatik për temat që trajton, po ashtu edhe disa të tjerë si prof. Arben Puto, historiani Paskal Milo, prof. Irakli Koçollari, Ilir Ikonimi, studiuesi arbëresh shumë i rëndësishëm Italo Sarro e shumë të tjerë. Nuk është e rastësishme që veprat e tyre, si dhe shumë përkthime të spikatura historike, të cilat botohen e ribotohen vazhdimisht, janë nga veprat më të kërkuara në tregun e librit shqip.

Këtë kam parasysh dhe jam përpjekur të realizoj në dy veprat e shkruara për arbëreshët, të jem i qartë para lexuesit për sa shkruaj, ta ofroj materialin historik apo informativ ashtu siç do ta doja unë po të isha në rolin e lexuesit. Nuk e di sa e kam arrirë, lexuesi i interesuar do ta thotë.

**A.D.:** Paçka serigoroziteti metodologjik nuk ju lejon sentimentalizma mbi tematika nacionale, krijohet përshtypja se si rezultat i kërkimeve tuaja, del se më së pari gjuha e më pas besimi katolik i rritit bizantin kanë ndihmuar më së shumti në mbrojtjen e identitetit të arbëreshëve. Kam të drejtë, apo është një perceptim i gabuar?

**F.T.:** Pa dyshim që gjuha është elementi më specifik dhe më i dukshëm i identitetit, ndërsa shprehja e besimit veshja shpirtërore e tij, aq më tepër në një vend të krishterë si Italia, ku në thelb



besimi është pak a shumë i njëjtë, por i shfaqur dhe i praktikuar në mënyra të ndryshme. Pa dyshim se ushtrimi dhe ruajtja e këtyre dy elementëve thelbësorë të identitetit, bashkë me elementë të tjerë kulturorë, tradicionalë, zakonorë, mënyrën e jetesës etj. ruajtën të pacenuar identitetin arbëresh dhe e trashëguan brez pas brezi, si elementin dallues nga vendasit.

Kanë qenë edhe disa faktorë të tjerë historiko-shoqërorë që kanë ndihmuar në mbrojtjen e identitetit të arbëreshëve, ku nga më të rëndësishmit nënvizojmë vendosjen e tyre në vende të izoluar, larg qendrave të mëdha të banuara, me mungesë të theksuar të infrastrukturës, komunikim të pakët me vendasit, jeta në familje të mëdha patriarkale etj. Në kohën e sotme të zhvillimeve të vrullshme ekonomiko-shoqërore, infrastrukurore dhe politikave të egra globalizuese, emigrimit masiv drejt veriut të Italisë apo vendet e tjera, nevoja për shkollim cilësor të brezit të ri etj. kanë sjellë fenomenin e braktisjes nga vendbanimet arbëreshe, e si rrjedhojë mospërdorimin e gjuhës e bjerrjen e saj, duke rrezikuar humbjen e një prej elementëve themelorë të identitetit arbëror. Kështu që perceptimi juaj është shumë i drejtë, por në kohën e sotme shpërbërja e familjes, emigracioni për shkaqe ekonomike e mbijetese etj., kanë sjellë braktisjen masive të vendeve ku historikisht jetojnë arbëreshët duke hequr bazën sociale të elementëve që bëjnë të mundur ruajtjen e identitetit.

**A.D.:** Harta në hyrje të librit ku paraqiten ngulmimet arbëreshe tregon diçka tejet interesante: Në krahinat veriore të Italisë kanë mbetur vetëm gjurmë të ngulmimeve, ndërsa në ato të jugut, ngulmimet vijnë ende dhe sot, duke ruajtur gjithë tiparet e tyre. Pse mendoni të ketë ndodhur kjo?

**F.T.:** Diaspora më e madhe arbre në fillimet e saj në shek. XIV-XVI ka qenë ajo në veri të Italisë, kryesisht në Republikën e Venedikut dhe zotërimet e saj përgjatë brigjeve veriore të Adriatikut, duke filluar që nga shek. XIV. Por edhe asimilimi i të ardhurve nga Arbëria u krye më shpejt në këto zona, për shkak se emigracioni ishte kryesisht nga vendet e veriut të Arbërisë, Shkodra, Lezha, Ulqini dhe territoret malore rreth tyre. Ato i përkisnin besimit të krishterë katolik dhe asimilimi i tyre brenda të njëjtit besim fetar ishte një proces që kryhej më natyrisht. Nga ana tjetër, pjesa territoriale e Arbërisë së Mesme, Jugore dhe e Greqisë, ku jetonte një pjesë e madhe e arvanitëve ishte përballë Italisë së Jugut, pjesë e Mbretërisë së Napolit, e cila kishte qenë në marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimi me Skënderbeun në të gjallë të tij, por që pas vdekjes së heroit tonë kombëtar gjetën strehë masivisht në krahinat dhe provincat e mbretërisë, si Kapitanata (Molize dhe pjesa veriore e Puljes), Bazilikata, Pulje, Kalabri, Sicili etj. Duhet shënuar këtu edhe interesi i ndërsjellë i ikanakëve për shkak të rrezikut turk që ishte evident dhe interesave të feodalëve dhe klerit katolik në Mbretërinë e Napolit, vendi i të cilëve ishte prej dekadash në krizë demografike për shkak të luftërave, epidemive shfarosëse, tërmeteve shkatërruese etj., duke ulur ndjeshëm forcat prodhuese të afta për punë dhe duke e kthyer territorin në një hapësirë djerrë e pa produktivitet.



Pikturë nga Pashk Pervathi

**A.D.:** Është folur shumë për rolin e arbëreshëve gjatë Rilindjes Kombëtare. Nga De Rada te Serembe; nga Lorecchio te Tocci në fundin e LIIB, e sa e sa të tjerë luajtën rol të rëndësishëm në përfundimin e idesë kombëtare te shqiptarët. Figura të shquara të lëvizjes kombëtare si: Gurakuqi, Fishta e të tjerë, në të njëjtën kohë, qenë nxënës të arbëreshëve. Pas viteve '90, përpos prof. Matteo Mandalà-së dhe prof. Francesco Altimari-t që kanë krijuar një shkollë krejt të veçantë filologjike për studimin e letërsisë shqipe e jo vetëm, si dhe pak figurave të tjera në fusha të ndryshme, lidhja mes arbërve në dy anët e Adriatikut ngjan sikur, vendeve ose është shumë e hollë, ose është shkëputur. Si e shpjgoni këtë dukuri?

**F.T.:** Përmbi pesë shekuj, për shkak të pushtimit osman të Arbërisë (më pas Shqipëri) ka pasur një mungesë pothuaj totale të komunikimit të arbërve në të dy brigjet e Adriatikut, dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore gjendja nuk ndryshoi. Në kohën e regjimit monist marrëdhënia ishte më shumë folklorike, ndërsa sot në epokën fatlume të hapjes të vendit tonë me botën marrëdhënia nuk është ajo që pritej, edhe pse komunitetet arbëreshe në Itali janë pjesë e Bashkimit Europian dhe bashkëpunimi në të gjitha fushat do të ishte me interes të ndërsjellë. Interesimi i politikës dhe i përfaqësuesve të saj në nivelet më të larta shpesh mbetet në kuadrin e qokave populiste, pa prodhuar rezultate konkrete në forcimin e marrëdhënies dhe zgjerimin e bashkëpunimit reciprok. Më rezultative është dukur në fillimet e saj, pas viteve '90 marrëdhënia e bashkëpunimi midis akademive të shkencave e instituteve në Shqipëri e Kosovë me katedrat e gjuhës shqipe të disa universiteteve në Itali (Napoli (1901), Palermo (1933), Bari (1934), "La Sapienza" në Romë (1939), Kozenca në Kalabri (1975), Salento në Leçe (1993), Venecia (2001)), ku ato më aktivet janë, pa dyshim, ajo e Kozencës dhe e Palermos, që drejtohen nga prof. Francesco Altimari dhe Matteo Mandalà, dy personalitete që janë kthyer në sisteme

referimi kur bëhet fjalë për çështjen arbëreshe. Edhe unë jam në një mendje me vërejtjen tuaj të hollë e plot delikatesë për një bashkëpunim më intensiv, i cili vitet e fundit duket më i brishtë, ndoshta për shkak të raporteve më të brishta institucionale kur bëhet fjalë për shkencën dhe punën studimore, por edhe për një rol më aktiv, të drejtpërdrejtë e konkret të strukturave shtetërore në Shqipëri për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të pakicave kombëtare apo gjuhësore kudo që ndodhen. Kjo do të inkurajonte një rol dhe lëvizje më aktive e të organizuar edhe nga komunitetet arbëreshe në Itali.

**A.D.:** Duket sikur një punë e tillë e është besuar një stafi të madh njerëzish me detyra të përcaktuara, nga mbledhja e të dhënave, përpunimi i tyre, vendosja sipas metodologjisë së ndjekur, radhitja në rendin e duhur e në fund, përgatitja për shtyp. Ndërkohë ju keni punuar i vetëm... Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha me të cilat jeni përballur gjatë punës për përgatitjen e kësaj vepre?

**F.T.:** Pa dyshim që ka qenë një punë e shtrirë në kohë dhe relativisht e gjatë për mbledhjen e materialeve, kërkimin në biblioteka të literaturës dhe materialeve të tjera të nevojshme, kontakteve me njerëz të të gjitha niveleve, vizitat pothuaj në të gjitha vendbanimet arbëreshe objekt i këtij libri, si dhe shërbimi i fotografimit, të cilin duhej, në pjesën më të madhe, ta realizoja vetë. Por, nga ana tjetër, kjo punë e madhe, që kërkonte edhe shumë kohë, më ka bërë të prek nga afër pothuaj çdo detaj të botës arbëreshe në Itali, në vendbanimet që sot ekzistojnë dhe njihen si tilla edhe zyrtarisht, por edhe në ato që janë asimiluar apo shuar përgjatë këtyre më shumë se pesë shekujve. Një punë e gjatë, por edhe e mundimshme, po të mendosh se shumica e vendbanimeve arbëreshe janë apo ishin të vendosura në vende me terren të vështirë, në zona malore, me infrastrukturë të dëmtuar, larg qendrave të mëdha urbane, dhe me një shtrirje më shumë se 1.000 kilometra, sikur të llogaritim udhëtimet vetëm nga Molize në Sicili, ku ndodhen pjesa më e madhe e tyre, pa llogaritur edhe

inkursionet që kam marrë në pjesën veriore të Italisë, nga krahina e Venetos në Piemonte, duke zbritur përsëri në Abruc. Gjithsesi, ky impenjim më ka dhënë një ndjesi kënaqësie të pafund dhe, besoj se jam nga të paktët, në mos i vetmi shqiptar që ka mundur të vizitojë, të shohë e të prekë nga afër të gjitha vendbanimet që janë apo dikur ishin arbëreshe përgjatë më shumë se 5 shekujve.

**A.D.:** Në shënimin e tij për librin, prof. Neritan Ceka shkruan ndër të tjera se përcjellë njëkohësisht ndjesitë dhe shqetësimet e një udhëtari të palodhur të katundeve arbëreshe. E di se është e padrejtë t'ju kërkoj për aq kohë sa ju i keni shkruar në libër gjerë e gjatë për secilin ngulmim, por gjithsesi po e bëj: A mund t'i përmbledhni në disa "kategori" kryesore këto ndjesi dhe shqetësime?

**F.T.:** Prof. Neritan Ceka është një njohës i mirë i botës arbëreshe. Përpos studiues dhe njohës profesionist i historisë në tërësi, asaj të lashtësisë në veçanti, ai është nga diplomatët që mbajti lidhje të ngushta me komunitetet arbëreshe dhe është një nga njerëzit më të njohur e më të dashur midis tyre. Ka ndodhur që bashkë të kemi qenë disa herë në festat e takimet me arbëreshët, si dhe në debatet që organizohen shpesh për problemet e identitetit dhe rrezikut të bjerrjes së gjuhës dhe kësaj trashëgimie unike kulturore europiane. Ai e ka shumë të qartë kur flet për ndjesi e shqetësime, ku pa dyshim kryefjala është rreziku i humbjes së gjuhës arbëreshe për shkak të shpopullimit të vendbanimeve arbëreshe.

Unë, prej gati tri dekadash, jam shpesh i pranishëm mes arbëreshëve për arsyt nga më të ndryshmet, gjithnjë e më tepër si i shtëpisë, si njëri prej tyre dhe nga viti në vit shoh gjithnjë e më pak njerëz që flasin arbërisht midis tyre, shumica të moshuar, të cilët janë rralluar shumë gjatë kësaj periudhe. Brezi i ri, nxënësit e pakët të shkollave me program mësimor italian nuk e flasin shqipen e vjetër, dhe as ka programe apo përpjekje për të mësuar arbërisht apo shqipen e sotme, gjuhën zyrtare të shqiptarëve. Besoj se ka të drejtë prof. Ceka kur vëren ndjesi dhe shqetësime tek unë apo edhe në arbëreshë të tjerë, kur arbërishtja po shuhet ngadalë e në një proces pa kthim, ndërsa përpjekje nuk ka as për të mësuar shqipen, goftë si gjuhë e dytë, në shkollat italiane ku fëmijët e arbëreshëve mësojnë në gjuhën italiane...

**A.D.:** Shtëpia botuese "Toena", e themeluar nga ju, ka botuar një prej zërave kryesorë të letërsisë arbëreshe, Carmine Abate-n e në të njëjtën kohë, edhe Seremben apo Gavril Darën. Nisur nga ky fakt, si dhe nga njohja e antropologjisë arbëreshe, besoni se letërsia e arbëreshëve sot mund të shihet si një vijim i asaj të fundit të shek. XIX, apo është diçka tjetër, e përfshirë, për shkak të globalizimit, në një hapësirë shumë më të gjerë se ajo e arbëreshëve?

**F.T.:** Letërsia arbëreshe që në shek. XVI-XVIII ka rëndësi jo vetëm si etapa e parë e letërsisë shqiptare, por edhe sepse ajo vuri bazat e shkrimit shqip. Që nga "E Mbuame e Krështerë" (1592) e Lekë Matrangës (1592), te "Ghiella e S. Mëriis Virghiër" (1762) e Jul Varibobës, që shënoi kalimin drejt letërsisë artistike, shpërtheu

(Vijon në faqen 4)

(Vijon nga faqja 5)

në shek. XIX një plejadë e ndritur intelektualësh e krijuesish arbëreshë, si: Gjergj Guxeta, Pal Maria Parino e Nikollë Keta, më pas Xhuzepe Krispi, i madhi De Rada, Gavril Dara, Françesko Krispi, Kamarda, Dorsa, Lorekio, Zef Skiroi etj. Me veprat e tyre jo vetëm letrare, por edhe studimore gjuhësore, historike e politike, e ngjallën dhe i dhanë shtysë çështjes shqiptare duke ndihmuar në njohjen dhe sensibilizimin e saj botërisht. Midis tyre figura madhore e Jeronim de Radës, i cili qëllimin dhe idealin e përbashkët për fatin e atdheut të përbashkët, e bënë letërsinë shqiptare dhe atë arbëreshe një të vetme, letërsi të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Pas rënies së prodhimtarisë letrare në gjysmën e parë të shek. XX, për shkak të depërtimit të frymës represive të regjimit fashist, pas Luftës II Botërore do të vihet re një ringritje si rrjedhojë e përpjekjeve të shumë intelektualëve dhe krijuesve për të shpërfaqur identitetin shqiptar nëpërmjet veprave të tyre studimore për gjuhën, historinë, kulturën, trashëgiminë folklorike shpirtërore e materiale, mbështetur e përhapur kjo edhe nëpërmjet një numri të konsiderueshëm gazetash, revistash e organeve të tjera kulturore, letrare, shkencore e politike. Françesko Solano (Dushko Vetmo), Domeniko Belici (Vorea Ujko), Karmel Kandrea, Luka Perone, Xhuzepe Skiro' di Maxho do të ishin përfaqësuesit më të njohur të letërsisë së kësaj periudhe.

Në kohën e sotme veprimtaria studimore dhe veprimtaritë kulturore tradicionale janë më të përhapura se krijimtaria letrare, ndoshta edhe për shkak të numrit të kufizuar të lexuesve në arbërishte. Fati i leximit në çdo kohë është i lidhur me lexuesin, dhe ky element po i mungon gjithmonë e më shumë arbëreshëve, shqiptarëve të Italisë, edhe pse një prej shkrimtarëve më të shquar të letërsisë italiane, Karmine Abate, është arbëresh nga Karfici i Katanxaros në Kalabri. Karmine Abate, vërtet për t'u çmuar, ka vlerën që shkruan vepra me subjekte nga historia dhe jeta e arbëreshëve të Italisë, duke i bërë jehonë historisë dhe kulturës të këtij komuniteti shqiptar. Por Karmine Abate, veprat e të cilin në kemi përkthyer nga gjuha italiane dhe botuar në gjuhën shqipe, shkruan në italisht dhe për lexuesin italian e më gjerë, në saje të përkthimit të veprave të tij. Kjo do të thotë se edhe arbëreshët e lexojnë veprën e tij në gjuhën italiane, siç e lexojmë edhe ne në gjuhën shqipe. Dëshira për ta shkruar veprën e tij apo vepra të tjera në gjuhën arbëreshe praktikisht është një mision i pamundur, pasi arbërishtja, siç dihet, është një gjuhë e folur, me leksik të kufizuar, e fragmentizuar në dialekte të ndryshme sipas vendeve të origjinës nga erdhën dhe territoreve ku janë vendosur. Ajo nuk mësohet sot në sistemin shkollor të shtetit italian, as si gjuhë e dytë, nuk ka politika për përgatitjen e mësimdhënësve për arbërishten dhe, përpjekjet e shoqatave të ndryshme për të sensibilizuar dhe organizuar kurse për mësimin e arbërishtes nuk po gjejnë mbështetjen e duhur institucionale.

**A.D.:** Para shumë vitesh, kur rropatesha të mësoja italishten, një zotëri më dhuroi një nga metodat më të mira për t'i dalë në ballë kësaj sfide: "Gjuha italiane pa mësuës", përgatitur nga ju. Kohë më vonë, u gjenda përballë dikujt që donte po ashtu të mësonte italishten dhe i

sugjerova të njëjtin libër, duke marrë në kthim mirënjohjen e tij pasi ia kishte dalë me sukses... Prandaj, ndonëse ky duhet të jetë libri juaj i parë nëse nuk gaboj, s'ri dot pa ju pyetur: Jetëgjatësia kaq e madhe e librit dhe suksesi i tij mes lexuesve, ende edhe sot kur për mësimin e gjuhëve të huaja përdoren metoda virtuale, si ndiheni?

**F.T.:** Ai libër, që i ka kaluar gjysmë milioni kopje të shitura gjatë më shumë se tri dekadave, ka historinë dhe rëndësinë e vet në jetën time. U ngjiz dhe lindi si një përmbledhje e leksioneve të studentëve të Akademisë Ushtarake në Tiranë, ku jepja mësim si pedagog i jashtëm para viteve '90, në fillim si dispensë, shtypur me shaptilograf, më pas i sistemuar në një libër për mësimin e italishtes pa mësuës, me shpjegime në gjuhën shqipe. Kujtoj se mësimi i gjuhëve të huaja para rënies së sistemit monist në vitet '90, veç asaj që ishte e programuar dhe e kontrolluar në shkolla, ishte i ndaluar. Më vjen mirë që ky libër, që kërkohej masivisht nga shqiptarët, si një dritare për të kontaktuar me botën, ndihmoi shumë, jo vetëm që ata që kërkonin një dritare informative e kulture nëpërmjet italishtes, por edhe si mjet komunikimi për mijërat e emigrantëve që kalonin detin me të gjitha mjetet e mënyrat e mundshme, dhe ku midis atyre pak plaçkave e pak të hollave që kishin me vete mbanin edhe librin tim si një gjë të çmuar. Edhe sot që flasim, kur kanë dalë në qarkullim me dhjetëra metoda virtuale e audiovizive, libri vijon të ribotohet periodikisht, pothuaj pa ndryshime nga botimet e para sepse, veç konceptimit të thjeshtë e praktik, ai është i pajisur me shpjegime në gjuhën shqipe në çdo element të gramatikës apo leksikut të saj.

**A.D.:** Në mbyllje, është një shprehje shumë e bukur që si rrallë ndonjë tjetër, përfshin thelbin e supersticionit e në të njëjtën kohë, të shpresës te shqiptarët: Nuk ka dy pa tre. Tani që janë botuar dy libra për arbëreshët, a jeni duke punuar, ose a do të punoni edhe me një të tretë?

**F.T.:** Gjatë pothuaj tri dekadave vajtje-ardhesh e kontaktesh të çdo lloji me botën arbëreshe, kudo në të gjithë Italinë, kam grumbulluar një material shumë të gjerë e të pasur dokumentar e informativ nga të gjitha aspektet e jetës në vendbanimet arbëreshe, ku gjuha, kultura, mënyra e jetesës, riti lindor bizantin, objektet dhe simbolet e kultit etj. dhe fotot e tyre ilustruese janë më kryesoret. Kjo më ka bërë të mendoj për botime të tjera mbi arbëreshët, me qëllim njohjen sa më mirë të historisë dhe kulturës së tyre, siç do të jetë një album i madh fotografik mbi trashëgiminë historike dhe kulturore arbëreshe në Itali, si dhe një libër studimor i indeksuar për mbi 560 vendbanimet shqiptare në Itali në shek. XIV-XIX, pjesa më e madhe e të cilave sot nuk ekzistojnë, por, duke lënë, gjithsesi, gjurmë të dukshme dhe të dokumentuara në historinë dhe kulturën e vendeve ku jetuan e punuan.

Gjithashtu, përgatitja e një botimi Guidë Turistike për vendbanimet arbëreshe, me informacionet dhe ilustrimet e nevojshme sipas kërkesave dhe standardeve bashkëkohore mund të jetë në planet e mia jo fort të largëta. Besoj se do të ishte një botim informativ që do të ndihmonte në njohjen dhe nxitjen e vizitave turistike në botën arbëreshe në Itali.



## LAMTUMIRË, XHEVAT BEQARAJ

nga Prof. Dr. Klara Kodra

Ushua edhe një yll nga yllësia e shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë, poeti mallakastriot Xhevat Beqaraj, liriku i ëmbël dhe fin që në vargje vizatonte tablo të shumëngjyrëshme të natyrës, duke i parë ato me syrin e mrekulluar dhe naiv të fëmijëve, që i antropomorfizonte kafshët duke i shndërruar në personazhe të gjallë, që gjente harmoninë e përshtatshme për vjershat dhe poemat e tij, përmes një larmie metrash dhe rimash tingëluese.

Që nga vëllimi i parë që u takon viteve gjashtëdhjetë, "Kam një harmonikë" (1965) e deri në "Rruazat e vesës" të vitit 2005, Xhevati kishte gjetur vetveten si poet të afërt me shpirtin e fëmijës që sillte në krijimtarinë poetike për të vegjëlit përvojën e vet si mësuës, njohës i moshës fëmijërore. Veçse, ky autor nuk sillte aspak në shkrimet e veta frymën didaktike, përkundrazi aspektin e pastër fëmijëror të shpirtit të vet që u bënte të fliste fëmijëve pa u shtirur dhe duke komunikuar natyrshëm me ta. Xhevati kishte një individualitet krijues të spikatur që e dallonte ndër sivëllezërit shkrimtarë për fëmijë. Qe poet i detajit dhe i figurave (metafora, simboli, epitete) të thjeshta e befasuese, qe poeti i gjetjeve të goditura që e çudisin dhe e bëjnë të mendohet lexuesin e vogël. Qe poet i lirikave të shkurtëra dhe i poemave. Qe poet që dinte të ndërthurte imtësitë nga realiteti me elementin fantastik që përputhet me magjinë e vështrimit fëmijëror mbi botën, pra poet i vjershës përrallë dhe poemës përrallë.

Qe poet që dinte të vendoste dukuritë e përjetshme kozmike pranë dukurive të teknologjisë moderne. Xhevat Beqaraj e shtriu poezinë e vet në dy periudha, madje në dy shekuj, nga dyzetvjeçari i fundit i shekullit të njëzetë në fillimin e shekullit të njëzetënjë, duke e përtërirë vetveten nga vëllimi në vëllim dhe duke i qëndruar besnik thelbit të vet, botës së vet poetike. Ai diti të ishte i thjeshtë, pa rënë në atë thjeshtëzim që dëmtoi një pjesë të poezisë sonë për fëmijë, të shkruante një poezi të pasur me mesazhe, me vlera njohëse dhe edukuese, pa rënë kurrë në atë retorizëm apo didaktizëm që e largojnë instiktivisht fëmijën. Disa nga personazhet e tij kafshë të animizuara të mbeten në mendje, qofshin ato pozitivë si milingonat punëtore të poemës "Elefanti dhe milingonat", mësuësja sorkadhe, e dashur dhe komunikuese me nxënësit, apo negativë si dhelpira e vjershës "Ku di qeni të lexojë", dinakja që kapet në vetë lakun e dinakërisë së vet ose elefanti mëndjemadh që beson vetëm te forca fizike te "Elefanti dhe milingonat", po mposhtet papritur nga guximi dhe mençuria e kundërshtarëve që ai i gjykon si të dobët. Gjithashtu të mbeten në mendje personazhe fëmijë si vogëlushja e dashur Keti që e animizon në mënyrë naive hënën dhe kërkon të gjejë mënyrën për ta shpëtuar se mos mbytet në pus, vogëlushja Dritë që hedh tullumbacen me figurën e macës dhe shqetësohet a do të fluturojë dot pa krahë, djali i vogël që bëhet merak për rosën që lahet në shi, Eneida e dashuruar pas natyrës, e mençur, po edhe naive, e tregimit në vargje "Çuditë e Eneidës".

Poeti e rizbulon natyrën bashkë me fëmijët që janë personazhe ose bashkëbisedues në poezinë e tij. Ai poetizon edhe lodrat përmes të cilave fëmijët zbulojnë realitetin dhe aktivizohen, po edhe përpjekjet e tyre të para për dije në sferën e shkollës.

Një gjetje befasuese e autorit është shkolla për kafshë e shpezë që fillon në pranverë dhe jo në vjeshtë ("Nuk qeshin të gjithë"). Poeti i përdor personazhet kafshë të antropomorfizuara për të simbolizuar tipa të ndryshëm fëmijësh dhe marrëdhëniet e tyre me mësimin dhe mësuësit.

Një tipar i artit të Beqarajt është ndërthurja e lirizmit me humorin e këndshëm, dy çelësa për të hyrë në botën e lexuesit të vogël. Xhevati është një poet konçiz, një poet që sintetizon, një poet që gjen fjalën e duhur për të vizatuar portrete dhe tablo ose për të ndërthur dialogë shprehës.

Xhevat Beqaraj bën pjesë ndër ata autorë që dëshmuar për thellësinë dhe nivelin e lartë estetik që mund të arrijë letërsia për fëmijë, e nënvlerësuar dhe e mënjanuar gjatë nga kritika jonë. Ndarja e tij nga jeta ka hapur një boshllëk që s'do të jetë e lehtë të mbushet.

Po trashëgimia letrare që ka lënë është një pasuri e paçmuar në thesarin e poezisë për fëmijë, në veçanti dhe tërë poezisë shqiptare në përgjithësi. Përmes saj poeti rron dhe do të vazhdojë të rrojë.

S'po i rikthehem metaforës së yllit që, siç dihet, edhe i shuar mund të rrezatojë dritë. Është një metaforë që ka humbur bukurinë e origjinës nga stërpërdorimi. Veçse drita e poezisë së Beqarajt shkëlqeu që në të gjallë të tij në dy periudhat krijuese në të cilat u zhvillua dhe i arriti lexuesit fëmijë dhe të rritur, gjithnjë origjinale, gjithnjë e freskët dhe e gjallë.

Jemi të bindur që kjo poezi do t'u arrijë edhe brezave të tjerë.

Çmimi “Lumo Skendo” për veprën më të mirë në fushat e publicistikës, eseistikës dhe studimtarisë, është i rëndësishëm sepse mban emrin e Mid’hat Frashërit (Lumo Skendo), një personalitet madhor i historisë dhe kulturës shqiptare.

Në këtë festë për LIBRIN, po kumtoj vetëm për lidhjen e Lumo Skëndos me librin, meqenëse prilli është Muaji i Librit, por edhe se ky çmim sivjet jepet për një botim të shkëlqyer të studiuesit Ilir Ikonomi “Fan Noli – apostulli”.

Për Lumo Skendon, libri ishte i shenjtë. Kur ishte 17 vjeç, në Stamboll, ku jetonte në familjen e Sami Frashërit dhe pranë Naimit dhe mes bibliotekave të pasura të tyre, ai themeloi bibliotekën personale “Lumo Skendo” 1897, gjë që rrëfente pavarësinë e tij intelektuale. Librat ishin miqtë e tij, dashuria e tij më e madhe, pasuria e tij dhe e kombit tonë.

Në vitin 1898, kur ishte 18 vjeç, Lumo Skendo u bë shpirti dhe mendja e “Kalendarit Kombiar”, me botues Kristo Luarasin. Në çdo numër të “Kalendarit Kombiar”, kësaj enciklopedie të vërtetë të kulturës shqiptare, gjendet pena dhe mendja e Lumo Skëndos.

Gjithë përpjekja e tij u bë misioni për ringjalljen shpirtërore dhe kombëtare të shqiptarëve nëpërmjet gjuhës shqipe dhe librit, diturisë së librit.

Në këtë periudhë të fundit të Rilindjes, ai hartoi dhe botoi librat e tij për shkollat shqipe “Këndimet për çunat”, metodat për mësimin e gjuhëve të huaja, kujtimet për Abdyl Frashërin, Sami Frashërin, Naim Frashërin si edhe më pas studimet për veprën e Naim Frashërit, ku janë mbështetur studiuesit e mëvonshëm për Naimin, pa e cituar Lumo Skendon.

“Po e shohim se tani se fuqia e njeriut nuk është vetëm te fuqia e grushtit, si në kohë të shkuara, por te qytetaria, dituria e librit, puna, mbrothësia” shkruante ai

Kjo veprimtari për gjuhën dhe diturinë e çoi te Kongresi i Manastirit, kryetar i të cilit ai u zgjodh kur ishte 27 vjeçar, ndërmjet mjekrave të shquara, për miratimin e alfabetit plotësisht latin dhe botimet e librave më këtë alfabet.

Më 14 korrik 1908 ai botoi gazetën “Lirija” e cila i solli shërbime të mëdha lëvizjes kombëtare dhe kulturës shqiptare.

Në vitin 1909 botoi revistën Kulturorë “Diturija”

*Padysim “Diturija” (e Lumo Skëndos) është sot për sot mjerisht e vetmja gjë për mua, që po e shndrit pakë a shumë qiellin e diturisë së vrazhtë të Shqipërisë” shkruante Gjergj Pekmezi, albanolog.*

Vlerësime të çmuara kanë dhënë edhe albanologët Holger Pedersen, Norbert Jolki, Gustav Weigand, të abonuar në këtë revistë.

Deviza e Lumo Skëndos ishte, “Lufta për gjuhën dhe diturinë është një formë tjetër e luftës për të rrojtur”.

Në vitin 1913 dha dorëheqjen nga qeveria e Ismail Qemalit dhe shkoi mësues filloreje në Elbasan, qendër e kulturës në atë kohë. Jepte mësimin e shqipes dhe të diturisë. Në filim të vitit 1914 ai shpalli një nismë, me rastin e vizitës së Edit Durham në Shqipëri, që qytetarët e Elbasanit të jepnin nga një grosh për t’i blere Mis Durhamit një stilograf të florinjte, për librat e saj mbi Shqipërinë dhe kombin shqiptar. Nga një grosh, që të kishte një pjesëmarrje sa më të gjerë (ekziston në arkiv lista e tyre ). U ble stilografi i florinjte dhe një delegacion me ne krye Lumo Skendon ia dhuroi mbrojtëses se madhe të kombit tonë, kur ajo zbriti në Vlorë, 1914

Në vitin 1914 si shumë patriotë u mërgua nga Shqipëria për shkak të lëvizjes haxhiqamiliste dhe shembjes së shtetit shqiptar. Në Bullgari nis botimin e librave të tij të çmuar “Hi dhe Shpuzë” (proza poetike), “Letra nga një udhëtim në Zvicër” (publicistike) dhe “Popullsia e Epirit” (histori). I vazhdoi botimet në Zvicër 1919 me veprat historike në frëngjisht “Shqiptarë e Sllavë”, “Rilindja shqiptare”, “Shqiptarët ne

Me rastin e dhënies së çmimit “Lumo Skendo” për vitin 2023

# DASHURIA E MID’HAT FRASHËRIT PËR LIBRIN

nga Uran Butka

vend të tyre dhe jashtë”, “Pritmi i Shqipërisë”, “Çështja e Epirit”, etj, vepra që ua dërgonte personaliteteve të politikës dhe kulturës botërore, që do të vendosnin për fatin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris.

Në vitin 1921, kur ishte kryetar i delegacioni Shqiptar në atë Konferencë, ai në bashkëpunim me albanologun Mario Roques, çeli katedrën e gjuhës shqipe në Universitetin e Gjuhëve të huaja dhe jepte mësim për gjuhën dhe literaturën shqiptare.

Në vitin 1924 boton librin me ese “Plagët tona” ku vinte gishtin mbi plagët e shoqërisë dhe rrëfente si shëroheshin ato.

Në vitet 1923-1925 kur ishte ambasador i Shqipërisë në Greqi. Ai mbrojti si askush çështjen çame dhe promovoi kulturën shqiptare dhe librin shqiptar. Në bisedën e Mid’hat Frashërit me kryeministrin grek, Venizelosi pranoi:

“Në Paris qeshë i shtrënguar të mbronj interesat e Greqisë, bëra detyrën time, si edhe ju bëtë tuajën. E shoh që kishit të drejtë. Teza juaj ishte më e vërteta dhe unë përulem para jush”.

Dha dorëheqjen si ambasador i Shqipërisë në Athinë, me motivin “Asgjë të mos japim nga trupi i mëmëdheut” si protestë për faljen e Shën Naumit dhe majës së Kelmendit, u kthye në vendin e tij dhe bëri jetë private, kryesisht me veprimtari kulturore. Çeli në Tiranë librarinë “Lumo Skendo”, të cilën e ktheu në një vatër të librit dhe kulturës shqiptare, por edhe evropiane. Mjafton të përmendim kujtimet e vetë Lumo Skëndos për këtë librari me titullin “Kujtimet e një librari”

Ndërkohë ku botoi një mori studimesh e artikujsh problemorë dhe shkencorë për të gjitha çështjet shqetësuese të shoqërisë shqiptare të viteve ’30 e ’40, theksojmë biografite, bibliografite shqiptare për të gjitha botimet e autorëve shqiptarë e të

huaj, botimi i veçantë “Udhëtarët e huaj në Shqipëri”, rubrikat kritike “Duke lexuar një libër”, “Tribunë gramatike”, studimet për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Fjalorin e Marko Boçarit, studimet për autorët e vjetër të letersisë etj, etj.

Ai i kundërvihet errësirës së asaj kohe, duke përhapur dritë, dritën e diturisë e të kulturës. Një nga ngjarjet më befasuese kulturore të kryeqytetit shqiptar ishte hapja nga Mid’hat Frashëri e dy ekspozitave të librit shqiptar. E para, me gjithë botimet e Kristoforidhit; e dyta, me veprat e shkrimtarëve të vjetër të shqipes. “Meshari” i Buzukut (broshurë), veprat e Bogdanit, Bardhit, Budit, Matrangës, Kavaliotit, De Radës, Dorsës, Kamardës, shkrime të vjetra fetare, shkollore, gjuhësore. Gjithashtu, ai çeli në Tiranë edhe një ekspozitë dokumentare e fotografike për Lidhjen e Prizrenit si edhe një ekspozitë me botimet shqiptare e të huaja për Skënderbeun.

Popullariteti i Mid’hat Frashërit rritej gjithnjë e më shumë, ai u shndërrua në një institucion kombëtar kulture.

Ai vazhdoi të punonte me këmbëngulje për themelimin e Bibliotekës Kombëtare, të pasuruar më pas me thesarin e bibliotekës së tij madhore në 40 mijë volume.

Në një njoftim të librarisë “Lumo Skendo” Midhat Frashëri i grish mendërisht lexuesit: “Në doni libra, në ju pëlqen këndimi, në kini dëshirë për dije, me një fjalë, në është se mendja juaj ka nevojë për ushqim, drejtohuni në librarinë Lumo Skendo, ku do të gjeni një sasi të madhe veprash në çdo gjuhë- letrare, diturije, tekste shkollore...”

Porositë plotësohen me kujdes dhe shpejtësi të madhe.

Ah, po në qoftë se nuk kini nevojë për ndriçim të mendjes, atëherë shkoni në...kafene!”

Në testamentin e tij 1929, ai shprehu vullnetin që bibliotekën e tij dhe çdo pasuri



tjetër të tundshme dhe të patundshme i linte për krijimin e një Instituti Albanologjik, që të ishte qendër e studimeve shqiptare edhe nderi e lavdi ynë personal”.

Dëshira a tij u plotësua në vitin 1916, kur me ndihmën humane e financiare të Agron Shehaj ngritëm së bashku Institutin e Studimeve Historike “Lumo Skendo”, ku po botoj 12 vëllimit e veprës se zgjedhur të tij, një pasuri kulturore e panjohur dhe e paçmuar e historisë dhe kulturës shqiptare.

Në vëllimin IX veç të tjerash, vijon edhe letërkëmbimi i famshëm i Lumo Skëndos, me figurat e shquara të botës shqiptare, natyrisht edhe me Fan Nolin, dy kollosë të letrave shqipe, si edhe me personalitetet më të shquara politike, shtetërore dhe kulturore të Botës.

Po japim një letër të Mid’hat Frashërit drejtuar Fan Nolit në Gjenvë, viti 1921:

“Imzot,<sup>1</sup>

*Telegramën që më dërguat, e mora. Disa orë pas telegramës sime, që ju çova pardje, mërdhi zarfi me aktet që patët mirësinë të më dërgoni. Ju falem nderit dhe ju lutem, në mundet, të më çoni disa libërza të Frangulit.*

*Këtu, Komisia e Ekspertëve e filloi punën dhe, si duket, nuk do të vejë gjatë. Më 8 të muajit më thirrën përpara Komissisë, për të treguar cilat janë desideratat e Shqipërisë.*

*Këtu brenda do të gjeni shkresën që këndova përpara atyre, sikundër edhe pyetjet e përgjigjet që vazhduan.*

*Me sa kemi kuvenduar, na japin shpresë. Pikëpamja italo-frënge na duket në favor tonë. Dje u dëgjuan delegatët grekë e serbë.*

*Tani delegati anglez pret instrukta të reja nga qeveria e tij. Besoj se Mehmed beu<sup>2</sup> si edhe Dr. Turtulli, i cili u nis pardje për në Londër, do të bëjnë sa të mundën për çështjen tonë.*

*Ju lutem, Imzot, të pranoni të falat e mija me nder.”*

Në një letërkëmbim me kryeministrin Shefqet Verlaci, i cili e fton Mid’hatin në ditën e 28 nëntorit 1937, lexojmë:

“Zoti Kryetar,

*Ju ngjatjetonj për telegrafin dhe jam fort mirënjohës për nderin që më bëni.*

*Mjerisht unë kam një shëndet të dobët, që nuk më permeton të marr pjesë në ceremonira. Veç kësaj edhe Z. juaj e kupëtoni se në përfaqësi të tilla është mirë të zgjidhet një njeri që të mos jetë dyqanxhi.”*


Midhat Frashëri

Një sarkazëm për kryeministrin fashist Shefqet Verlaci dhe qeverinë e tij.

Një libër më vete përbëjnë letrat e dashurisë të Lumo Skëndos, kryevepra të letërsisë epistolare. Ndër to edhe letrat e të dashurës së tij rumune, Angele Romano, me të cilën pati plot 25 vjet letërkëmbim të bukur. Ajo e ftonte të bashkëjetonin së bashku në një vend më të qetë e të sigurt.

Më 28 Nëntor 1933 ajo i dërgonte një kartolinë: “Po të shkruaj me nxitim, ngase nuk doja të shpëtonte kjo ditë pa të thënë që nuk e harroj, përvjetorin e një dite të lumtur për vendin tënd, 28 nëntorin. Jam krenare për ty dhe për vendin tënd”.

**Por Mid’hati mes Shqipërisë dhe Angeles zgjodhi vendin e vet, mes dashurisë dhe detyrës zgjodhi pasionin për kombin e tij.**



<sup>1</sup> Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme, Dosja 41/1, viti 1921. Letër e Mid’hat Frashërit. (red)

<sup>2</sup> Mehmet Konica (red)

## Parantezë

Në mëngjesin e 15 janarit të vitit 1992 bashkë me dy nga anëtarët e kryesisë së Shoqatës "Për të Rënë e Kombit Shqiptar" arritëm në Tiranë. Aty gjetëm edhe idealistë të tjerë që kishin shkuar nga Kosova, ndërkaq pas disa ditësh erdhën edhe të tjerë nga Zvicra dhe Gjermania. Problemi më i madh fillestar u shfaq për strehimin tonë. Na vendosën te shkrimtari Resul Bedo, ushtaraku Halil Katana, gazetari ushtarak Mehmet Gëzhilli, shkrimtari Agim Cerga dhe më së shumti te artisti Reshat Arbana, në shtëpinë përdhese të të cilit ishin përshtatur disa dhoma dhe ajo më parë se sa në shtëpi, ngjante në një minikazerëm. Në këtë shtëpi, në mbrëmje shtriheshim të flemë 7-8 veta, ndërsa zgjoheshim deri në 15 veta. Gjatë natës vinin shumë të rinj, që duhej të përgatiteshin për ushtrime ushtarake, të lodhur, të lagur e të ngrirë nga bora gjatë kalimit të kufirit dhe vendoseshin pikërisht në këtë shtëpi të parapërgatitur për këtë qëllim.

Te secili gjetëm ngrohtësinë e mikpritjes, por në kujtesë do të më mbetet Familja Gëzhilli. Dhe do të më mbetet për dy arsye: e para se ata "për të strehuar luftëtarët e lirisë së Kosovës", në banesën e tyre të vogël kishin rregulluar një kënd fjetje në ballkonin e saj, jo shumë të ngrohtë, ndërsa me ne, në dhomë flinin dy fëmijët e tyre të vegjël; dhe e dyta, sepse në një kohë që tregu i librit vërshonte nga vepra të shkrimtarëve të letërsisë së huaj (Kamy, Kafka, Dostojevski, Xhojsi etj.), Mehmet Gëzhilli, punonte me përkushtim për një *Antologji të poezisë kushtuar Naim Frashërit*, të cilën me një fjalë hyrëse të Dritëro Agollit, do ta botojë në vitin 1996. Duke dëgjuar përkushtimin e tij intelektual për fatin e Kosovës, e cila në ambientet politike të Tiranës kishte rrëshqitur thellë në fundosjen e Shqipërisë si shtet dhe shqiptarëve si popull, si dhe duke parë përkushtimin e tij ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare, si kusht i tejkalimit të zhgënjimit të atij brezi në tranzicion, pëshpërisim deri natën vonë me Enverin nga Kumanova dhe Bacën Kadri nën zë: "Fatin dhe perspektiven e vendit dhe të kulturës së një populli e ruajnë dhe e ushqejnë para se gjithash njerëzit si Mehmet Gëzhilli, i cili as në momentet më të vështira të përmbysjes nuk shkëputet nga rrënjat e trashëgimisë kombëtare".

### I. Faik Konica: "njeri i mirë, zemërqëruar, mendjehollë e fjalëkripar"

Në këto kohë të vështira tranzicioni të trishtë, kur bashkëkohësit e tij gjurmonin në Dosjet e Sigurimit të Shtetit, në Dosjet e Partisë dhe në dosjet gjithfarëshe, madje kush duke i pastruar e kush duke i mbushur ato në Arkivat e rrënuara e të rrëguara, Mehmet Gëzhilli punonte ditë e natë për të krijuar "Dosjet" jetësore dhe krijuese të burrave të mëdhenj të kombit: Naim Frashërit, Naum Veqilharxhit, Fan S. Nolit, Nonda Bulkës dhe madje personaliteteve të mëdha botërore, të cilët i kishin dalë zotë Shqipërisë dhe shqiptarëve në ditët më të vështira, sikur ishin dosjet me materiale për botim të Presidentit Amerikan Woodrow Wilson dhe mbretëreshës së pakurorëzuar shqiptare Edit Durham.

Për t'i realizuar ëndrrat e tij jo vetëm të *Antologjisë* për Naim Frashërin, po edhe për t'i kurorëzuar ato me një korpus të madh studimesh antologjike për jetën dhe veprën e Naim Frashërit, të cilin ai e quan: *Enciklopedia Naimiane*, gazetari të dikurshëm ushtarak e tani botuesit, hulumtuesit dhe studiuesit Mehmet Gëzhilli, ju deshën rreth tri dekada. Kërkimet e tij tani i ka përmbledhur e sistemuar në dhjetë vëllime të mëdha. I: *Gjuha e Naimit*; II: *Filozofia e Naimit*; III: *Arti i Naimit*; IV: *Naimi* për shkollën shqipe; V: Studime për veprat e veçanta të Naim Frashërit; VI: *Kujtime, publicistikë, veprimtari përkuajtore*; VII: *Naimi* në librin dhe shtypin botëror; VIII: *Antologji poetike për Naim Frashërin*; IX: *Bibliografia e Naim Frashërit (25 maj 1846 – 31 dhjetor 2023)*; X: *Fjalor enciklopedik*. Ato ju referohen bëmave jetësore dhe bëmave intelektuale krijuese e letrare<sup>1</sup>.

1 Me qëllim referimi e njohjeje të botimeve të Naim Frashërit, me të cilat merren autorët e këtyre studimeve, por të referuara në botime të ndryshme, këtu po e sjellim të plotë bibliografinë e botimeve të para të veprave në gjuhën shqipe. 1886: *Bagëti e Bujqësija*. Bukuresht, 1886; 1886: *E këndimit çunavet. Këndonjëtorja*. Copë e parë. Bukuresht 1886; 1886: *E këndimit çunavet. Këndonjëtorja*. Copë

*Enciklopedia naimiane: Gjuha e Naimit* (Përgatiti: Mehmet Gëzhilli), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022, f. 868.

# GJUHA E VEPRËS SË NAIM FRASHËRIT

Nga Begzad Baliu

Serinë e kësaj kolane posaçërisht të rëndësishme në jetën tonë shkencore dhe kulturore e hap vëllimi *Gjuha e Naimit* prej tetëdhjetë e pesë autorësh me mbi dyqind tekste. Në këtë vëllim, tekste janë radhitur sipas kronologjisë së botimit të tyre, me ndonjë përjashtim, kur tekste janë nxjerrë nga botimet e mëvonshme, ndërsa në paraqitjen tonë teksteve të këtij vëllimit do t'ju qasemi fillimisht sipas tematikës së teksteve e herën tjetër sipas kronologjisë së botimit të tyre.

Vëllimi hapet me një tekste të Faik Konicës, me titull *Në vend të parathënies*, i cili sikur është shkruar për të përfaqësuar gjithë mendimin e bashkëkohësve të tij për Naim Frashërin dhe madje mendimin kritik të tyre, si dhe perspektiven historiko-letrare të kohës sonë për studimin e veprës e tij. Në tekste e tij, të mëtejme, publicistike, kritike, bibliofilike e bibliografike, sintetike apo polemizuese, të plota apo fragmentare: *Ca këshilla mbi artin e shkrimit*; *Faik Konica për Naim Frashërin*; *Mbi një plloçë varri*; *Biblat shqip*; *Libra shqip*; *Naim Frashëri*, si askund tjetër bashkohën ide, referenca, koncepte, paradigma e sintheza jetësore e krijuese për Naim Frashërin, për kohën, historinë, artin dhe kombin, të cilat do të shkruhen dhe botohen në *Albania dhe Kalendari kombiar*, ndërmjet viteve 1897-1904, do të projektojnë të ardhmen e atdheut, gjuhës, identitetin dhe kulturën kombëtare. Le t'i referohemi vetëm një mendimi të tij për Naim Frashërin: "Gjuhëtar i shëndoshë, i ditur, i mbaruar në greqishte të vjetër e në persishte e në shumë gjuhë të tjera, mendje lëruar e ndjesëhollë, do të kish mundur e dëshironte të shkruajë gjëra më pak të nevojshme e më shumë të bukura. Po nevoja e vendit tonë, detyra t'u hapin sytë botës, e shtrëngonin të mos ngjitej më sipër se kuptimi i popullit të Shqipërisë. U kufizua pra, gjithnjë në qark të ndershëm e të shkëlqyer të mësimi kombëtar. Jo se nuk ndodhen në libra të Naim beut faqe të hieshme e të mbartura janë përkundër po rrëfejnë të gjitha veç dëshirën të mësohet kombi. E mësoi, e ngjalli, e rriti pak kombin shqiptar, - e gatiti udhën, - për një propagandë kombëtare më përparimtare". (19/22) Të tilla tekste botohen e shpërfaqen, të tilla mendime barten e përplotësohen deri në fund të këtij vëllimi studimesh prej një shekulli për jetën dhe veprën e Naim Frashërit.

### II. Rilindësi i Shqipërisë, shqiptarëve dhe gjuhës shqipe

Në pjesën e parë të teksteve të zgjedhura të këtij vëllimi janë botuar artikuj, fragmente artikujsh, tekste të zgjedhura, kujtime, letra, vlerësime e tekste për ngjarje historike, ku emri i Naim Frashërit dhe veprës së tij kur e kur del në planë të parë e kur e kur në mënyrë anësore<sup>2</sup>.

e dytë. Bukuresht, 1886; 1886: *Istori e përgjithëshme për mësonjëtorët të para*. Bukuresht, 1886; 1886: *Vjersha për mësonjëtorët të para*. Bukuresht, 1886; 1888: *Dituritë për mësonjëtorët të para*. Bukuresht, 1888; 1890: *Luletë e lërësë*. Bukuresht, 1890; 1894: *Mësime*. Bukuresht, 1894; 1894: *Paraja dhe fjala fluturake*. (Bashkë me veprën *Mësime*). Bukuresht, 1894; 1895: *Gjithësia*. Bukuresht, 1895; 1896: *Fletore e bektashinjët*. Bukuresht, 1896; 1896: *Iliadh e Omirit*. Këngë e parë. Bukuresht, 1896; 1898: *Istori e Skënderbeut*. Bukuresht, 1898; 1898: *Qerbelaja*. Bukuresht, 1898; 1899: *Istori e Shqipërisë*. Sofje, 1899; 1902: *Shqipëria*. Vjershë. Sofje, 1902.

2 Prej *Bibliografisë*, në të vërtetë prej *Kronologjisë së shkrimeve për jetën dhe veprën e Naim Frashërit* botuar në monografinë e Rexhep Qosjes, *Porosia e madhe (Vepra e Naim Frashërit)*, Prishtinë, 1985, kuptojmë se artikujt e parë janë shkruar para vdekjes së tij, duke filluar me vitin 1898: *Istori e Skënderbeut*. (Shënim i shkurtër). *Shqipëria* (Bukuresht), I.X.1898; 1898: *Qerbelaja dhe Histori e Skënderbeut*. (Shënim). Albania, nr. 3, 1898; 1899: Naim bei Frashëri. La Nazione Albanese (Catanzaro), 30.V.1899; 1900: *Naim beg Frashëri*. La Nazione Albanese, 31.X.1900; 1900: *Vdekja e Naim Frashërit*. Albania, nr. 11, 1900.

Autorë të këtyre teksteve janë bashkëkohës e pasardhës të tij të Rilindjes Kombëtare, iluministë të cilët për Naim Frashërin kanë shkruar kryesisht pas vdekjes së Naim Frashërit. Ata shkruajnë për Naim Frashërin dhe veprën e tij edhe atëherë kur shkruajnë për vendlindjen (Naum Naçi); edhe atëherë kur shkruajnë për hapjen e shkollave shqipe dhe shpërndarjen abetareve të para (K. N. Luarasi, Shahin Kolonja); edhe atëherë kur shkruajnë për familjen e madhe të Frashërlinjve (Midhat Frashëri); edhe atëherë kur shkruajnë për fatin historik e perspektiven moderne të popullit shqiptar (Luigj Gurakuqi); po edhe atëherë kur shkruajnë për shkrimtarët shqiptarë si përfaqësuesit më emblematikë të popullit shqiptarë e të kulturës së tij (Josif Bageri, Mehmet Vokshi) etj.

Thënia lapidare e patriotit dhe mësuesit të popullit Mehmet Vokshi "Ajo, Naim Frashëri, ka për t'i gëzuar shekujt"; pamja që sjell fanalisti Qerim Panariti për gjuhën shqipe, si një evolucion i krijuesve sikur është Naim Frashëri; si dhe tekste të tjera të shkruara nga Dhimitër Berati për Korçën si një referencë përfaqësuese nacionale; letra e arbëreshit Zef Skiroi dërguar iluministit dhe memoreistit Visar Dodani; shqetësimet e E. Selenicës për rrëgjimin e gjuhës shqipe si një pabesi ndaj apostullit të saj Naim Frashërit; kujtimi i heroit të kombit Bajo Topilli për takimet e tij me Naim Frashërin dhe redaktorin e tij të teksteve didaktike Jani Vreton; artikulli i Mihail Gramenos për vendlindjen e Frashërlinjëve si një vend i shenjtëruar i Shqipërisë e shqiptarësisë; tekste mjaft domethënëse të Syrja Vlorës dhe Hafiz Ali Korçës për Naim Frashërin dhe krijimtarinë letrare, të shkruara në një kohë perëndimi të shpirtit të tij, në fillim të shekullit XX; na bëjnë të rivlerësojmë tani në rrethana të reja përmasën e perceptimit të veprës së tij nga një brez personalitetesh nga më të shquarit e kohës: shkrimtarë, eruditë, patriotë, heronj, klerikë e specialistë të fushave të shumta, që për atë/baba/apostull/frymë kishin rilindësin, bardin e kombit, Naim Frashërin.


Po të kësaj natyre, sa kohësore po kaq edhe historike, brenda modelit të artikujve të botuar në etapën e parë janë tekste e studiuesve Moikom Zeqo dhe Nexhip Merkurit. Moikomi me tekstin e tij *I lumi ai shkrimtar që e lexojnë edhe pas 100 vjetësh*, sikur ju përgjigjet të gjithë bashkëkohësve të Naim Frashërit dhe paraardhësve të tij për bindjet e tyre të shprehura që në fillim të shekullit XX, sikur janë Mehmet Vokshi, Josif Bageri, Luigj Gurakuqi etj.

Në këtë periudhë artikujsh, kujtime, vlerësimesh, studimesh e nderimesh për Naim Frashërin dhe veprën e tij mund të merren shumë autorë dhe tekste të tyre si referencë a paradigmë kërkimesh të mëtejme për romantikun tonë dhe veprën e tij, por do të shquanim një prej artikujve më të hershëm të Mit'hat Frashërit për Naimin, i cili mund të quhet përpjekja e parë për të shkruar një biografi të jetës së tij, që në realitet nuk ka arritur të shkruhet, qoftë për shkak të mungesës së dokumenteve të dorës së parë, qoftë për shkak të hulumtimeve modeste për jetën e tij që kanë bërë gjatë gjithë shekullit XX.

### III. Studimet e para themeltare për kohën, jetën dhe veprat e Naim Frashërit

Pa dashur që të vendosim kufijtë e kërkimeve shkencore të studiuesve për jetën e Naim Frashërit dhe sinthezat e para shkencore për jetën e tij, po e sjellim këtu një kronologji të tyre mbështetur në botimin e teksteve në këtë vëllim<sup>3</sup>. Në këtë periudhë që hapet kryesisht

3 Prej tekstit të parë të vitit 1898 janë shkruar shumë



në vitet '30 vazhdojnë të shkruajnë atdhetarë e iluministë të periudhës së parë, por gjithashtu fillojnë të shkruajnë studiues të formuar në shkollat filologjike të institucioneve vendore, të rajonit dhe të Europës. Studimet e kësaj natyre janë tekste e studiuesve, të cilët gjuhën e veprave letrare të Naim Frashërit e shohin në kontekst të zhvillimit të gjuhës shqipe, të historisë së saj dhe madje të raporteve të gjuhës së saj me shkrimtarët të tjerë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, po edhe me paraardhës e pasardhës të tij. I kësaj natyre është studimi historiko-gjuhësor i At Justin Rrotës, botuar brenda monografisë *Për historinë e alfabetit shqip*, si dhe teksti i Profesor Shaban Demirajt, i botuar brenda studimit sistematik për gjuhën e shkrimtarëve të shekullit XIX.

Kalimin nga studimi përgjithësues në sintezë shkencore në studimin e gjuhës së Naim Frashërit e bën Profesor Jup Kastrati me studimet e tij më me ndikim në gjuhësinë shqiptare gjatë kësaj periudhe. Fjala është për studimet më të cituara në studimet e gjuhës së Naim Frashërit dhe madje jo vetëm të gjuhës së tij: *Ndihmesa e Naim Frashërit* për gjuhën shqipe, dhe *Naim Frashëri* për gjuhën shqipe. Vështirë të gjendet një studim a një sintezë serioze për Naim Frashërin në të cilin studimet e Profesor Jup Kastrati të mos jenë cituar disa herë. Të kësaj natyre janë tekste e studiuesve, të cilët gjuhën dhe veprën e Naim Frashërit e kanë parë në kontekst të veprës së tij, në raport me gjuhën e teksteve të bashkëkohësve të tij dhe studiuesve, të cilët gjuhën e Naim Frashërit e kanë parë jo vetëm në kontekst të shkrimtarëve shqiptarë po edhe në raport me letërsitë e Lindjes.

Studiuesi Shaqir Berani, gjuhën e teksteve letrare e didaktike të Naim Frashërit e quan revolucion gjuhësor, e ndoshta do të duhej të quhej evolucion i shqipes moderne; Profetori Tomor Osmani ka bërë një diskutim sintetik mbi një studim të albanologut Norbert Jokli, që si asnjë tjetër gjatë gjysmës së parë të shekullit XX ka thelluar studimet gjuhësore në fushë të fjalëformimit për veprën e Naim Frashërit dhe madje jo vetëm për të; bashkëkohësit tjetër i Profesor Tomorit, Profesor Seit Mansakut ka botuar një studim tipik në fushë të diakronisë gjuhësore të shqipes, jo vetëm për faktin se ka bërë krahasime të para të kësaj natyre ndërmjet gjuhës së veprës letrare të Pjetër Bogdanit dhe veprës letrare të Naim Frashërit, por edhe për arsye se ky krahasim ka hapur kufijtë e kërkimit ndërmjet letërsisë biblike dhe letërsisë së romantizmit, dialektit të toskërishtes dhe dialektit të gegërishtes; letërsisë së latinitetit shqiptar dhe letërsisë së shkruar në ndikimin e letërsisë oksidentale e orientale etj. I kësaj natyre është edhe studimi i studiueses Luljeta Adili-Çelikut për formimin e fjalëve të përbëra në poezinë e Naim Frashërit, Aleksandër Stavre artikuj, vepra e konferenca shkencore, ndërsa studimet, monografitë dhe konferencat më me ndikim, parë në kontekstin kronologjik janë: Konferenca *Naim Frashërit. Vjershëtorit dhe edukatorit kombëtar*. Kushtuar me rastin e mbushjes së 25 vjetëve pas vdekjes së tij. Graz 1925; Dhimitër S. Shuteriqi, *Naim Frashëri. Histori e letërsisë shqipe për shkollat të mesme*. Tiranë 1955; Naim Frashëri. Në Historia e letërsisë shqipe II. Tiranë 1959; Jup Kastrati, *Naimi për gjuhën shqipe*. Shkodra, 1970; Jup Kastrati, *Naimi për gjuhën shqipe*. Studime filologjike, nr. 3, 1971; *Naim Frashëri* (Sesioni shkencor), Tiranë, 1972; Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Sesioni shkencor për Naim Frashërin). Prishtinë nr. 5, 1979; Dhimitër S. Shuteriqi, *Naim Frashëri. Jeta dhe vepra*. Tiranë 1982; Rexhep Qosja, *Porosia e madhe* (Krijimtaria letrare e Naim Frashërit), Prishtinë, 1986.

Drenova-Asdrenit dhe Lasgush Poradecit. Megjithëse të një periudhe jo shumë të largët kohore, të një dialekti (toskërishtes) dhe të një ndërndikimi nga vepra e njëri-tjetrit po edhe nga letërsi dhe kultura të ndryshme, autorja ka identifikuar mjaft veçori të përbashkëta dhe dallime të theksuara fjalëformuese ndërmjet Naim Frashërit në njërin anë dhe Asdrenit e Lasgush Poradecit në anën tjetër.


Në këtë kapitull tekstesh për gjuhën e veprave të Naim Frashërit hyjnë edhe studimet kur përgjithësuere, sikur janë tekstet e historianëve Gazmend Shpuza, *Naim Frashëri* për letërsinë dhe gjuhësinë iraniane dhe historianit Hasan Kaleshi, për veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit; e kur të veçanta, sikur janë studimet e historianit të letërsisë shqipe Mahmud Hysa, *Naim Frashëri si përkthyes i Kur'anit* dhe profesorit të orientalistikës Abdulla Rexhepit, *Shërbesat e Naim Frashërit* për gjuhën perse.

#### IV. Kërkime të fjalësisë dhe fjalëformimit në veprën letrare të Naim Frashërit

Studimet naimiane të viteve '30 marrin dimensione të reja edhe për një hulumtim pasaqërisht të veçantë në gjuhën e veprës së tij. Përbërësin e studimeve kur të përgjithshme e kur të veçanta të veprës së tij e pasurojnë studimet me orientim leksiko-semantik. Studimet e Kostaq Cipos, për leksikon e veprës "Istori e Skënderbeut", studimi pothuajse i papërsëritshëm i Nonda Bulkës, *Lokucionet në "Historinë e Skënderbeut"*, studimi i zgjeruar i Dhimitër S. Shuteriqit për gjuhën e Naimit, i cili në këtë kohë, sikur dihet u përmbyll me një *Fjalor të leksikut të veprës letrare*, për tu kurorëzuar tri dekada më vonë me një monografi, ndër më të mirat e kohës së tij për Naim Frashërin, përfaqësojnë tekstet referencë për shumë dekada. Studimet më qenësore të kësaj kohe dhe të kësaj natyre kanë të bëjnë me strukturën leksiko-gramatikore e leksiko-semantike të veprës letrare të Naim Frashërit.

Fjala është për studimet e Xhevat Lloshit, *Mbi përdorimin leksiko-semantik të mbiemrit tek "Istori e Skënderbeut" e Naim Frashërit* dhe paraqitjen e një veprë pak të njohur nga ato tekste të didaktikës shkollore të kohës *Një kopje e gramatikës së Naim Frashërit*. Në studimin e parë, theksi vihet tek denduria e mbiemrave, me përqendrim në tre kryesorët: a) kuptimi, b) sinonimia, c) antonimia e mbiemrave, ndërsa në tekstin e dytë, sillet një aventurë jo vetëm sfiduese e kërkimit të gramatikës së persishtes sipas metodës së re, si dhe e gjetjes së kopjes së saj elektronike në Bibliotekën e Michiganit, për botimin dhe vlerësimin e të cilës mbetet të merren studiuesit e brezit të sotëm.

Në këtë rrjedhë botohen edhe dy kërkimet themeltare gjuhësore të Engjëll Angonit, *Lakimi dhe ndërimi i gjinisë së emrave në numrin shumës te Naim Frashëri dhe Disa çështje të sistemit emëror në gjuhën e veprave të Naim Frashërit*. "Sistemi emëror në krijimtarinë e një shkrimtari dhe lëvruesi të madh të gjuhës shqipe, siç është Naimi, -shkruan Angoni - përbën një temë të gjerë e të larmishme, prandaj është përqendruar kryesisht në ato çështje që i janë dukur më me interes. Sa herë ka qenë e mundshme dhe e nevojshme, çështjet që trajtohen, i ka bërë objekt krahasimi me gjuhën e sotme letrare shqipe dhe sidomos me të folmen e Dangëllisë, në mënyrë që, krahas të tjerave, të vihet në dukje ç'ka të përbashkët dhe ç'ka të veçantë Naimi me këtë të folme, dhe, njëherazi, të dalin në pah, sadopak, përpjekjet e tij në përpunimin e normës letrare". Sado përshkruet të duket kërkimi mjaft shterues i pedagogut Mehdi Bardhit për *diminutivët dhe hipokoristikët te Naim Frashëri*, në këtë vëllim ai sjell një pasuri shkencore hulumtimi e krahasimi për studiuesit e rinj. I kësaj natyre, por me shtrirje më të gjerë kërkimi e krahasimi është edhe studimi i Ragip Mulakut, *Elemente të traditës gjuhësore (të shqipes) në veprën e Naim Frashërit*, të cilin e ka trajtuar edhe në raport me tekstet letrare e liturgjike të shkrimtarëve Pjetër Bogdani, Pjetër Budi, Frang Bardhi etj. Është me shumë interes dhe orientues për kërkimet e mëtejme studimore në fushë të terminologjisë, përkatësisht leksikon terminologjik dhe konceptet e Naim Frashërit për leksikon terminologjik, studimi i studiueses Hëna Pasho, *Naim Frashëri*, ashtu si edhe bashkëkohësit e tij të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, janë shquar për përdorimin e terminologjisë didaktike në fushë të arsimit, të




terminologjisë shkencore, e filozofike, prandaj vjelja dhe studimi i saj paraqet interes edhe sot në kërkimet tona shkencore. Ata që e kujtojnë letrën e Naim Frashërit për Vasil Terpon në Bukuresht edhe mund të mos pajtohen me vërejtjet e tij për të mos e përkrahur botimin e *Fjalorit të gjuhës shqipe* të Konstandin Kristoforidhit, sepse thoshte Naim Frashëri, Konstantin Kristoforidhi "ka marrë ca fjalë këtu-këtu nga një rradhua që ka bërë Hahni, po si ka as me rradhë, as të shumën", por ata që e kanë parë përkushtimin e tij në fushë të terminologjisë, mbase edhe do ta mirëkuptojnë shqetësimin e tij. Naim Frashëri me gjasë kishte krijuar dy koncepte për fjalësin e shqipes: i pari, që në fushë të letërsisë leksiku i shqipes duhej të ishte autokton dhe pasuri materiale e shpirtërore e popullit shqiptar; ndërsa i dyti, në fushë të leksikografisë, se fjalësi i shqipes duhej të ishte i zgjedhur, terminologjik dhe nënkuptueshëm shkencor, i krahasueshëm edhe me fjalorët leksikorë, do të shprehej ai, të popujve të qytetëruar. Në këtë rrjedhë, ne përjashtojmë idenë e përsëritur prej kohës në studimet gjuhësore e historiko-letrare, se ky kundërshtim i Naimit vjen si rezultat i mëniesë a zilisë për punën paralele që po bëhej në dy fjalorë të shqipes.

Studimet e kësaj fushe përmbullen me vëzhgimet përgjithësuere për karakterin leksikor dhe gramatikor të Naim Frashërit, nga studiuesit Behar Hoxhaj dhe Idriz Metani. I pari për veprën e Naim Frashërit si tërësi dhe i dyti me theks veprën "Istori e Skënderbeut", në veçanti. Sigurisht me njohjen e arritjeve të mëparshme dhe me dijen moderne shkencore të kohës sonë, këto dy studime sjellin qasje të re më këto tema.

#### V. Gjuha e veprave të Naim Frashërit dhe raportet e saj me dialektet

E ndërlidhur gjithnjë me trashëgiminë historike dhe me modernizimin e gjuhës si perspektivë bashkëkohore, vepra e tij letrare, përkatësisht gjuha artistike e realizimit të saj, është trajtuar edhe në kontekstin dialektor. Janë shumë studime në të cilat gjuha e Naimit është trajtuar në rrafshin dialektor të toskërishtes dhe janë në mënyrë të veçantë shumë studime e fragmente brenda teksteve dialektore, në të cilat gjuha e Naim Frashërit është ndërlidhur në kontekstin fonetik, gramatikor, leksikor e stilistik edhe me gegërishten.

Një studim të kësaj natyre mbi ndihmesën e Naim Frashërit për lëvrimin e gjuhës shqipe, duke e parë atë edhe në kontekstin dialektor dhe të krahasuar me bashkëkohësit e tij Kristoforidhin, Sami Frashërin etj., në këtë vëllim ka botuar profesor Shaban Demiraj, ndërsa ne këtu po i theksojmë dy përbërës, fjalorin: "Dëshira për të shkruar në një gjuhë të pastër e të punuar i nxiti ata që në radhë të parë të bënin përpjekje për ta njohur mirë fjalorin e shqipes së folur, ndërsa shkrimet e Kristoforidhit, të Naimit e të Samiut tregojnë qartë se sa mirë e njihnin ata gjuhën amëtare, të cilën e çmonin shumë"; të cilën e kurorëzuan edhe me ortografinë: "Pra, ortografia e shkrimeve të Samiut, të Naimit e të shkrimtarëve të tjerë toskë të shekullit të kaluar, ishte më tepër një ortografi fonetike; veçse në të ruajturit e zanores -ë në fund të



fjalëve proparoksite, e nganjëherë edhe në trup të fjalëve, ata ndoqën edhe parimin historik-etimologjik. Por ata nuk janë treguar gjithënjë konsequentë në ortografinë e tyre".

Pedagogu i përkushtuar i gjuhës në Prishtinë Prof. dr. Abdullah Zymeri, në këtë sinor ka shkruar rreth disa ndajfoljeve të kohës në veprat e Naimit, krahasuar me "Fjalorin" e Kristoforidhit dhe me disa të folme të Kosovës. Sistemin ndajfoljor kohor në veprat e Naimit Profesor Zymeri e konsideron shumë i pasur. Një dorë syresh Naimi, thekson ai, i përdorte me dy e edhe me tri forma, në mënyrë që të pasuronte edhe me këtë kategori gramatikore. Naim Frashëri sistemit ndajfoljor kohor, e ka haur më tej duke u mbështetur në brumin popullor e duke e përdorur atë përsosmërisht edhe në veprat e veta. Naim Frashëri, në dallim prej shkrimtarëve të tjerë, në krijimtarinë është ndikuar pak prej gjedhesh të huaja, ndryshe nga shkrimet tona, po edhe në mjetet e tjera të informimit, ku sistemi ndajfoljor kohor ka filluar të vërshohet me fjalë të huaja, megjithëse në disa të folme popullore ato janë të frymës së gjuhës shqipe, të gurrës së saj. Materialin e trajtuar këtu Profesor Zymeri e ka krahasuar dhe e ka kundruar në trekëndëshin - Naim Frashëri, Konstantin Kristoforidhi edhe me disa të folme popullore. I kësaj natyre është edhe studimi tjetër i Prof. Zymerit tani me shtrirje më të hapët dialektore, për fjalësin e burim të shqipes në veprat e Naim Frashërit krahasuar me disa të folme të Kosovës dhe të Malit të Zi.

Dy studime posaqërisht të karakterit specializues janë ato të Haki Ymerit, nga fusha e fonetikës dhe morfologjisë. E para ka karakter sintetik dhe merret me bazën dialektore (fonetike) të gjuhës së Naim Frashërit, ndërsa e dyta merret ekskluzivisht me një dukuri, natyrën e togjeve në gjuhën e Naim Frashërit.

#### VI. Tekste për gjuhën e tij dhe shqipen standarde

Po të bëhet një sintezë e teksteve përgjithësuere, artikujve publicistikë, studimeve me karakter të veçantë gjuhësor, studimeve krahasimtare brenda shqipes dhe në raport me gjuhët tjera, teksteve esistike e publicistike dhe madje atyre me përqendrim, poetikën e veprës letrare, nuk është vështirë të konstatohet se numri më i madh i tyre janë të ndërlidhur me pasurinë gjuhësore, që na e ka lënë në funksion të realizimit të ëndrrës së shumë brezave: shqipes standarde.

Studimet e kësaj natyre nuk i kanë shkruar vetëm gjuhëtarët, përkatësisht standardologët, po edhe pedagogët, publicistët, studiuesit, kulturologët, shkrimtarët, gjuhëtarët me përvojë modeste shkencore, përkatësisht dashamirët e gjuhës, studiuesit e thelluar me përvojë të gjatë kërkimore e shkencore etj. Numri i artikujve të kësaj natyre është i gjatë dhe i shumanshëm, për të shtuar se ata janë shkruar për përvjetorë të Naim Frashërit, për përvjetorë të gjuhës shqipe, të shkollës shqipe, të kulturës kombëtare, krahasuar edhe me kultura të tjera, të Rilindjes Kombëtare dhe bashkëkohësve të tij, të personaliteteve vendore e ndërkombëtare, të ndërlidhura me jetën, personalitetin dhe veprën letrare të tij, të familjes së tij etj.

Në këtë vëllim janë botuar vetëm ato tekste të cilat nxjerrin në plan të parë rolin e Naim Frashërit si personalitet unikifikues të brezit të tij dhe shumë brezave të tjerë deri në kohën tonë dhe rolin përkushtues të veprës së tij për një gjuhë kombëtare. Teksti më i hershëm i këtij kërkimi del të jetë artikulli i intelektualit, gjuhëtarit e historianit të letërsisë Karl Gurakuqi, sikur shprehet ai "për nevojën e një *Komisioni letrar*". Studimi orientues e themeltar i Profesor Idriz Ajetit, *Ndihmesa e Naim Frashërit* për formimin e gjuhës letrare shqiptare, do të mund të quhej themeltar edhe në këtë botim për arsye historike dhe shkencore. E para, autori i këtij teksti, Profesor Ajeti dhe idhujtari i tij janë bartës të një procesi historik të standardizimit të saj brenda dy shekujve të fundit XIX-XX, si dhe për arsye shkencore, identifikimit të përbërësve themeltar të shqipes letrare, brenda të cilit konstatonte se Naim Frashëri "vuri një gur të rëndë e me peshë në hartimin e teksteve të historisë kombëtare, po mbi të gjitha vinte gjuhën shqipe, për kujdesin dhe zotërimin e së cilës i porosiste shqiptarët, të madh e të vogël, gjithëherë e kudo, ta pasurojnë e ta pastrojnë atë. Për ata që ndaj gjuhës shqipe sillëshin shkuajdesur, për ata që gjuhën shqipe nuk e kishin gjithëherë në qendër të vëmendjes e që e trazonin me shprehje e fjalë të huaja, që e shëmtonin". I kësaj natyre është edhe studimi i Profesor Shaban Demirajt, *Ndihmesa e Naim Frashërit* për lëvrimin e gjuhës shqipe. Po këtu botohet edhe studimi i Androkli Kostallari, *Vepra e Naimit* për gjuhën letrare të kombit, brenda të cilit veç tjerash thekson se: "Shkrimet e Naimit, sidomos shkrimet diturore e mësimore, tregojnë se ai i njihte mirë arritjet kryesore të antropologjisë e të shkencës gjuhësore të shekullit XIX dhe çmonte drejt rolin e gjuhës në shoqërinë njerëzore. (...); Ai u la një trashëgim ta pakrahasueshëm breznive të sotme e të nesërme dhe një mësim të madh historik: gjuha ua zbulon vlerat e bukuritë e veta atyre që e duan dhe e nderojnë dhe ai që e do Atdheun e gjuhën amtare duhet t'u kushtojë atyre gjithë jetën e vet. Lëvrimi i shqipes ishte për të një kënaqësi e thellë, por edhe një mundim i madh, të cilin e njohin vetëm krijuesit e vërtetë"; Ky vëllim do të ishte i varfër edhe pa përfshirjen e studimeve të Jorgo Bulos, *Gjuha e Naimit: e tashmja dhe e ardhmja e shqipes; të Gjovalin Shkurtajt, Disa mendime të Naim Frashërit* për gjuhën, *Naim Frashëri dhe gjuha letrare shqipe, Naim Frashëri luftëtar për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe*, të cilin e përmbyll me sintezën largvajtëse: "Gjuha e Naim Frashërit është e pasur në fjalor, përfshirë këtu edhe leksemat e gurrës popullore dhe ato që ai i farkoi mbi gjedhet e saj, por është, gjithashtu, shumë e begatë dhe me vlera larmia e nuancave kuptimore që marrin ato në ligjërimin e tij poetik, prandaj, ai, edhe pas gati njëqind vjetëve pas vdekjes, vijon të mbetet, pa dyshim, poeti ynë kombëtar më frymëgjatë dhe më i lexuar"; të Valjer Peshkëpiajt, *Naimi dhe shqipja letrare*; si dhe Profesor Emil Lafes, *Porosia e Naim Frashërit* për gjuhën shqipe, e cila do të shquhet këtu veç tjerash edhe për sjelljen e një përshëndetjeje të indoeuropianistit të madh Holger Pedersen, në 100-vjetorin e lindjes së Naim Frashërit, të cilën po e sjellim edhe këtu: "Një gjuhëtar i huaj, që është mësuar ta dojë qysh i ri kombin fisnik shqiptar, është i gëzuar të bashkohet me këtë korale nderimi që i bëhet këtij apostulli të idesë kombëtare... si gjuhëtar ai e di plotësisht vlerën që ka gjuha amtare për jetën dhe zhvillimin e një kombi. Asnjë gjuhë nuk mund të lulëzojë pa një letërsi. Prandaj patriotët që kanë krijuar letërsinë shqipe janë nga bamirësit më të mëdhenj të popullit shqiptar. Dhe kjo lidhet në radhë të parë me Naim Frashërin. Kryeveprat e tij në prozë dhe në poezi u kanë dhënë shijen e leximit bashkatdhetarëve të tij dhe kanë nxitur të tjerët ta ndjekin këtë shembull të lavdishëm."; Të kësaj natyre janë edhe studimet e Remzi Nesimit, *Koloriti gjuhësor në poezinë e Naimit, Diçka rreth kontributit të Naimit* për shqipen letrare; të Tomor Osmanit, me dy artikujt për *Naim Frashërin dhe gjuhën shqipe*, si dhe *Naimin e parë nga aspekti gjuhësor*; Qazim Qazimit, për veprat e Naim Frashërit dhe gjuhën shqipe. Së fundi botohen dy nga kryestudimet, ai i Profesor Ethem Likajt me sintezën nga gjuha e Naimit te gjuha e sotme letrare si dhe ai i Profesor Valter Memisha për gjuhën e veprës së Naim Frashërit dhe shqipen standarde, parë në kontekst të zhvillimeve të sotme të shqipes letrare dhe të mendimeve njëshekullore për



vlerësimin e ndihmesës së tij për krijimin e shqipes standarde, të cilin Profesor Valter Memisha e ka parë në pesë përbërës: Së pari, Naim Frashëri, me krijimtarinë e tij që u realizua në fund të shekullit XIX (dhe që është e shtrirë pak më shumë se në 10 vjet) e ngriti në shkallën më të lartë ligjërimin letraro-poetik të kohës, i dha letërsisë dhe gjuhës shqipe përmasë të paparë deri në atë kohë. (...); Së dyti, Naim Frashëri me gjuhën e veprave të tij e kombëtarizoi shqipen, gjuhën e nënës. (...); Së treti, njihet tashmë se një nga tiparet cilësore të shqipes së sotme standarde është karakteri i saj i theksuar popullor, nga që ajo është ngritur mbi gjuhën e folur të popullit. (...); Së katërti, vepra e N. Frashërit e popullarizoi gjuhën letrare shqipe të përpunuar artistikisht, të pasuruar, të latuar e të zhërvjellësuar prej tij si askush deri kur ai jetoj dhe shkroi. Ajo ishte vepra më e përhapur dhe u bë vepra më e lexuar për kohën, çka ndodhi edhe për dekada të tëra më vonë (ashtu si vazhdon dhe sot!); Së pesti, Naim Frashëri krijoi në mënyrë bazale gjedhe pune për më tej në procesin për krijimin e shqipes letrare të njësuar. Ai tregoi se si një gjuhë mund të përpunohet letrarisht në një shkallë shumë të lartë dhe si mund të punohet që ajo të bëhet e të jetë shumëfunksionale. Në këtë linjë, theksojmë se ndihmesa e poetit tonë kombëtar shpërfaqet fuqishëm dhe e frytshme në prurjet e tij për të krijuar një strukturë të saj të përpunuar në të gjitha nënsistemet". (...). *Si përfundim*, Naim Frashëri i ngriti gjuhës shqipe përmendore të përjetshme. Ai është vetë shqipja dhe gjuha e sotme standarde e ka bërë të vetën pjesën dërrmuese të asaj që ai krijoi, por edhe gjedhet e pasurimit, të pastrimit, të përpunimit e të latimit të saj, të modeluara prej këtij biri të Frashërit e të mbarë Shqipërisë. Naimi jetoj pak e bëri shumë. Le ta kujtojmë atë, por le të punojmë përherë në mesazhin e tij të madh, ku janë shkruar në një tërësi të pandarë mëmëdheu, kombi, gjuha dhe njeriu: "Ndero mëmëdhenë dhe kombinë tënt edhe gjuhënë tënde... Më dashurë se kombi, më dhëmpshurë se mëmëdheu, më ëmbël, se gjuhë e ti s'ka gjë tjetër për njerinë")!

## VII. Poetika e gjuhës së veprës letrare

Nëse në artikujt publicistikë, kulturorë, normativë, deskriptivë e shkencorë për gjuhën e veprave të Naim Frashërit dhe të shqipes së sotme janë trajtuar këto marrëdhënie kryesisht në sensin iluminist, kulturor, e kombëtar, tekstet për poetikën e gjuhës së veprave letrare të Naim Frashërit janë shumë më koherente dhe më të arrira. Autorët e këtyre teksteve përveç me dijen për gjuhën si dije normative, si përmbajtje historike dhe si përpjekje për standardizimin e saj janë formuar edhe me dije elementare mbi probleme të stilistikës së gjuhës, të teorisë së letërsisë dhe të retorikës. Autorë të këtyre teksteve janë jo vetëm gjuhëtarët, por edhe studiuesit e thelluar në fushë të stilistikës së gjuhës, letërsisë, shkrimtarë me njohje akademike në fushë të teorisë së letërsisë dhe retorikës etj.

Siparin e këtyre teksteve e hapin: Skënder Luarasi, me mendimet e tij për gjuhën e edukatorit të kombit; Eqrem Çabej, me përcaktimin e vendit të Naim Frashërit në hapësirën europiane e ballkanike të romantizmit, si Lëvizje letrare e nacionale; dhe Aleksandër Xhuvani, me dy konceptet e tij për Naimin: "patriot i madh dhe edukator i popullit, (...) nuk është vetëm vjershëtor, por edhe prozator i mirë, që ka shkruar një gjuhë popullore të pastër shqipe, si pakë kush. Si e pamë më nalt, prej kësaj gjuhe të Naimit mund të fitojmë mjaft na sot, me gjithë përparimin që ka bamë gjuha jonë në këto kohë të fundit). Studimet vazhdojnë me studimet e thelluara nga studiuesi Rexhep Qosja me temat mbi zhvillimin dhe përsosjen e gjuhës nga Naim Frashëri, për tekste e shkruara në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, për rëndësinë e krijimtarisë gjuhësore të Naimit për gjuhën gjithëkombëtare. Le të thuhet këtu se Profesor Qosja në monografinë për krijimtarinë letrare të Naim Frashërit me titull *Porosia e madhe* (1986), pjesën më të madhe të saj ia ka kushtuar gjuhës së tij, vlerave stilistiko-gjuhësore të krijimtarisë së tij dhe strukturës teoriko-letrare e retorike të poezisë së tij. Prej leximit të këtij vëllimi, ndërkaq mund të shihet se Profesor Qosja është studiuesi më i cituar i teksteve të shkruara gjatë gjysmëshekullit që lamë.

Duke shkruar për gjuhën dhe stilin e Naim



Frashërit, Profesor Qosja ka shkruar për trajtat e ligjërimin, duke i parë ato edhe në raport me përmbajtjen, me mendimin, me fjalët e urta, me ndjenjën dhe veçoritë tjera të kësaj natyre, sikur janë: lavdërimi, urimi, mallkimi dhe lutja, pyetja retorike, thirrja dhe pasthirrma; duke shkruar për përsëritjet dhe radhitjet, ai ka shkruar për përsëritjet e tingujve e të fjalëve, po edhe përsëritjet anaforike, për ta përmblytur këtë diskutim edhe me çështjet tjera, sikur janë radhitjet lidhëzore dhe palidhëzore, si dhe përsëritjet si parim kompozicioni; duke shkruar për veçoritë gjuhësore e teoriko-letrare prej krahasimit deri te zmadhimi në veprën letrare të Naim Frashërit, Profesor Qosja, ka shkruar për trajtat e krahasimeve, për krahasimet e zgjeruara, për vlerat e krahasimeve për trajtat e cilësorëve, për vlerat e cilësorëve, për shtrirjen e zmadhimeve, për rolin zmadhues të leksikut, për shqiptimin si mjet zmadhimi, për marrëdhëniet e zmadhimit dhe të zvogëlimit etj.; duke shkruar për çështjet teorike të veprës letrare të Naim Frashërit, të cilat Profesor Qosja i identifikon nga metafora deri te miti, shkruan për metaforën, trajtat dhe rolet e metaforave, metaforat dhe frazeologjinë, simbolet, simbolet dhe shpirtëzimet, shtrirjen e mitit, figurat dhe prapakujtimet mitologjike, mitemat, mitet dhe botëkuptimin, si dhe rolin estetik të miteve.

Brenda këtij vëllimi është botuar i plotë kapitulli *Zhvillimi dhe përsosja e gjuhës*, në të cilin janë trajtuar çështjet gjuhësore si: gjuha kombëtare dhe fjalët e huaja, fjalët e reja të gjuhës diturore, fjalët plaka dhe krahinorizmat, shprehësia kuptimore dhe stilistike e fjalëve, rëndësia e krijimtarisë gjuhësore për gjuhën gjithëkombëtare. Në sintezën e madhe të monografisë së Profesor Qosjes, ndërkaq janë trajtuar edhe dy tema të rëndësishme për ndërtimin rrokjesor dhe ritmik të vargjeve në krijimtarinë letrare të Naim Frashërit. Në të parin janë diskutuar çështjet: vargu i tij dhe vjershërimi i përparsëm shqip, llojet e vargjeve, këmbimet e vargjeve të gjatësive të ndryshme, si dhe thyerjet dhe lidhjet e vargjeve; ndërsa në të dytin çështjet, si: larmia ritmike e vargjeve, bartjet dhe kapërcimet, rimat dhe strofat, prej trokeut deri te jambi, si dhe ndikimi në vjershërimin e mëvonshëm shqip.

Megjithëse është shkruar pas botimit të monografisë për Naim Frashërin, studimi i Profesor Qosjes për rëndësinë e krijimtarisë gjuhësore të Naimit për gjuhën gjithëkombëtare, në këtë vëllim enciklopedik shquhet për natyrën gjithëpërfshirëse të studimeve të kësaj fushe në veprën letrare të Naim Frashërit në studimet e kësaj natyre në përgjithësi dhe në studimet e Profesor Qosjes për Naim Frashërin në veçanti.

Në vazhdim botohen tekstet e studiuesve, si ai i Xhevat Lloshit, për fjalën shqipe në poetikën e Naimit, studimi i Sabri Hamitit për gjuhën poetike dhe përkushtimin; eseja e Profesor Ruzhdi Ushakut, "Fjalët e qiririt" si interpretim gjuhësor i frymëzimit dhe vizionit poetik, studimi i Vehbi Kadriut për frazeologjinë naimiane, trajtesa brilante e studiueses Shefkije Islamaj, Poezia "Qielli" e Naimit - një model i gjuhës poetike; trajtesat dhe parathëniet e Emil Lafes për ribotimin e poemthit "Bagëti e Bujqësia", leksikon e poemës

## VIII. Edukatori i gjuhës shqipe

Në personalitetin e Naim Frashërit historiografia, gjuha dhe kultura shqiptare kanë parë para se gjithash edukatorin e kombit, të kujtimit të tij personal e kolektiv, edukatorin e gjuhës së bukur, të vjershërimin të bukur tingullor. Fjala është për tekstet e Sevasti Qiriazi Dakos, me titull *Një pjeckje me Naim Bej Frashërin*; studimit mbi arsimin shqip të pedagogut Faik Ymeraj, me titull *Mësimi i gjuhës shqipe në Vlorë*, artikullit të profesorit Nexhat Abazi, me titull *Naimi mbi vlerën edukative të gjuhës amnore*, artikujve programatik të gjuhëtarit Qemal Murati, *Naim Frashëri - poeti që krijoi gjuhën dhe Gjuhëpruarit i Frashërit*; sintezës së madhe shkencore të filozofit Zija Xholi për iluminizmin, gjuhën shqipe dhe shkollën kombëtare, brenda të cilit përbërëset *gjuhë* dhe *iluminizëm* identifikohen qartazi: "Është e qartë se meritat e Naim Frashërit ndaj gjuhës shqipe janë të mëdha dhe të gjithanshme. Ai e shkroi atë dhe e bëri gjuhë të shkruar. Ai çeli shkollën kombëtare dhe e bëri atë gjuhë mësimi. Krijoi poezi dhe poema në gjuhën e bukur shqipe dhe hodhi themelet e gjuhës letrare të njësuar shqipe, atë gjuhë të shkruar që përdor edhe sot shkolla, letërsia, publicistika, shkenca dhe e gjithë kultura anë e mbanë vendit. Për rëndësinë e veçantë që ka gjuha letrare e njësuar shqipe ia vlen të ndalemi pak më gjerë. Në letrën dërguar De Radës, më 1881, Sami Frashëri midis të tjerash i shkruan për nevojën e një "gjuhe shqip të pandame e të njëjtë", një gjuhë ku "gjithë dialektet do të gjenden të gjitha të bashkuara e të përziera", me një fjalë, një gjuhë letrare të vetme e të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Mesazhin e Samiut, që ishte edhe mesazhi i epokës, e kapi Naimi dhe, si gjithnjë me intuitën e adhetarit, me një ndriçim gjenial, diti të zbulojë në pasurinë e dialekteve të gjuhës shqipe atë që është e qëndrueshme, e qenësishme dhe e bukur në to dhe nëpërmjet tyre arriti në një gjuhë të vetme, në një gjuhë letrare të njësuar. Atë e dha në poezitë dhe në poemat e tij të mrekullueshme. Në to, gjuha shqipe e Naimit nuk flet, por këndon, rrjedh e bukur dhe e pastër, siç rrjedhin ujërat e kulluara të burimeve malore që ai u këndon me aq pasion dhe talent".

Të kësaj natyre janë eseja e shkrimtarit të shquar Xhevahir Spahiu, për shpëtimtarin e shqipes, artikulli i Frymëzimit Dautit për Naim Frashërin dhe gjuhën e bukur shqipe, studimi ynë mbi Naim Frashërin, engjëlli mbrojtës i gjuhës, identitetit dhe shkollës shqipe; dhe shënimi i shkrimtarit Agim Shehu, për gjuhën amtare në kontekst të kujtesës së Naim Frashërit. Cikli i këtyre teksteve për nga ana kronologjike mbyllet me trajtesën shumëplanëshe të gjuhëtarit dhe profesorit Nexhip Mërkuri, me titull *Tingëllimi i bukur i fjalës naimiane* në mijëvjeçarin e ri, të cilën e përmblyllë me një rezultat përkimi me studentët në fondin leksikor të Naim Frashërit, sipas të cilit: "Fondi i pasur i mjeteve gjuhësore që janë përdorur për formimin e fjalëve, termave - fjalë, tipat e ndryshëm të kompozitave janë aktive e prodhimtare dhe në gjuhën e sotme. Prandaj del e nevojshme që t'i kthehemi dhe t'i rikthehemi kësaj pasurie, fjalëve të ndërtuara me mjetet e shqipes dhe sipas natyrës së saj. Ka fjalë që jehojnë papritur, që duhen rivlerësuar e duhen futur në përdorim me këndvështrimin si pasuri kombëtare".

Vëllimi mbyllet me dy dokumente të rralla, të cilat janë përgjigje për të gjitha ato që janë thënë për historinë e jetës së tij, të gjuhës së tij, të poetikës së tij, të stilit gjuhësor të tij, të misionit të tij, të mesazhit për të dhe sidomos për trashëgiminë që ka lënë. Fjala është për dy dokumente historike, me të cilat popullit shqiptar ia ka dhënë përgjigje kryeatit të tij të gjuhës, e këto janë dokumentet me të cilat ka kurorëzuar standartin më të lartë të gjuhës shqipe, një kërkesë e Naim Frashërit dhe rilindësve të tjerë për fatin e shqipes moderne sot. Janë sjellë të skanuara dokumenti i Delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimin të Gjuhës Shqipe dhe Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimin të Gjuhës Shqipe.

Le të thuhet së fundi, se botimi i këtij korpusi paraqet një vlerë të madhe shkencore me interes shumëplanësh për lexuesit, prandaj presim që Akademitë tona ta përkrahin kurorëzimin e saj sa më parë, jo vetëm për Naim Frashërin po edhe për rilindësit e tjerë.



Edhe librat kanë histori: histori të hartimit, nga autorët për rrethanat e krijimit, por edhe të botimit të tyre; ka me dhjetëra tregime që kanë mbetur në biografite e shkrimtarëve, të cilët, në ditë e fundit të jetës, i kanë mohuar veprat e shkruara, u janë lutur miqve të ngushtë t'i digjin ato, siç është Franz Kafka, shkrimtari bohem i gjuhës gjermane, i cili jo vetëm nuk arriti, me gjallje të tij, t'i shihte veprat, madje edhe i mohoi, duke porositur mikun e afërt Max Brod, t'i zhdukte ata....Tjetër janë shkencëtarë e gjuhëtarë të botës, veprat e të cilëve nuk e kanë parë dritën e botimit, sa ishin gjallë, por janë publikuar mbas vdekjes, si është lingusiti i shquar zviceran Ferdinand De Saussure, që në fillim të shekullit të kaluar mbajti ligjërata të lira në Universitetin e Gjenevës dhe u largua nga jeta, pa i botuar, ndërkohë që dy studentë të tij: Charles Bally (Sh.Bajy) dhe Albert Sechehaye (A.Seshe), adhuroes të profesorit të tyre, e përjetësuan librin e tij *Cours de Linguistique Générale* (Kurs i Gjuhësisë së Përgjithshme), duke e bërë autorin mjeshtrë, të cilit iu referuan dhe vazhdojnë t'i referohen të gjitha rrymat e drejtimeve e mëvonshme linguistike botërore.

Njëqind vjet më vonë, në ditët e sotme, del se njëri ndër shkrimtarët më të njohur në botë, nobelisti G. G. Márquez, jo vetëm që paskësh mohuar romanin "Shihemi në gusht", por kishte këmbënguluar të mos botohej...duke lënë edhe shënimin "Ky libër nuk bën. Duhet shkatërruar!"...Ndërsa botimi i njëkohshëm në gjuhët europiane, si ngjarje kulturore botërore... u prit me aq përjetim, sipas shkrimtarit të ri A.Dushi.

\*\*\*

Pak gjatë kjo hyrje, por, me dëshirën t'i afrohem sadopak metodës së mjeshtrit të bisedës dhe kulturës së gjuhës, prof. Shkurtajt, në hyrjet pindarike që bën ai, për njerëz e ngjarje, edhe kur merr e shkruan për një kuvend Malësie apo për peshën e fjalës shqipe, kryekreje, për verbin e shkrimtarëve tanë, në prozë e poezi, siç ka bërë deri më sot. Ai nuk mohon si Kafka e Márquezi, por si mbledhës i urtë i nektarit të gjuhës sonë gjithandej, si etnograf e kulturolog brenda vendit dhe në diaporën shqipfolëse, kërkon të gjenerojë edhe punë e studime të kohës së rinisë....gati para gjysmë shekulli. Ishin vitet kur Arsimi ynë i Lartë, në disa degë u themelua dhe mbahej kryesisht me specialiste e profesorë të huaj. Për disa disiplina në vitet 1970 në Institutin e Arteve (kështu quhej atëherë) pedagogu i ri Gjovalin Shkurtajt mbane leksionet e lëndës *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, një lëndë e domosdoshme dhe aq e pëlqyer prej shumë breza studentësh, të cilët do t'i demonstironin artritjet e kësaj disipline aq bukur e me nivel të lartë, edhe pse aktorët vinin nga treva të ndryshme dialektore të vendit, por edhe sepse kumbimi i fjalës normative gjuhësore para spektatorëve, jo vetëm në kryeqytet ku ndodhej Tatri Kombëtar, por edhe në shfaqje të zakonshme që trupa teatrore bënte nëpër qytete e krahina të Shqipërisë dhe jashtë kufijve tanë politikë. Gjatë këtij shkrimi se si m'u kujtua një vlerësim që pata dëgjuar prej aktorit të talentuar Rikard Ljarja për pedagogët që jepnin leksione të ILA.: "Ne kemi përfituar shumë prej atyre pedagogeve të vjetër e të rinj të Institutit të Gjuhësisë, që na dhanë mësim, sepse vinim prej gjimnazeve të ndryshme të vendit e përgatitja jonë gjuhësore nuk ishte si e sa duhej për skenën dhe sekuencat filmike që do të ndërtoheshin mbi artin e bisedës dhe dialogut spontan."

Në vijim të historisë së këtij libri, dua të nënvizoj se *Teori drame*, e prof. Gj. Shkurtajt është një kurs leksionesh me ligjërata të lira, siç dhe bëjnë rëndom lektorët e rinj në shkollat e larta: me skeda e shënime pikash të ndryshme, për të ruajtur argumentin e trajtuar, me vjelje të pjesshme e citime prej autorëve e veprave të tyre, kryesisht

## Gjovalin Shkurtajt, guhëtari dialektolog - ligjërues në Akademinë e Arteve për Teorinë e dramës

nga Tefë Topalli  
(Profesor Emeritus)

nga gjuhët e huaja, me gjithë vështirësitë që ishin krijuar në atë kohë ndryshimesh e zhvillimesh politike, sipas modeleve të Revolucionit Kulturor Kinez...Pedagogu i ri nuk arriti t'i botonte ligjëratat e kësaj lëndë as si dispensë për të gjithë studentët. Kështu ka ndodhur: kohët e fundit ai po u kushton shumë vëmendje mjaft botimeve universitare dhe akademike, me plotësime dhe risi që vetë shkenca jonë albanologjike i sjell të domosdoshme. Papritur, tregon autori i librit, më vjen një njoftim prej një ish-studenti pasuniversitar të ayre viteve, regjisorit Edmond Mëhilli, nga Shkodra, i cili paskësh ruajtur një palë leksione dhe ia dorëzoi menjëherë...


Libri *Teori drame* që kemi në dorë nuk është thjeshtë një kurs ligjëratash për aula në shkolla të larta speciale, siç quhej Instituti i Arteve, por përmbajtja e lëndës së trajtuar vjen më e gjerë dhe aq e plotësuar, sa na jepet të mendojmë, si ka mundësi që prurjet e shumta teorike të kenë ardhur prej një lektori të ri, siç ishte Gj. Shkurtajt në ato vite të mbylljes politike e kulturore që kalonte vendi ynë dekada me radhë. Autori nis me lindjen e kësaj gjinie letrare në Shqipëri, pal

Luftës II Botërore, për të kaluar në kuptimin e dramës në planin letrar, mbështetur në të dhënat e shkollës shqipztare, nga Lesingu, Gorki, Hegeli, Çernishevskij, Pushkini, Bjelinskij, Shekspiri, Serantesi, etj. Ai nje dhe na shfaq me hollësi traditat e gjinisë dramatike në letërsinë shqiptare, nga Santori, Çajupi, e kohë të mëvona. Sipas Shkurtajt, teatri duhet vështuar si formë arti me gjuhë dhe nëntekst të veçantë, me karakter veprues në shoqëri. Në shtjellime të tilla, argumentet gjejnë mbështetje tek emra të shquar të artit: nga L. Tolstoj, Stanislavskij, M.Gorkij, A.Çehovi, enciklopeditët francezë, Brehti, Esenstein-i, etj. Për t'u përgjigjur auditorit, kursi i ligjëratave përmban edhe ndryshimet mes teatrit e filmi, teatrit dhe televizionit. Informimet vijnë në fjalën e lirë të lektorit si nga lindja, ashtu edhe nga perëndimi; nga Majakovskij e nga R.Kleri, Nga Ibseni e nga M.Reinhardi; në mënyrë të veçantë autori sjell në këtë libër të dhënat nga arti skenik rus dhe sovjetik. Gjemë në këtë kurs leksionesh tema shumë interesante që edhe sot nuk e kanë humbur nevojën për t'u trajtuar, si *Teatri dhe drama*, ku njihemi me ndihmesën që kanë dhënë

kultura të popujve të ndryshëm, si anglezët, me veprat e Shekspirit, Bajronit, francezët me krijimtarinë e Bomarshesë, Hygoit, gjermanët me Shilerin dhe Gëtën, apo më parë me veprën e Lessingut "Dramaturgjia e Hamburgit" etj. Po kështu, shtjellime në një rrafsh të ngritur shkencor na vijnë për objektin e dramës dhe veçoritë themelore të gjinisë dramatike, konfliktin, tipat e kompozicionit dramatik në raport me kontradiktat jetësore në formacione të ndryshme sociale, duke e lidhur, sidomos, me realitetin shqiptar dhe më gjerë.

Në këtë shtjellim të lëndës, janë mjaft tema që i takojnë regjisorës, si: *ekspozicioni dhe nyja, skena si dyluftim, zhvillimi dramatik, skena masive, zhvillimi i karaktereve përmes veprimeve*, etj. Nuk duhet harruar se edhe në ligjërata si këto, duhej ruajtur e paprekur vija e kuqe e drejtimit letrar e skenik që sundonte në artin e realizmit Socialist! Përmbledhja e ligjëratave të autorit përfshin edhe tema për kulturën e përgjithshme të tyre, parë në vështrimin historik, si: nga Aristoteli, Gotthold E.Lesingu (me veprën enciklopedike "Dramaturgjia e Hamburgit"); pas tyre, duke ndjekur kronologjinë, sillen edhe njoftime të hollësishme për dramaturgjinë e Volkenshtejnit, Estetika enciklopedistit të madh francez, Didëroit dhe roamcierti e dramaturgut rus Leon Tolstoj.

Në kohën që qarkullonin këto leksione të pedagogut të ri, Gj. Shkurtajt në ILA, në vendin tonë ka pasur një tregues artistik shumë popullor: jepeshin aq shumë radiodrama, për kategori të ndryshme moshe e niveli kulturor, emisione që gozhdonin para radios qindra e mijëra njerëz, nga fëmijët nxënës shkollë, deri tek moshat e rritura. Ky mjet arti që lulëzonte me sinjalin "Teatri në mikrofon" e që më vonë u shndërrua në "Teatri në ekran" gërshetonte njëherësh *fjalën artistike, mjetet dëgjimore dhe muzikën dhe figurën televizive*, siç thekson autori ynë. Ka një pjesë përmblylëse libri i prof. Gj. Shkurtajt, që tërheq jo vetëm studentë profesionistë të ardhshëm të artit, por edhe lexues me kulturë të përgjithshme, që titullohet *Mikroleksikon për teatrin dhe dramaturgjinë* – është një segment (i quajtur *mbështetës*) nga f. 181 deri në f. 211, një hapërisë jo e lehtë për t'u mbushur me të dhëna nga antikiteti helen, si: nga filozofi Aristoteli, me tragjikët e mëdhenj të njerëzimit: Eskili, Sofokliu, Euripidi, Aristofani; me autorin që u përket të gjitha kohëve – *Shekspirin* e periudhës elisabetiane, francezin Didëro, që së bashku me J.d'Alambert-in themeluan "Enciklopedinë franceze", botën kulturore gjermanike, me G.Lesingun, Gëtën, F.Schiller-in dhe Hegel-in. Përfshihen në vijim: Ibseni, Shaw, Konstantin Stanislavskij, teatri moskovit, Belinskij, Chernyshevskij, dy *Tolstoj-t* e mëdhenj shkrimtarë, Meyerhold dhe gjermani i shekullit XX E.B.F.Brecht, i shkëlqyeri dramaturg i Republikës së Weimar-it, për t'u mbyllur kjo pjesë me figurën aq të njohur të teatrit amerikan Artur Miller, arti i të cilit ndikoi skenën dramatike gjatë gjithë shekullin XX. Fjalorthi terminologjik në fund të librit, i përket gjinisë së gjuhëtarëve, që e quajnë të domosdoshme të mos ndahen nga vepra pa lënë dorën e tyre në fushën e kërkuar. IRigetja e kësaj përmbledhjeje me ligjërata, është si një takim me vetveten, ku akademiku i sotëm, do të na tregojë se është po ai i para gjysmë shekulli, veç më me dëshira për punë, ritëm më të lartë dhe më i realizuar shkencërisht: botimi i këtij libri, në sinergji të dy moshave të autorit, e vërteton këtë më së miri.... Do ta vërtetojë edhe lexuesi, fletë pas flete dhe sapo t'i shkojë në fund *Teorisë së dramës*.



Fati i njeriut është i lidhur mgushtësisht me aktet që kryen në jetë, përkundër fati i shkrimtarit, mbruhet dhe jeton në veprat e shkruara. Privilegji i artistit dhe shkrimtarit, që varësisht vlerave ta kapërcejë harkun e jetës, shoqërohet me udhëtimin e tij në rrrathët e ferrit, si një shkrim që projektoi parajsën të cilën e shijon lexuesi në çdo kohë. Ligjërata, që ka në qendër natyrën dhe ngjyresat e krijimtarisë letrare të Agim Gjakovës, nuk merr përsipër portretizimin e njeriut, krijuesit, por vetëm sa do të hedh penelata të shpejta, më tepër për të zgjuar kureshtjen e lexuesit, që të rikthejë vëmendjen nga tekstet e shkruara në kohë të ndryshme, gjithnjë duke u bazuar në sugjerimin se: hapësira letrare është kujtesa e njerëzve. , C Clark. Megjithatë, në gamën e gjerë që ngërthen, tashmë si një dukuri letrare e formësuar në motet dyshekullore, vëmendja jonë do të përqëndrohet në disa aspekte:

A – Kush është Agim Gjakova?

B – Dimensionet e shkrimit letrar

C – Dykohësia e letrares së autorit

Çështja e parë, jo rastësisht nis me një pyetje retorike, se kush është Agim Gjakova. Jeta e gjatë, e mbushur me pengime dhe peripeci të shumta, burgimet, spiunimet dhe sidomos shtegtimet në hapësirat shqiptare, dhe po ashtu, qenësia e tij si qytetar i botës, siç e thotë shpesh vetë, na fusin në ngasjen për të parë elemente që nuk i kemi vënë re, të cilat lidhen me rrethanat e mbrujtjes së materies letrare. Agim Gjakova, si dhe bijë të tjerë të Kosovës, si Selman Riza, Adem Istrefi, Sadri Ahemti, e dhjetra poetë, piktorë, shkencëtar e gazetarë, u detyrua që të ikte nga Kosova martire, e të vinte në Shqipëri, me gjasë në shtetin amë, që megjithatë në jo pak herë, doli njerë. Në vitet '60, të shekullit të kaluar, kur realizmi socialist, i kishte konsoliduar pozitën e veta, në skenë vjen brezi i poetëve si: F. Arapi, D. Agolli, I. Kadare, A. Shehu, e në ato fillime edhe Gjakova përmendje me emër në radhën e kësaj breznie. Pastaj, si shumë të tjerë, poet dhe shkrimtar të kohës, hyri në pjesën e fundit, pikërisht në sintagmën memece, etj. , ku ishte dhe nuk ishte. Pastaj u dyshua, pastaj për një kohë të gjatë u la në heshtje, mbeti jashtë asaj liste. Përse u nder ngrica, heshtja e gjatë, ndaj veprës letrare? Ky në fakt është fati i mbrapshtë që ka shoqëruar me qindra shkrimtarë, sepse në kohë të ndryshme, autorët dhe tekstet dalin tepër. Varësisht konteksteve, kur shfaqet dhe formësohet krijimtaria letrare e autorit, ka jo pak shkaqe, "të ndalimit" të pashpallur, që më së shumti fle në dosjen, ku gëlojnë gjurmuesit e biografive, por në mesin e tyre do të nënvizojë, se Agim Gjakova, vinte më një botë të vetën, me dhimbjen e ikjes nga trojet e përgjakura, madje me vetëdijen gjuhësore dhe letrare dhe prandaj nuk kishte shumë mundësi të bëhej pjesë e modelit të shkrimtarit të ri, pjesë dhe mekanizëm i modelit zyrtar të realizmit socialist. Në përpjekjen sizifiane për të qenë pjesë e letërsisë zyrtare, e ngjyresave të realizmit socialist, ma tepër dështoi, me vetëdije, ndonëse nuk i shpëtoi ngasjes së botimit të librave edhe në atë hark kohor, shtysë dhe ëndërr e secilit shkrimtar. Jeta e Gjakovës, në kuptimin e parë, është e lidhur me shkrimin, ku ndërkaq në materien tekstore, mbizotëron shkrimi letrar, si në një udhëtim imagjinar, shqiptuar në morinë e librave.

#### Dimensionet shkrimore

Marrëdhënia me shkrimin, e veçmas me letërsinë, qysh në krye të herës, vepra e gjerë shkrimore e autorit, ka zgjuar interes tek lexuesi, e po kaq ka tërhequr vëmendjen e kritikës dhe studimeve letrare, për risitë e ligjëritimit dhe të shprehësisë, për lavrimin e gjithë zhanreve letrare. Parapëlqimi i vlerave, të teksteve të shkruara, së pari

# Agim Gjakova dhe dykohësia e shkrimit letrar

Nga Behar Gjoka

lidhet me larminë, e po kaq ndërthuret me zërin e një krijuesi të paepur, që megjithatë duhet lexuar ndryshe, më përtej skemave të akademizmit didaktik, çka shpaloset në fjalët e Harold Bloom, kur nënvizon: Më ka ardhur në majë të hundës çfarëdolloj argumenti që ndërthur ëndjen e leximit vetmitar me të mirën publike. (2008: 15), pra vetëm si lexim teksti. Laryshia e shkrimit, lidhet ngushtësisht me morinë e veprave, të botuara ndër vite, ku lehtësisht përveçohen:

Së pari: Poeti që ka shpërfaqur përmasat e plota të epikes dhe lirikes, madje të një sintagme të përveçme ligjërimore, gjuhësore dhe estetike, e cila shenjëzohet në nëntë vëllime poetikë. Poezia në trashëgiminë e shkrimtarit, shënon fillesat e shkrimit letrar, në motin e largët 1962, me vëllimin ... dhe thonë se paqë ka në botë, megjithatë në gjithë vitet poezia ka mbet shenja parake e krijimit, si me thënë vijon, që të mbetet dashunia e parë, në lidhje me artin e fjalës.

Së dyti: Prozatori i veçantë, i cili ka shkruar për të rritur dhe fëmijë, e që madje ka lëvruar të gjitha llojet letrare, ndonëse me anësim dhe kualitet të përveçëm, shpërfaqet në lavrimin e tregimit dhe romanit, porse kohëve të fundit me një shkëlqim të vetin në tipologjinë e shkrimit të romanit, ku madje zbulohet botëpreceptmi i marrëdhënies me atdheun, kombin dhe njerëzimin, si një qarkëzim anazor, të fatit të universitetit të qenies. Në zhanrin e romanit, shpaloset sendërtimi i tipit klasik, realist, satirik, modern, gjë që dëshmohet qartësisht në romanin e fundit, Shtegtimi i ëndrës, botuar në 2018.

Së treti: Lëvruesi i dramatikës, si autor dramash dhe skenare filmash, ndonëse janë me më pak tekste se sa në dy modelet e tjera shkrimore, çka përplotëson konturet e shkrimtarit që ka jetuar në letërsi dhe për letërsinë, duke dhënë kontribut në tipet dhe zhanret e ndryshme.

Së katërti: Pjesë unike e shenjave shkrimore, që madje shpalos njeriun aktiv, intelektualin që jeton me shqetësimet e kombit dhe të shoqërisë, është edhe publicistika, e cila shtrihet ndër vite, të dy shekujve. Kryefjala e publicistikës është Kosova martire, fati i saj nën thundrën e pushtimit serb, po ashtu aty përshkruhen dritëhijet, e kohës së lirisë dhe të pavarësisë. Krahas temës së Kosovës, në publicistikën e Gjakovës, gjen vend gjerësisht edhe problematika e mprehtë e demokracisë dhe shoqërisë shqiptare, duke u kthyer në një trajtues mendjehollë i proceseve demokratike, në të dyja Shqipëritë, në atë londineze dhe euroatlantike.

Në mesin e teksteve shkrimore të tij, vetiu spikatet letërsia, e në mesin e librave ku sendërtohet mjeshtëria artistike, veçohet poezia dhe proza, e ndërkaq të dyja kanë udhëtuar bashkarisht e madje, janë dy anë të medaljes së shkrimtarit Agim Gjakova, me vokacion të rrokshëm, si poet dhe prozator.

#### Dykohësia e letrares së autorit

Termi dykohësi nuk është një përcaktim formal, që është shkrimtar që ka shkruar në dy kohë, por më tepër synon që të



hetojë estetishtë krijimtarinë e autorit, që shëmbëllen dykohësinë si ligjëritim letrar koherent. Varësisht teksteve të botuara, në sy kohë, së pari nën detyrimin e modelit të realizmit socialist, si dhe në kohën e lirisë nga diktatura, në Shqipëri dhe nga pushtuesi serb në Kosovë, është një përpjekje për të cekur vijimësinë e shkrimit, praninë e hijedritave, e sidomos për shijuar dëshminë kreative që ngërthejnë veprat e Gjakovës. Të shkruash në dy kohë, madje në dy kohë thelbësisht të ndryshme, është një situatë e ndërlikuar, me gjasë një sprovë e vështirë, letrare dhe jo letrare. Nga njëra anë është loja për tu përkshatur, me rrethanat e reja, pra të rishkruash, të ndryshosh kahje ligjërimore e kuptimore, gjer në përmbyse, gjë që ka ndodhur me jo pak shkrimtar, do të thotë të ndryshosh kaq shumë sa të mos njohësh veten. Kjo në letërsi shënon tjetërsimin, përmbyse e mëtimeve autoriale, që përgjithësisht e kapërcejnë kohën shkrimore. Në anën tjetër, të mbetesh vetja në shkrimin letrar, që ka të bëjë me "fajësimin" pa faj, të kohës së censurës dhe vetëcensurës, që në kohën e lirisë rrezoi nga fronti jo pak zota, të pushtetit dhe jetës kulturore dhe letrare, me shumë mundësi është përpjekja për të hetuar shtegtimin real, të letrares së materializuar nga Gjakova. Në veprën e gjerë letrare, e sidomos në poezi dhe prozë, krijimtaria e Gjakovës, i përkon "honeve" autoriale, ku kohët kanë lënë gjurmë, por ndërkaq nuk ia kanë cënuar esencën e brendshme kreative, unin e shkrimtarit që projekton lirinë, si një atribut që kërkon sakrificë. Ngjizja e amzës letrare, në toposin e botës autoriale, vjen e shqiptuar në dy kohët:

- Si një zë tjetër, me shenjë të dukshme mëvetësimi, në periudhën e parë, ku boton libra me poezi dhe prozë, pavarësisht faktit që janë botuar vëllimet me poezi ... dhe thonë se paqë ka në botë 1962, Këngë e Drinit të Bardhë, 1967, Perspektivë, 1972, Obelisk, 1985, si dhe vëllimi me tregime për të rritur, Nën hijen e pavdekësisë, 1983, me tregime për fëmijë, Vjen përroi, 1979, me romanet Në kërkim të së vërtetës, 1976, Dritëhijet e një qyteti, 1982, si dhe tre skenar filmash.

- Si vijimësi e tonalitetit të vetë, në tematizimin e kohës, në qëmtimin e ligjëritimit modern, ku veçohen librat me poezi, I gjuaj ëndrrat me gurë, 1995, Guxo e vdis, 1998, Deti, 1998, Kufiri imagjinar, 2003, Saga flurore, 2008, si dhe vëllimi me tregime Shtëpia në udhëkryq, 2003, romanet Herezia, 2006, A ka kund Zot, 2009, etj. , . Loja e kafkave, Korridorët e gjelbra, Mëhalla e kolegëve, Rrëfimet, për të ardhur deri të romani Shtegtimi i ëndrës, botuar në 2018. Në periudhën e dytë janë botuar gjithsej njëzet tekste, e shumica prej tyre janë romane, të cilat sendërtojnë "Shëmbulltyrat e negativitetit ekzistencial, bazë e një pjese të madhe të letërsisë bashkëkohore..."(2000: 27, Leksione Amerikane) të pohuar nga Italo Kalvinos.

Megjithatë, me rëndësi është fakti që të verifikohen kahjet ligjërimore, në të dy kohët, e dëshmuar në materien letrare, të poezisë dhe prozëshkrimit, ku veçohet fakti që në periudhën e dytë, në qiellin e lirisë janë botuar me shumë tekste dhe, në shijen time shënojnë nivel më të ngritur të shenjave letrare.



Lexoj se për kohën para moshës shtatëvjeçare shumë pak gjëra i mbajmë mend dhe është e paqartë nëse me të vërtetë kujtojmë ndonjë gjë apo janë thjesht rrëfimet e të tjerëve që na janë ngulitur në mendje. Përshtypjen se kujtojmë vetë diçka na e përforcojnë edhe fotografitë e asaj kohe të hershme të jetës, fotografi që shpesh i shoqërojnë rrëfimet e të tjerëve për fëmijërinë tonë. E lëshoj librin ngadalë mbi tavolinë dhe ngulis sytë në peizazhin e varfër para meje, nis të kthehem prapa në kohë, në fëmijërinë time aty ky zënë fill kujtimet e para – jam pesë vjeçe, por s' mund të jetë rrëfim i tjetërkujt, perspektiva është imja, ngjarjet zhvillohen para meje e realiteti prodhohet prej meje, në këtë tablo mungoj pikërisht unë, jam e tëra sy, ndjesitë janë aq të forta e imazhet aq të qarta sa s' më duket që kujtoj ndodhi të tjera të mëvonshme me të njëjtën përpikëri:

Është mbrëmje, saktësisht ora 19:30, të gjithë janë tërë sy e vesh para televizorit, s' pipëtin asnjëri, prej tij vjen një zë gruaje, përhapet nëpër dhomë, është i pakëndshëm, më duket se ngjason me zërin e mamit kur na qorton mua dhe vëllanë. Ne të dy po luajmë me fije shkrepëse, kemi ndërtuar dy shtëpi të bukura e të larta e tash po e stisim edhe një rrugë, herë pas herë këqyri gruan në televizor dhe kthej shikimin kah babi, nuk e kuptoj se si mund t' i bëjë kaq shumë përshtypje; është e njëjta grua çdo natë dhe më duket se i thotë gjithmonë të njëjtat fjalë që unë s' i kuptoj, s' kuptoj as pse e këqyri kur s' u pëlqen, të gjithëve u prishet fytyra dhe pëshpërisin kur përfundon. Mua dhe vëllait, kur këqyrim filma vizatimorë, fytyra na buzëqesh, nuk vrenjtemi si ata. Vëllai, gjatë hutimit tim, m' i ka marrë disa fije shkrepëse, e qortoj, babi na thotë të mbajmë qetësi pa e shkëputur shikimin prej gruas në televizor, biem në ujdë dhe vazhdojmë ta zgjasim rrugën. Papritmas shtëpia dridhet, diçka gjëmon jashtë dhe fijet e shkrepësës përzihen, diçka që babi e quajti luftë, sulm, bom..., e plot emra që s' i mbajta në mend, na e prishi lojën. Të gjithë brofën në këmbë e dolën jashtë të shihnin se çfarë kishte ndodhur, u kthyen brenda me fytyra të zverdhura. U sula drejt babit të më tregonte se çfarë po ndodhte, por mora urdhër ta vazhdoja lojën ose të shkoja të mami. Nuk më luej më, ajo gjëja luftë na kishte prishur gjithçka që kishim ndërtuar. Shkova te mami, në dhomën ngjitur, ishte ulur në dysheme dhe po tëhollonte bukë aq shpejt sa që m' i mori mendtë, kishte shumë bukë, kurrë në jetën time s' kisha parë aq shumë bukë. U ula në divanin përballë saj dhe fillova t' i numëroja bukët, dija të numëroja veç deri në dhjetë dhe herë pas here më duhej t' i rikthehesha numërimin nga njëshi, mami ndërkohë ngritte kokën dhe shihte e shqetësuar kah dritarja që ishte prapa meje. E pyeta shumë herë se kush mund t' i hante të gjitha ato bukë, e pyeta se mos po gatuate për ndonjë gjigant që e mbanin të fshehur prej meje, apo do të vinte axhi t' i merrte. Ai nuk jetonte me ne – ishte ndryshe prej nesh - jetonte në mal, nuk vishej si ne – kishte rroba të çuditshme të gjelbra me ca njolla, madje as nuk ishte i pastër si ne, çizmet e tij ishin plot baltë, njëherë fshehurazi desha t' i mbathja, ishin aq të gjata e të rënda sa mezi nxora këmbët prej tyre, edhe duart i kishte të fuqishme, sa herë e shihja të vinte vrapoja drejt tij, më kapte dhe më hidhte lart në ajër. Por as nuk hante si ne; ishte i babëzitur dhe gjithmonë mbushte çantat plot ushqime para se të ikte. U binda se vetëm axhi mund t' i hante tërë bukët që po i gatuate mami kur u dëgjua sërish një gjëim i fortë, mbylla veshët me duar dhe rrudha sytë fort, kësaj here nuk u drodh veç shtëpia, ndjeva se diçka e fortë po më godiste në kokë e në shpinë. Dikur ra qetësisht, por s' guxoja t' i hapja sytë; diçka e keqe kishte ndodhur, ndjeva duart e mamit që po m' i kapnin të miat e po m' i largonin nga veshët, më pyeste në isha mirë, hap

# LUFTA

Tregim nga Adelinë Selmani



sytë ngadalë dhe pashë se bukët ishin mbushur me cifla xhami, pashë rreth e rrotull meje, kishte copa xhami ngado, mami më kapi me të dyja duart dhe duke vrapuar, me mua në krah, çau për nga dera, u ndeshëm me babin, e hakërryer i tha: ken' t' u e vra çikën. E kuptova se ajo gjëja luftë jo vetëm që ma kishte prishur lojën, por edhe mund të të vriste. Babi më kapi rrëmbimthi në krah dhe u nis para, hymë në bodrumin e shtëpisë. E urreja atë vend, kishte pluhur, ishte shumë errësirë dhe shpesh me vëllanë kishim parë edhe minj e plot insekte. S' doja të rrija aty, por s' guxoja të bëja zë, diçka e çuditshme po ndodhte. Vëllai kishte shkuar më herët, madje kishte arritur t' i merrte edhe kutitë me fije shkrepëse, ishte ulur në batanije dhe kishte filluar sërish të ndërtonte shtëpi, më ftoi të vazhdonim lojën, u ula afër tij dhe në vesh i pëshpërita se nuk doja të luaja më, i thashë se lufta ishte ajo gjëja që gjëmonte dhe mund të të vriste, ai ndaloi dhe më pa me ca sy që shprehnin hutim e që tregonin se s' po merrte vesh gjë, vazhdova të flisja ngadalë që të mos më dëgjonin të rriturit dhe m' u duk se zëri im filloi t' i ngjasonte gruas në televizor, mendova se ndoshta edhe ajo fliste për luftën, prandaj tingëllonim njëjtë, i thashë se lufta desh më vrau, se na i kishte mbushur bukët me cifla xhami e s' do të mund t' i hanim as ne, as axhi. Shikimi i tij u turbullua edhe më, më këqyri gjatë e dikur ma zgjati një fije shkrepëse, atëherë iu hakërreva se unë s' isha më e vogël të luaja. Të nesërmen e lamë shtëpinë, ngarkuan në rimorkion e një traktori miell e batanije, por s' na e morën asnjë lodër, vëllai u çor e qau që s' mundi ta merrte arushin me të cilin flinte çdo natë, ishim ulur ngjitur, futa dorën ngadalë poshtë këmbës së tij, duke parë se mos më shihte ndonjë ia shtrëngova me thonj mishin fort e nëpër dhëmbë i thashë se duhej të bënte çfarë bëja unë e të rritej siç isha rritur unë. E mora përdore e u ulëm bri kanatave të rimorkios, shikonim

qenin tonë që na vinte pas, ai na ndoqi një copë rrugë, dikur me sy të përplotur na pa e ndaloi vrapin, i urreva të gjithë që po e linin në atë gjënë luftë që prishte lojëra e mund të të vriste. Nuk m' u hoq nga mendja gjatë gjithë ditës dhe u pendova që s' kërceva ta merrja. Por, kur erdhi mbrëmja e harrova dhe as e kujtova më për ditë të tëra. Ishte mbrëmja më e errët që kisha parë, nuk kishte yje, as hënë. Disa njerëz që ishin veshur ndryshe e që mbanin armë në duar, na mblodhën në një fushë, ishim shumë-shumë, nuk mund të shihja sa shumë, por dëgjoja zëra, të qara fëmijësh, britma. Një fashë drite e fortë binte herë pas here mbi turmë, dy njerëz që nuk flisnin si ne, tërhiqnin zvarrë një burrë dhe pas pak çastesh dëgjohej një krismë, u përsërit shumë herë e njëjta, pas zvarritjes dëgjohej krisma, pastaj britma e të qara grash, e kuptova ç' ndodhte, ata njerëz ishin ajo gjëja luftë, ata po i vrisnin burrat. Frika ma rrënqethi mishtë e drithëroi krejt trupin, pashë nga babi, i brita duke dënesur të fshihej, ika nga duart e mamit dhe shkova u ula në prehrin e tij, nuk doja ta merrte lufta. Duke u dridhur iu përgjérova të fshihej, ai qe topitur, fytyra e tij s' kishte kurrfarë shprehjeje, as nuk nxirrte zë. Tërë natën trupi më kërceu e më dukej se më shumë se britmat e krismat dëgjoja rrahjet e zemrës sime që s' kishin qenë kurrë aq të forta, tërë natën iu luta dikujt që mami e quante zot e besonte se na i dëgjonte lutjet, iu luta të mos e shihnin babin, e mallkova veten se pse s' isha rritur më shumë ta mbuloja me trupin tim, por mund të bëhesha më e madhe, nëse ajo fashë drite do të binte mbi ne, do të ngrihesha në këmbë, në majë të gishtërinjve e do t' i hapja duart, kështu ata s' do ta shihnin, s' do të ma merrnin. Dridhesha, dënesja dhe s' mund ta kuptoja pse ai ishte aq i qetë, dikur mendova se mos edhe ai donte të ikte prej nesh. Jo, unë s' do ta lija kurrë, iu ngjita me të dyja duart për kraharori dhe e shtrëngova me sa fuqi pata,

ashtu ndenja tërë natën, e nata ishte pafund e gjatë, s' e kisha ditur kurrë se sa të gjata ishin netët. Dikur, një prej luftës tha diçka me një zë që çirrej, s' kuptova ç' thoshte, por për herë të parë babi u përmend, mori frymë thellë, dhe kjo qe ngjitëse, të tërë pas tij u përmendën. Kishte marrë fund! I pëshpërita vëllai, që s' kuptonte gjë, se lufta mori fund. Ai më pa sërish i hutuar, pa e kuptuar se ç' po flisja dhe nuk bëzajti, iu afrova edhe më shumë dhe i thashë se ai vazhdonte të ishte bebe dhe s' kuptonte gjë. Atëherë ai filloi të qante e t' i ankohej mamit, ajo u kthye kah unë dhe më kërkoi që të mos e ngacmoja vëllanë. I thashë se ai duhej të rritej si unë, se tashmë e kishte parë me sytë e tij luftën. Mami s' ma vari veshin, u bëra hundë e buzë që s' e kuptonte që unë isha rritur... Kur fijet e para të dritës ranë mbi ne, m' u duk se kisha parë një ëndërr të keqe. Vëllai i qe ngjitur mamit për gjoksi dhe po flinte i qetë. Me të në krah, ma kapi dorën e u nisëm drejt traktorëve që ishin buzë rrugës, dëgjoja se po niseshim për në Shqipëri, s' dija ç' ishte Shqipëria, as ku i binte, as sa larg ishte, veçse dija që ishte një vend ku s' kishte net të tilla. S' iu shqita kurrë më babil, u ula në prehrin e tij ndërkohë që ai voziste, s' e pyeta kurrë asgjë, se kështu bënin të rriturit, ata s' bënin pyetje, kuptonin vetë gjithë çka ndodhte. S' doja as të haja, as të pija, kisha vendosur të mos i ndahesha, s' do të lejoja as të ma merrnin e as të ikte prej meje. Udhëtuam për ditë të tëra, dëgjonim krisma të luftës dhe e dija se dikush vritej, shihja njerëz që i hidhnin skajeve të rrugës, pashë edhe nga ata që ishin lufta, ishin të këqij, të shëmtuar, edhe gjuha e tyre më ngjasonte me luftën. Na ndalnin kohë pas kohë e mua më kaplonin drithat e frika si në atë natën e gjatë, por kurrë s' nxirrja zë, kurrë s' qava, as u ankova që më ishin mpirë këmbët duke ndenjur vetëm në njërin këmbë të babil, doja ta kuptonte edhe ai që unë isha rritur.

Një ditë, që qe më e qetë se të tjerat, babi hapi gojën për herë të parë, më pyeti në e dija pse axhi ishte ndryshe dhe jetonte ndryshe, i thashë se dija pak dhe ktheva shikimin në anën tjetër, s' doja ta diktonte që nuk dija gjë e të dukeshja si vëllai që s' kuptonte as ç' ishte lufta. Më tha plot fjalë që s' i kuptoja, e unë skuqesha deri tek veshët nga inati, por mësova që ai ishte UÇK. Ai po luftonte për ne, që ta largonte luftën nga shtëpitë tona. U ngazëlleva, s' kisha pse të frikësohesha më, s' do të vdiste askush! Tashmë kisha një superhero! Ai do të vinte të na shpëtonte! Atëherë e lashë zotin që i lutej mamit dhe lutjet e mia ia drejtova axhit, tashmë e dija që diçka e quajtur UÇK mund të të mbronte dhe të të shpëtonte. Ajo gjëja UÇK ma riktheu ëndërrën që ma mori lufta - atë ditë guxova të ëndërrroja për herë të parë se isha në shtëpi, babi po më mbante në prehër, ndërkohë që e shihte atë gruan në televizor, e herë pas here m' i përkëdhelte faqet. Më kishte marrë malli edhe për gruan e televizorit, ajo bënte të mblidheshim e tërë familja. Për çudi, pikërisht atë ditë, ndjeva përkëdheljen e dikujt në faqen time - s' ishte e babil. Një nga ata të luftës, u afrua te kabina ku ishim ne të dy, i foli babil në atë gjuhë si lufta, babi iu përgjigj në të njëjtën gjuhë, u habita se si nga goja e babil mund të dilnin fjalë që tingëllonin aq keq, si duket atij të luftës nuk i pëlqeu çfarë tha babi; mbështeti tytën e revolverit në fytyrën e babil dhe me të i ngriti kokën lart, mua filluan të më rridhnin lot faqeve, po lutesha që një UÇK të dilte nga mali e të na shpëtonte, mudohesha të mos pipëti, m' u mblodh një duq në fyt e shpërtheva, ai ktheu sytë nga unë, e tërhoqi revolverin ngadalë e e fshehu pas shpinës së tij, e urdhëroi babin diçka dhe ma ledhatoi faqen. Kur e tërhoqi dorën, e gërreva faqen me thonj - s' doja të më prekte lufta. Babi më pa, i shkoi buza në gaz, e kaloi gishtërinjte lehtë edhe ai mbi faqen time, si për t' i fshirë gjurmët që lufta po linte në mua.

Deri atë mbrëmje, Ajo ishte thjesht njera nga Ne.

Shumë-shumë mezi mund të vërehet nja dy-tri gishtërinj më e gjatë, ose kështu e rrëfenin këmbët, nëse jo thjesht ajo pjesë e gjunjëve që zbulohet prej dallgëve të fustanit veshur asaj mbrëmjeje po aq të pafajshme pranverore.

Tërë kjo mbresë mbeti prej asaj çfarë ndodhi tekta ajo, Frida, u pa për herë të fundit përmes "Bermudës" së qytezës sonë të vogël.

Shpërosj të mos e teproj, tekta ofroj një skicë të lehtë të qytezës. Jo thjesht si vendngjarje (kanë qenë e mbeten gati të parëndësishme në të shkruarat e mia veshjet apo mjediset ku lëvizin njerëzit si personazhe), por ngaqë veçanërisht aty, në arenë të tillë, ka më shumë të ngjarë të ndodhin pikërisht këto gjëra.

Qyteza ndodhet midis tri kodrash. Në njërin prej tyre ngrihet spitali dhe materniteti, në tjetrën kisha dhe xhamia, tekta në të tretën janë vendosur burgu dhe varrezat. Tërë banorëve, për të ngjitur njërin nga të tri kodrat dhe për të arritur në shtëpitë e tyre, u duhet të zbresin e të kalojnë në shëtitoren e vetme, që e mbanë frymën në qendër të qytezës. Është e pamundur të nisësh për diku, të arrish dhe të kthehesh, pa kaluar në sheshin aty, i vetmi në qendër.

Të gjitha dritaret e ndërtesave dhe zyrave përqark këtij sheshi, duket se rrinë e përgojnë vendin ku takohen të tri rrugët që ngjiten e zbresin nga tri kodrat, me rrugën e madhe, të vetmen që vjen prej jashtë qytetit dhe mbyllet aty, në qendër. Mbase në të gjitha orët e ditës, në mos edhe të natës, shkallët e jashtme të atyre pak pallateve, dyqaneve, njësieve tregtare, këpucarisë, berberhanes, orëndreqësit, bulmetores, bankës së kursimeve, magazinës ushqimore, postë-telegraf-telefonit, dentistit, zyrës së të plote-fuqishmit dhe banjave publike që zbresin për tek përroi që, më tej, ulë kryet sikur fshihet e rrjedh nën qytet, janë plot me njerëz. Ulen diku aty dhe rrinë e vështrjnë gjithçka që lëviz nëpër qytezë dhe pashmangshëm vjen e shfaqet për pak pikërisht aty.

Të sapo-fejuarit, ata që martohen a ndahen, ata që janë thirrur të paraqiten te zyra e të plotë-fuqishmit e radhës, që ndryhen pastaj në qelitë, ata që barten për në spital pastaj për në varreza, të gjithëve pra, edhe turma që drejtohet të dielave për te fusha e futbollit ku luan skuadra amatore që dikur do të dalë më në fund nga kategoria e tretë, u duhet të shfaqen në këtë shesh. Për të shkuar në minierë apo bujqësi apo pyllëzim dhe për tu kthyer, duhet të kalosh aty, gjer edhe autobusi i vetëm, që vjen një herë në javë nga qyteti i madh i afërm, aty ndalet. Qarkohet menjëherë nga të atyshit, njëlloj si xha Petri që hedh vështrimin mbi të gjithë si gjysmë shenjt kur del nga ndërtesa e postës dhe fillon të shpërndajë letrat, telegramet dhe gazetën. Pasi presin e përcjellin autobusin, me ndonjë gazetë 'Sporti Popullor' apo 'Puna' në dorë, po aq të ngeshëm ulen përsëri tek shkallët e Mapos, të koçeqëve apo pezulet e dritareve të njësieve të shërbimit. Vazhdojnë sehirin e përditshmërisë së vet.

Për ne, femrat e kësaj qyteze, shëtitoret dhe vetë sheshi s'është veçse pasqyra ku vështrimeveten me syrin e të tjerëve. Natyrisht s'e kemi lehtë përmes kësaj ngushtice, këtij kryqëzimi, kryqëzate a vend-kurthi që na sjellë ndërmend Bermudën e mistereve.

Pikërisht në këtë qerthull u shfaq për herë të fundit Frida...

Ajo doli në rrugën pranë shtëpisë së saj pak pasi kishte rënë muzgu.

Ishte ajo që dinim, po ai trup që kishim parë Ne, shoqet e saj, e veshur me një fustan pranveror të lehtë, të cilin nuk se e shihnim për herë të parë. Ndërkohë, nuk e dinim, por sapo doli në rrugë e morëm vesh, të gjitha, se asaj mbrëmjeje Frida e kishte shkurtuar vetëm dy gishtërinj. Mbase këto, dy-tri gishtat më pak të fustanit, ia shfaqën dy-tri gishtërinj më të gjata këmbët, gjë që bëri që Ajo të kundrohej dhe të mbetej në përfytyrim më e gjatë se Ne të Tjerat.

Dukej aq e qetë në veprimin e saj. Shkurtimi i fustanit posaçërisht për atë mbrëmje dhe dalja në rrugë, vuri në dukje edhe një të veçantë tjetër të saj, gjunjët e rrumbullakët. Gjunjë si të të tjerave ishin, ashtu si mermeri që thuhej se da Vinçi e kishte përdorur edhe për Jezusin edhe për Pilatin, të dyja kryevepra.

Njëllloj si në librat e shenjtë, s'dihej se do ishte 'Nata e Fundit'. S'dihej çdo ndodhte. As ajo s'e dinte. I vetmi shkak që e ndjemë menjëherë të gjitha, që ajo doli nga shtëpia e saj, pra e vetmja e veçantë e asaj mbrëmje ishte se, secila prej nesh, për ditë të tëra rresht, qe përgjërur dhe provoi t'ia mbushte mendjen vetes për të bërë të njëjtin veprim si të saj: përse jo dy-tri gisht më të shkurtër këto mbrëmje vere?

Çdonjëra prej nesh, në këtë qytezë, e dëshironte këtë. Veç ajo guxoi.

Mbase pafuqia e jonë, kujdesi për të mos rrezikuar më shumë, bindja e shfaqur si urtësi e mirësjellje, e shtyu Fridën drejt atij veprimi të guximshëm që sigurisht do tingëllonte sfidë krenare apo gjest kryeneç.

(Në të vërtetë, shkurtimi me dy-tri gishtërinj i fustanit, po të krahasohet me minifundet e sotme, me fundet deri në një të çarë, deri në zbulimin e kërthizës, për të mos shkuar te pothuaj-nudot, apo fake-veshjet, ishte një ndryshim i vogël, aq i papërfillshëm sa tani, vite më vonë nga ajo mbrëmje, tingëllon për të qeshur. Por atëherë, në kohën e Saj..., ishte tjetër.)

Edhe unë, si gjithë femrat e qytezës, shoqe të shkollës apo fqinja të tyre, e vura re menjëherë bukurimin e pamjes së Fridës. Një përskuqje e prilltë i kishte rënë në fytyrë, nur që zbriste si hije lëkundësi në rrëpirat të-poshtë qafës, përshkëndiste në rrëpirën e gjoksit, më poshtë në ijat, po pra te gjunjët e shfaqur posaçërisht kësaj mbrëmje dhe në pulpat e kolme pa tepri.

Mbase kjo bëri që tërë në femrat e qytezës sikur para-ndjemë, diçka edhe mund të ndodhte asaj mbrëmjeje. Dhe, ku tjetër veçse në sheshin qendror? Tërë të papriturat e qyteteve të vogla dhe qytezave, po aq vështrë parashikohen- si ato në qytetet e mëdha, taftune që nisin prej shtrësve të atje-tejme ngrohura ndryshëm, nëse jo hurrikane prej tërmeteve në shtratin e oqeanëve.

Mbase të gjitha ne e merrnim me mend, por Frida ishte e vetme asaj mbrëmje...

# AJO... E BERMUDËS

Tregim nga Faruk Myrtaj



Ajo doli në rrugicën që niste prej portës së oborrit të shtëpisë së vetë dhe zbriti, natyrisht për nga qendra. Të gjithë i druhen Trekëndëshit të Bermudës, kështu thuhet, e dinë ku gjendet edhe në hartë por, kur duket se u vjen ora, barkat e anijet e avionët nisen pothuaj symbyllur për atje!

Si të ma pëshpërishte engjëlli im, unë i shkova pas Fridës, me të njëjtin hap, me të njëjtin qetësi e mënyrë të mbajtjes ulur të kokës, pa shprehur asgjë të veçantë. Vërtetë s'kisha të bëja fare me të. Pata veshur rrobat e përditshme, për të cilat s'kishin vërejtje prindërit, as drejtorja e shkollës dhe, ta merr mendja, s'mbaja asnjë përgjegjësi për ç'kishte ndryshuar në veshjen e asaj tjetrës, Fridës pra.

Të gjitha Ne, kishte kohë, mezi i bënim ballë joshjes dhe- siç më pas u tha, nuk ishte Frida që harxhonte më shumë kohë përpara pasqyrës. Deri bukur kohë më pas, nuk u pranua hapur se, të gjitha Ne, e prisnim një veprim të fundit, shkurtimin edhe-sado-pak të fustaneve apo fundeve tonë. Në mos atë mbrëmje, kjo do ndodhte, një ditë a një javë a një muaj më pas, por s'mund të mos ndodhte. Në mos Frida, një tjetër prej nesh, vajzave të tjera të qytetit, dikush do dilte nga oborri me fundin shkurtuar.

Krejt befasisht, vumë re se ishte Ajo. Sot është naivitet të pyesësh se si Lajmi i Daljes së Saj me fund të shkurtuar dy-a-tri gishta u shpërnda aq rrafshëm, pa ndodhur...

Frida s'e pa të udhës të ushtronte vëmendje të vërente ç'njerëz ndodheshin në rrugicë atë orë mugu. Edhe unë, që ecja pas saj, sikur isha shndërruar në njeri të padukshëm. Gjendesha aty thjesht për arsyen e përmendur më sipër: secila prej nesh do dëshironte të ishte në vendin e Saj. nuk dukeshja për arsyen tjetër: guximi për të dalë ishte i Saj!

Syri u mësua në mugëtirë dhe ma qartësoi imazhin e trupit që sfidonte atë mbrëmje. Pas pak fitova qetësinë e mjaftueshme për të vënë re se ç'kishte ndryshuar realisht në veshjen e saj. Mbase më erdhën në ndihmë edhe duart e saj që, herë pas here shkonin atje poshtë tek këmbët, ku ishin zbuluar paksa gjunjët. A thua ende donte të bindte veten se vërtet e kishte shkurtuar rrobën e veshur? Vuante ende mëdyshjen e kësaj shëtitjeje vetmitare deri në qendër? Bluante akoma dilemën e kthimit menjëherë në shtëpi, të kthehej qysh në rrugicën më të parë?

Në mënyrën se si hidhte hapin, megjithatë, ndjehej vendosmëria. Deri në lëvizjet më të vogla. Me gëzim trishtak, u sigurova se Frida s'kishte ndërmend të kthehej, ndonëse kurrë s'e kisha menduar të keqen që mund t'i ndodhte. Në fund të fundit, ajo ishte dy-tri gishtërinj më e gjatë se secila prej nesh. Shkurtimi i fundit, që solli këtë diferencë, vetëm dy tri gishtrinj gjithë-gjithë, vetëm se i qartësonte këto raporte për të na qetësuar.

Ndryshimi në veshjen e Saj u vu re nga më i pari që rastisi të gjendej në rrugicën pranë shtëpisë së saj. Mbase përmes tij, me shpejtësi të papërfytyrueshme, e morën vesh gjithë ata që u gjendën jashtë atë orë.

Unë që vija re gjithçka të saj, pashë se u bë më e shkathët, më e gjallë, kur vuri re tërheqjen e vëmendjes tek tërë të tjerët. A thua se mezi kishte pritur vënien në funksion të këtyre enëve komunikuese. Gjithnjë e më e vendosur vazhdoi të ecte përgjatë rrugicës, që sigurisht do ta nxirrte në rrugën kryesore. Gjithçka frymore ishte kthyer me vështrim nga ajo. Tërë ai ngulim njerëzor i asaj mbrëmje më shtyu të besoj se qyteti ishte populluar jo me njerëz por me lule dielli. Të gjithë rrotulloheshim me vështrimin për nga Ajo. As që bëhej fjalë se ishte punë rrezatimesh, energjie dhe drite.

S'di pse, ndjeja dëshirën e papërbalueshme, të pa-evitueshme, për tu gjendur atje ku do duhej të isha doemos dëshmitare. Atje ku

ishte, por edhe ku pas pak do ishte Ajo.

Nxitoja, dredhoja rrugicave, kapërceja muret, për ta kundruar nga pika të ndryshme. Herë përpara, herë diku pas saj. S'guxoja t'i isha shumë afër, por s'mund të mos e dëshmoj ndrojtjen si frikë për keqkuptim të mundshëm: Nuk isha unë që e pëshpërita apo që e bëra lajm, shkurtimin me dy-tri gishtërinj tek gjunjët e saj.

Kush e di me ç'lloj krahësh, fërfërima e fustanit të saj fluturoi e mbërriti tek ata ulur te shkallët, minuta më përpara se Ajo të arrinte vet në Shesh.

Më besoni për këtë. Dëshmoj se as atëherë as sot nuk më thirri kush për të dëshmuar. Kërkoj të rrefehem vet. Për veten. Për shpirtin tim. Por, mos prisni të dëshmoj atë që s'ka ndodhur: ne, të gjithë, nxitnim të gjendeshim atje, në qerthullin e Bermudës.

Njerëzia, ndenjtur shkallëve apo parvazeve të lokaleve a njësieve të shërbimit, e tëra priste që diçka të shfaqej aty, në syrin e Bermudës. Askush nuk shihte për nga unë, edhe pse u shfaqta aty, fill pas Fridës. Natyrisht me dy tri gishtat të pa-shkurtuar.

Midis atyre që u gjendën në Shesh pashë edhe Petrin, postierin e urtë, më të pafjalin e qytetit. Edhe ato minuta, me fytyrën e mbyllur, pa shprehje. Mbase ndër të vetmit që nuk vështronte për nga Frida. Besova se prandaj dukej se si njeri i mirë kishte vite të tëra që sikur s'prekej nga gëzimet e as nga hidhërimet e telegrameve që shpërndante. Tek shkallët e berberhanes u pa edhe e para femër berbere, Olja. Ngaqë e kishte provuar edhe vet peshën e këtyre vështrimeve, u detyrua të dilte vetëm e vetëm se klientët e berberhanes, edhe ata me mjekrën ende me shkurme, apo gjysmë të rruar, lanë karriget dhe dolën tek shkallët. Tek stoli përbri Arkës së Kursimeve ku qytetarët paguanin faturat për llambën e vetme të ndriçimit, rrinte Aladini, korrieri i Pushtetit Popullor. Ai vet rrëfente histori lufte, por para disa vitesh, thuhej se iu desh të shkante te pallati ku banonte, trokiti tek dera e vet si në shtëpinë e një të panjohuri, dorëzoi fletë-arrestin për të biri, dhe u kthye te kolibja e zyrës, i gatshëm për të shpërndarë zarfe të tjerë pushtetorin.

Frida, pa asnjë ngut, sikur zhvendosej për kudo ku e prisnim.

Unë vazhdoja ta ndiqja. Në sigurinë e hapit të saj mu duk se shprehej kënaqësia, jo droja, që rruga kalonte pikërisht atje, në qendër. Kur po i afrohej frymëmarrjeve të rënduara që pa asnjë shkak e prisnim në Shesh, preku edhe një herë fundin e fustanit, si për tu bindur edhe një herë se ia vlente ta çonte shëtitjen e nisur deri në fund.

Vetësiguria e plotë e gjestit të Saj përcillej vetëtimthi tërë rrugicave e rrugëve, në ankthin e vështrimeve të vajzave, grave dhe shoqeve tona të shkollës që ndiqnin lëvizjen e saj pas perdeve të dritareve. Frida, por edhe unë që zhvendosesha pas saj, e ndjenim përgjimin e të Tjerave, njëlllojtë si ai fëmija që provon të ngrihet më këmbë me sigurinë e dorës së nënës që do t'i gjendet nëse do rrëzohet. S'kishte si shpërgohej ndryshe që, përpara se të qëndronte më së fundmi në qendër, u kujdes të shkelte çdonjërin prej rrugëve të qytezës. Për ta mbërritur këtë moment do t'i duhej të kalonte disa herë në qendër, për t'i ngjitur e pastaj për t'i zbritur, të tria rrugët që çonin në të Tri Kodrat reliev të qytezës, si në një fushë të elektrizuar, pa shfaqur ngarkesë të vetën.

Isha e sigurt, si tërë gratë e gocat e qytetit, Ajo nuk e kishte prerë fundin e fustanit. Vetëm e kishte kthyer, e kishte bërë palë, pastaj hekurosur për të mos rënë në sy. Sido të shkante puna, përdërisa në këtë qytezë do vazhdonte jeta, kishte mundësi ta zgjaste përsëri. Kështu guxonim të tëra ne, femrat e asaj-kohe. Përgjysmë. Në mëdyshje, në betejë me veten dhe të tjerët. Nuk është kollaj të fitosh luftëra me betejat të pafundme. Kështu kishim provuar dhe kishim humbur kështu.

Përveç Asaj...

E la sërish qendrën e qytetit, tekta në ajër ndjehej një si kundërmim qerpikësh dhe vetullash të djegura për shkak vështrimesh që bënë sehir verbërinë. Frida bëri për nga rruga që çonte në spital, vetëm një rrugë më shumë e ndante fitoren nga humbja, pasi kishte ngjitur rrugën që çonte në burg dhe në varreza, pastaj edhe atë që shpinte për tek kisha dhe xhamia, i zbriti të dyja dhe, pikërisht tekta ngjitej kodrës së tretë, turbulluar si unë dhe femrat e tjera të qytetit, u kujtua se pranë spitalit ndodhej materniteti. Vetëm që të mos e shinin në atë afërsi, u kthye në të kundërt, me vërtik. Edhe shkelja më rastësore në atë rrugë do ta bënte me faj pafalshëm atë fustan të shkurtuar aq kursyeshëm mbi gju.

"Veç tani mos u kthe, Fridë!", doja t'i bërtisja. "Të kthehesh tani është të dorëzohesh si e penduara e kësaj mbrëmjeje!"

Si të ma kishte dëgjuar atë që nuk e artikulovala, ose sikur të kisha emetuar në ajrin e asaj mbrëmjeje ndjesinë e rrëzimit në mëdyshjen e saj, vazhdoi të ecte, për tu shfaqur sërish në qendër. "Bermudës sigurisht nuk do t'i iki!"

Mbase nuk mund t'i shmangej, edhe sikur të donte tashmë. Për Bermudën kishte dalë asaj mbrëmjeje. Dhe unë, për atë e ndiqja pas, dhe tërë të tjerat, që tashmë i kishin hequr fare perdet e dritareve o kishin dalë në ballkonet të dukeshin që po ia kurajonin hapin bukuruar aq këndshëm prej lojës së kupave të gjunjëve.

Edhe nëse dukej ca si e mpirë, s'ishte e lodhur. E nxitoi edhe pak hapin, që dëgjohej më larg, ku isha unë. Përplasej në muret dhe në kthim sikur gjemonte. Më duhej t'i mbyllja veshët, pastaj një si mpirje apo përgjumje më këshillonte t'i mbyllja sytë. Apo ishte rrekja për të shpëtuar veten nëse aty do rrezikohej diçka? Do më duhej të provoja ndjesinë se, po të isha në vendin e Saj, do duhej të rrezohesha, pa frymë?

"Ti duhet të vazhdosh, duhet të mbaresh...E ke detyrim, edhe prej nesh!"

Edhe pse isha e bindur se s'më dëgjonte. Flisja me veten, apo për veten, kështu?

Ajo çau vërtik përmes sheshit, si të donte të shkulte aty tërë shigjetat e vështrimeve të ngulura tek pjesa e gjunjëve që tepronin prej fustanit të saj. bënte gjithçka të shfaqej e sigurtë, se nuk do ta lëshonte veten, ose kështu më besohej mua, që e kisha ndjekur prej

kur doli nga shtëpia, në frikë se dikur mund t'i shteronin fuqitë, apo edhe vetëm shtyja për të vazhduar. Kur arritëm në mes të Sheshit besoja se e vetmja gjë që e mbante në lëvizje ishte se po i afrohej fundit.

Tek Bermudet s'bëhej dot ndryshe. Frida kishte arritur deri aty...

Pak çaste më vonë, kur ndjeva një lloj hakërimi të maskuar nën kureshtjen e pa cipë të syve që përshkëndisnin prej shkallareve dhe parvazeve, në pamundësi të eklipsoheshin nga përgjërimit femëror që përthënohej prej perdeve të dritareve, ngaqë prej tërë gocave unë isha më afër Fridës, ndjeva detyrimin t'i përcillja mirënjohjen se, qoftë edhe vetëm për deri aty, kishte bërë shumë.

"Edhe mund të kthehesh...Nuk është e thënë t'i bësh ti të gjitha..."

Ishim në Sheshin e Madh të qendrës së qytezës, nuk guxoja t'i flisja në prani të veshëve dhe syve të atyre që vazhdonin ta përgjonin dhe t'i lagështonin me vështrime hapat e saj, gjuhët e skuqura sikur t'i ishte dashur të ecte me to, gjuhëzazi.

S'mund të ishin të tilla miljet e fundit të lundrimit të saj, në dallgët e marrëzisë së pa shkak dhe të pa adresuar që ngrihej si dallgë në humbellën e Bermudës sonë. Frida ishte vetëm pak hapa më tej, shumë kollaj për t'i folur, për ta prekur, nëse jo më për ta kurajuar, për ta ndërmendur se tashmë s'kishte më çfarë tjetër të kryente.

Por mund të ndodhte diçka dhe, mbase për këtë version, do mund ta siguroja se ishte e ndihmueshme. Nuk arrita, s'guxova.

Qoftë edhe përmes gulçeve, që po ma merrnin frymën, duhej t'i kisha thënë diçka. Por nuk dija çfarë. Asaj, vetes, apo të Tjerave përqark?! Si mund t'ia klithja fjalë të tilla si "Mjaft, mjaft, de! Nuk i sheh, ata...? S'e ndjen frymëmarrjen gjellitëse të Bermudës?"

U hëngra me veten, gjer në çastin e fundit, por ngaqë nuk isha ajo, nuk e kandisa këtë vete që isha, t'i thërrisja, ta kujtoja se më në fund mund të kthehej, të kthehej pas, ose të fshihej si ne të tjerat nëpër muzg, të futej në ndonjë nga ato oborret e shtëpive përdhese aty pranë, pastaj të kapërcente ndonjë nga gardhet e ulët për në ndonjërin nga rrugicat me dalje tjetërkund.

I mendova tërë këto, por s'munda. Edhe kur u binda se Ajo s'do kishte dot ndonjë barkë, shfaqur rastësisht atyre ujërave në atë vend kurthi uhor të ditur si të rrezikshëm. Nuk e shkova ndërmend, për asnjë çast, si lundërtare të pa-përvojë, që s'kishte marrë me mend për ku e kishte shtyrë deti i trazuar apo zërat e shtojzovalleve të ngasjes sonë të përbashkët. Edhe pse e vetme, pa-fshehshëm e brishtë, edhe në ato momente, më shumë mu duk si një anije me vela të mëdha të ngritura, me disa busulla, edhe pse me një motor të vetëm të brishtë, ajme...Nuk di pse ende po ngulmonte, për çfarë kishte dalë nga shtëpia e vet atë mbrëmje, pra për të kaluar pikërisht aty, mes trekëndëshit të Bermudës. Mbase i ishin mjegulluar sytë, si mua, që tashmë e pranoj se isha përplotur, si tërë sytë e femrave të tjera pas perdeve në dritaret me drita të shuara.

Për çfarë ndodhi më tej, s'mbaj mend kthjellët. Nuk pashë gjë. Pas një turbullire apo përhumbjeje, që s'di sa zgjati, dëgjova përqark zëra të alarmuar, rrokjezime që përcillnin lajmin se Ajo nuk dukej më.

Dikush përsëriste këmbëngulës që e kishte parë Fridën të rrëzohej tek këmbët e stolit ku ende rrinte Aladini, por kurrkush nuk dëshmoi për ndonjë zarrlëshuar në dorë të saj prej tij. Një tjetër shtoi se ngulmoi të arrinte tek Arka e Kursimeve, apo një i tretë që edhe pse vet i rrëzuar aty në shesh, duke u zhvendosur edhe ai gjuhëzazi, bënte paralajmërime të mos ecej përpara. Nuk ia vlen të paguhet kaq shtrenjtë, po thoshte. Si të ishte fjala për të paguar faturë atje. Pa thënë dot për çfarë paguhej? Në emër të kujt? I kujt që çmimi? I Kujt, de...?!

Tërë asaj nate, as të nesërmen, si dhe në ditët më pas, nuk e pa kush më Fridën.

Mungesa ndjehej, përditë e më rreptë, si një humnerë e thelluar prej cdo minute që shkante pa Fridën, por nuk ishte e thënë të pyetej për ç'ndodhi me të.

Përmendja e epilogut të asaj mbrëmjeje nuk i vinte për osh kujtesës së askujt.

"Gjersa s'ka vesh për të dëgjuar, bën mirë të heshtësh...", më thanë mua, që kisha qenë në gjurmë të saj. "Gjersa nuk rrihen dot për çastin e fundmë, as dëshmitare s'je!"

Edhe ca pak që fillimisht qenë të interesuar për *historinë e Saj*, më pas u morën thjesht me shkurtimin e fustanit.

Nëse duhet thënë sado-dicka për funeralin, duhej pranuar, mori pjesë gjithë qyteza.

Shoqet e saj, tërë vajzat e gratë e qytetit, dolën në rrugë. Dukej se bartnim arkivolin me trupin e saj, edhe pse askush nuk besonte të ishte më.

Edhe pse askush nuk e pa më me sy, e shëtitëm arkivolin deri te majë-kodra ku ngrihej kisha dhe xhamia, e zbritëm të-poshtë, ndalëm për pak çaste në shesh, në qendër të qytezës, pastaj deri tek kodra tjetër ku ndodheshin burgu dhe varrezat. Vetëm për ta shtrirë shëtitjen vdekur edhe në rrugën e tretë, atë që çonte tek spitali dhe materniteti, atë nuk e shkuam ndërmend.


Prej asaj mbrëmjeje Ajo mungoi, pa lamtumirë.

Emri dhe fotografia e Saj nuk u vunë në pllakën e ndonjë varri.

\*

Kjo ngjarje kujtohet të ketë ndodhur kohë më parë. Tashmë thujse është harruar. Në qytezë përmendet thjesht një vajzë, një trushkulur që doli në rrugë me fustanin mbi gju. Emri i saj nuk i kujtohet kurrkujt. Edhe kur zihet ngjesh pa të keq, thirret thjesht "Ajo".

Nuk ka asnjë arsye ta kujtojmë. Tërë gocat e vajzat e qytetit, gratë që i kanë kapërcyer të pesëdhjetat, madje edhe të moshuarat, mbajnë fustane dekolte të hapur dhe minifunde, shumë më mbi gju se ajo asaj mbrëmjeje të fundit.



## Sërish

Le të bëhen të dukshme distancat sërish që brenda nesh i bartim, të shëmbëllojnë sërish me ëngjëj fjalët e shkrojtura në pëshpërimitat e rërës

kopshti ëndërron zogj dhe lule të egra dhe vazot prej balte lëvdojnë manushaqet, karafila dhe zambakë,

le ta gjejmë pra sërish veten tonë të fshehur në udhën e pafrymë të përditshmërisë, në shkretëtirë dhe në orët e shkurdisura të qiellit.

Athinë, 10 Mars 2006

## Heroi i poemës

Heroi i poemës prej këtij çasti nuk shkruan më përkohësisht sepse nuk di në vdekjen urren më tepër apo jetën, nuk di nëse do shtrinte dorën e tij të ndihmëje

një të dobët, a një të fuqishëm të bëhet ende më superior për të luftuar plogështitë e të dobëtit, hero i poemës ka një shikim të largët dhe afër ndonjëherë,

varet nga dita, jeton në një botë gjithë lumenj, liqene dhe det ushqehet me lajme në celular, çdo ditë

komenton aktualitetin me tekste të derdhura në faqen e tretë të gazetës, nuk shkëlqen diku, është thjeshtë një hero i një poeme të thjeshtë.

Tinos, 12 Shkurt 2024

## Mbijetova

Mbijetova aksidentalisht jo nga mrekullia ndërsa të gjallët kalbeshin në trupat e të vdekurve e ndërkohë fjalët humbisnin kuptimin në gojë të politikanëve

ndërsa ata përkarshi nxitonin të turreshin

në panairin e elefantëve dhe si të jenë insekte, Palestinezët i shtypin me këmbë,

por mbijetova dhe hamendësohet që në vdekjen tjetër në kafene nuk do jem më duke pirë kafënë e hidhur të ngushëllimit me peksimadhen e zezë.

Tinos, 5 Shkurt 2024

## Kaos

Në librin e ardhshëm do desha një fotografi me kaosin, do desha botuesi im të dërgonte një fotograf dhe një ditë të vijë në shtëpinë time e para kaosit të më fotografojë, nuk më thonë gjë sfondet me bibliotekë dhe libra, më janë kthyer në makth, më lodhin vetëm që i shoh

dua kaosin për sfond sigurisht që të zbulohet nuk do jetë e lehtë e jo më t'i thotë të qëndrojë prapa meje mos lëviz se do të nxjerrë në fotografi

mundet ta joshë me akullore a pak pafundësi kush e di, të shohim, gjithçka është në diskutim.

Tinos, 5 Shkurt 2024

## Gracias a la Vida

Ngushëllohuni me kafshën tuaj shtëpiake me kafënë tuaj, marramendjen, tabletat me një vazo në nevojë, me një serial

Tigri është kaq larg sa dhe Eufirati në Meksikë vrasje çdo ditë dielli vonohet në El Paso Gracias a la Vida gjer tutje nuk dëgjohet.

Athinë, 6 Janar 2016

## Tashmë

Tashmë heronjtë mungojnë me leje në dyqane të kyçura harruam dritën furtuna s'ka nisur ende dhe të fshehtat tona të tmerrshme i kemi ngjeshur aq sa mundemi më thellë

tashmë dashuria u bë lakuriq nate dhe netëve hidhet nga njëri prag tek tjetri duke kërkuar gjakun tonë të dashurisë tashmë hija e erës përkëdhel hijen tonë ndërsa bie, e dobët dhe e rrënuar mbi gjëra të stërthëna

tashmë kam veshur frikërat të mos më njohë bashkë udhëtari i kohës që më skërmit dhëmbët e tij vazhdimisht

tashmë gjithçka regjistrohet si e përkohshme: gjelbërimi i pareshtur, të stërlënduarit dhe të mbyturit në detyrime familjet gjithaq dhe përjetësia.

Athinë, 16 Janar 2016

Dinos Siotis (Tinos, 1944) është një nga poetët më emblematic dhe produktiv i poezisë bashkëkohore greke.

Me një biografi tejet të pasur në fushën e botimeve si poezi, publicistikë, kritikë letrare, njëkohësisht botues dhe organizatori i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë në Athinë. I angazhuar në çështjet sociale ku reflektohet thellësisht në poezitë e tij. Ka studiuar Drejtësi në Universitetin e Athinës dhe Letërsi Krahasuese në Universitetin Shtetëror të San Franciskos. Ka punuar si këshilltar shtypi në Ambasadën e Greqisë në Otavë dhe Konsullatat e Greqisë në San. Francisco, Nju Jork dhe Boston. Ka dhënë leksione për poezinë greke në Bibliotekën e Kongresit, Bibliotekën Kombëtare të Kanadasë, Universitetin e Harvardit dhe institucione të tjera intelektuale. Është vlerësuar me Çmimin Shtetëror të Poezisë në 2007.

**DASHURI**

Ish nje vajze e ish nje djale,  
vajza e donte e djali e donte,  
po Shkumbini i madh me vale  
i kish ndare e s'i bashkonte.

Dhe therrisinin: O o o, te dua!  
po kjo klithme e lashte fjalesh  
u degjohej: Jooo, s'te dua!  
neper thashetheme valesh.

E humbisnin te dy shpresen  
e shpresonin prap me teper,  
sic humbet dhe drita vesen  
dhe e gjen mengjesin tjetet.

Ooo, te duuaa, nisej fjala,  
Jooo, s'te duuaa, mberritne zallit,  
vajza thosh: Me pifte vala!  
Te perpifte! I vinte djalit.

Bot me buze, bot me duar  
anes dallgeve nderkryer,  
here per jete dashuruar,  
here per vdekje te zhgenjyer.

Hidhnin fjalen ta kalonin,  
shprishej porsi plisi i kumit,  
hidhnin gurin te qellonin,  
binte mu ne mes te lumit.

Nje cast lumi s'ish me lume  
mes dy brigjeve te mallit  
dhe u bind e ra ne gjume  
dhe u hap e fjete zallit.

Rendi vajza e rendi fjali  
sa u ngrit nje ere e marre,  
qe rrezoi shkembinj nga mali  
e nje bresher qe s'ish pare.

Zgjaten duar, vune gure,  
shtruan dhimbjet qe nuk thuhet  
gjer mbi lume u bene ure,  
te kalojne ata qe duhen.

\*\*\*

S'rri dot me ty,  
s'bëj dot pa ty,  
nata ka vesh,  
dita ka sy.

Fshehur po dal'  
vjedhur po hyj,  
nata ka vesh,  
dita ka sy.

Nën qiell veç,  
nën dhe të dy,  
s'rri dot me ty,  
s'bëj dot pa ty.

**PËR TY QË TË DUA**

Unë emrin tënd e zë rrallë në gojë  
kjo do të thotë që në zemër e ruaj thellë  
veç në ndodhtë të kthehem në rrenojë  
do të dalësh si legjenda mbi një kështjellë

Unë emrin tënd s'e kam vënë në asnjë vjershë  
E s'do ta shkruaj as në vargun më me bujë  
Kjo do të thotë që gjërat me peshë  
rrinë në thellësi dhe është zor t'i ngresh mbi ujë

Plot dhjetë vjet më parë, më 20 prill 2014  
u nda nga jeta poeti i talentuar

# Koçi Petriti

## BREDH BRENGA E MBRËMJES

**VALLJA GORARE**

Me nje shtyrje gjuri ngjitet  
Me nje thyrje gjuri zbret  
Sikur ecën nëpër vitet  
Po çon historinë e vet

Sa shpalos një trill shamie  
Nga mëngoret e mëdha  
Del një re thëllëzërie  
Ç'gushëkuqe e ç'guguçe ka

Me çdo palë fustanelle  
Fllade mbledh, furtunë përcjell  
Herë muros një mur kështjelle  
Herë përkulet lule mbjell  
Pa kur shenjë bën me vetull

Ç'gurrë gërrnetash rrokullis!  
Njëqind shqipe mbledh nën sqetull  
Treqind shqipe larg i nis  
E me nje shtrëngim të dorës

Shoku shokun supit kap  
Brof te shohë nga Guri i Gorës  
Mbi Tomorr e mbi Korab  
Nën opingat xhufkëkuqe

Tokën dredh e ajrin gris  
Herë përzen një nisje lufte  
Herë në hon një xhind gremis  
Dhe nën vetëtimë të xhufkës

Shoku shokun rrok perkrah  
Brof të shohë nga sheshi i luftës  
Përtej maleve çfarë ka?  
Me një shtyrje gjuri ngjitet

Me një thyrje gjuri zbret  
Sikur ecën nëpër vitet  
Përcjell historinë e vet...

**BREDH BRENGA E MBRËMJES**

Bredh brenga e mbrëmjes. Bryma brigjet zbardh.  
Ty të buis mbi dy bumbeska i bryllët gjiri.  
E unë ndjej sikur nga gjith ky mall i madh  
përbrënda më vjen rreth një gur mulliri.

Mbi ç'buzë bumbeskat-zogj ti po i çuket,  
kur mijra zilka gjethesh troket plepi  
e natyra nxjerr nga xhep' i vet  
hënën si pasqyrëz tualeti?

**DHIMBJA E POETIT**

Nga dhimbja ime dalin zogj,  
skifterë hapësirash  
e ç'kam në zemër e shkërmoq  
në copra xhevahresh.

Se copra xhevahresh ndaj  
me vargun tim blatonjës  
e pasuri për vete mbaj  
veç pendën e shqiponjës.

**JU KUJTOVA TE GJITHAVE**

Ju kujtova te gjithave juve qe them se ju desha  
qe nga m'e hershmja  
gjer tek e vona,  
ate qe ish e paputhura,  
ate qe ish virgjerasha,  
ate qe ish moll' e sherrit e pelë e harbimeve tona.

Ate qe flijoi per tre grosh dashurizen e pare  
ate qe briroi fill pas muajit te mjaltit nen mua  
ate qe nguroi n'udhekryq djall a ëngjell te marre  
ate qe kuptoi qe s'e desha, qe sapo i thashe "Te dua"

Ja, po me ngjan sikur ngrihi nga heshtja e honeve  
te ndryshme, te shumta si ngjyrat, si zogjte  
ju fluturuat mbi prushin epshor te pasioneve  
donit te ngroheshit, pendet e bukura dogjte

Vjen perendisht edhe ti qe te desha se pari  
pikez e arte, flurorja, si rreze e perthyer mbi lote  
te shtrij e te shkoj permby buze serish si dikur nje fill  
bari  
ti nis kendon edhe qan: Dashuria ben xhiro ne bote!


Prap une u desha pa ty  
ti prape u puthe pa mua  
erdhen pas teje te tjera, shuan c'rindizet e digjet  
erdhen, po s'hyri askush gjer ne pronat e tua  
mes njeri tjetrit shkon lumi qe ndan e bashkon te dy  
brigjet

Zbriti dhe suta e Veriut  
mbririti edhe krrilla prej Jugut  
une i pranova te gjitha, te gjitha, te gjitha  
toka, grua beronje, palluar prej plugut  
qan kur s'ngarkohet me peme  
qesh kur mbulohet me drithra

Ja, ku po vjen dhe m'e vona, mjellma e fundit  
mjellma e fundit brymuar nga vjeshta  
hirin honor te flijimit kalimthi ma shkundi  
brymen e ikjes pa kthim me brymoi permby vjersha

Une keshtu dimeroj gjer ne flirtet e vona  
here i rishuar, here i rindezur, sa mund  
jam gati cdonje ta ridua sikur t'ish vertet Dezdemonia  
pastaj ta harroj si nje liber qe s'mund ta lexosh gjer ne  
fund.

Karikaturë nga Arben Mexsi



Letërsia nuk është gjë tjetër,  
veçse një ëndërr e komanduar.  
J. L. BORGES

Një mbrëmje të vonë, mes një bote të largët ku më kishte kredhur pasazhi i një libri që thoshte se Plutarku tallej me ata që mëtonin se hëna e Athinës ia kalonte asaj të Korintit, m'u mbyllën sytë dhe pashë një nga ëndrrat më të gjata e më çuditshme që mund të shihet ndonjëherë. Unë s'do të bëj gjë tjetër, vetëm do ta riprodhoj:

Në fillim qelqi i dritares së dhomës ku flija u drodh prej pasqyrimin të një drite të bardhë në të kaltër. Në të njëjtën kohë, u dëgjua një murmurimë muzikore, e ngjashme me fëshfëritjen e jargavanëve nëpër stinët e lulëzimit. Ngrita sytë e përhumbar, por në çast më pushtoi një llahtari e papërshkrueshme; në parvazin e dritares ishte ulur hëna. Gjithë duke ndriçuar, ajo përftoi atypëraty trajta njerëzore dhe më vështroi tepër e hutuar. Kështu ne dukeshim të dyja, sikur patëm dalë nga i njëjti ferr.

-Mirëmbërma!- tha ajo.

Në të vërtetë, pasi më kaloi çasti i parë i tronditjes, unë u mrekullova me atë pamje drite. Mrekullimi filloi të më derdhej duke gurgulluar në shpirt, ndaj, kur desha të përgjigjesha, diç më pengonte.

-Mirë se erdhët! - i thashë me vështirësi.

Jehona e zërit tim u përplas nëpër mure si një kumt i largët.

Ashtu e ulur në dritare, hëna zgjati dorën drejt meje. U ngrita edhe unë e i zgjata dorën për mirësjellje. Përfytyroja se do të rrëqethesha nga e ftohta, por në dorën e saj fërgëllonte një zjarr i ëmbël si dashuria. E kundrova në sy për t'u bindur se trupi dhe shpirti në fund të fundit janë dy realitete që flasin.

-Dijesh, - i thashë.

-Nga trishtimi, - pohoi.

-Trishtimi është gjendje e përhershme në kohët moderne, - iu përgjigja me një shprehje retorike që e kisha lexuar aq e aq herë.

-Për mua çdo kohë është moderne në raport me atë që ikën - tha. - Që nga Herakliti në Antikitet, i cili e koncepton kohën si lumë dhe deri te Borges që në shekullin XX, e quan *Zoti tjetër*, koha po ajo është. Të parët që ndërtuan një kalendar për të matur kohën qenë hebrenjtë. Jul Qezari donte t'i fiksonte orët dhe ndërtoi edhe ai një kalendar që mban emrin e tij, *Kalendari Julian* ose i vjetër. Thuhet se shahu i Persisë ngarkoi një poet të madh për të hartuar një kalendar të veçantë, i cili mori emrin *kalendari persian*. Është pastaj *Kalendari gregorian* ose i riu e shumë të tjerë. Ndërsa *koha dritë* është një lloj ëndrre, që endet nëpër univers.

Hëna vazhdoi të fliste, por unë e pashë veten të rrethuar nga një realitet i pakuptueshëm. Po më tërhiqte një forcë që nuk e kisha provuar kurrë: një energji drite ma përshkoi mendjen dhe zemrën si send që bymehet. Nuk e di përse ato çaste mendova kaosin primitiv. Ndjeva lëvizjen natore që më krijonte mundësi ta fshihja në një farë mënyre përshtjellimin. Dhe thashë diçka pa lidhje:

-Në një traktat fizike shkruhet se gjithçka është pasojë...

Hëna nuk u kushtoi rëndësi fjalëve të mia, por i hodhi sytë nga unë në formë kërkuese. Mbase donte të mësonte si e kisha prituri fjalën e saj. Me shprehjen time të fytyrës i tregova se ajo që tha ishte e llahtarishit e bukur. Duke e vështruar, hëna m'u duk vashë e re. E tejdukshme si agimi. Dhe lëshonte një rrezatim argjendor.

-Pra, koha në vetvete është iluzion, pavarësisht nga qindra e mijëra llojet e orëve që përdorni ju njerëzit e tokës. Ajo sjell trishtim, trishtim.

Fjalën *trishtim* hëna e përsëriti dhe e zgjati shumë zanoren e fundit. E magjepsur dhe doemos e hutuar nga ato që thoshte, e pyeta:


-Më trego, të lutem, si e kupton që je e trishtuar?

E bëra pyetjen shpejt, se mos e harroja dhe më mbërtheu një ndjesi faji. I isha drejtuar me ti, kur ne kishim fare pak që ishim takuar.

-E kuptoj menjëherë, - tha. - Një erë e ftohtë fryn brenda meje dhe zemra më bëhet akull. Tani nuk e ndiej më parfumin e tokës. As melodinë e valëve ujore, nuk e hetoj dot. Madje algat fosforeshente nuk i përshëndes më. Unë zhytem në thellësi të shpirtit dhe e kuptoj se diçka në mua është shuar. Në kraharorin tim varet shpresa e zhgënjyer. Jeta ime është e papajteshme me lumturinë. Njëherësh unë jam dhe nuk jam. Shpirti im e ka braktisur trupin. Çfarë jam unë? Në mos, një pasion për vdekjen.

## VETËVRAJJA E HËNËS

nga Feride Papeleka



Ajo u ndal një grimëherë, sa për të marrë frymë, pastaj shtoi:

-Trishtimi tek unë ngjitet si batica, thotë...

-Ngrijeni pak zërin, - iu drejtova, - duke mos e fshehur druajtjen që u strehua befasi në ndjenjat e mia. Hëna më hodhi një shikim miqësor dhe u përgjigj:

-Por unë flas vetëm me zë të ulët, se dua të më dëgjojnë.

Butësia e zërit të saj fërfërinte nëpër dhomë si një ogur i bardhë. Edhe pse melankolik, muzikaliteti i jepte qartësi mendimit. Sa keq që e ndërpreva dhe nuk e mora vesh emrin e autorit. Por, e kuptova se doja të mësoja sa më shumë. Kjo ishte një anë e re, e panjohur, që nuk e dija se ekzistonte te unë. Kuptohet, isha kureshtarë të zbuloja edhe brengën e saj.

Gjithnjë, duke e mbajtur dorën në anën e majtë të kraharorit, hëna tha:

-I trishtuar vjen nga latinishtja *tristis*. Ka ngjyra të trishtuara, vende të trishtuara, nota të trishtuara. Ka edhe diçka tjetër më të rëndë: sytë trishtuar. Ky është dënim i perceptimit njerëzor. Ai i shndërron sytë në një imazh vajtues që herë duket si gjuhë zjarri që djeg, herë si faqe e zhveshur mali.

Pas këtyre krahasimeve të çartura, ajo heshti. Unë përfytyrova gjëra të copëzuara që rrëzohen së larti, pa zhurmë. Sidomos trupa që ndahen nga shpirti. Kisha etje ta dëgjoja. Mos ishte një engjëll që kishte zbritur në tokë për t'u rrëfyer?! Ajo vazhdoi, duke e ndryshuar paksa tonin:

-Por, kur trishtimi ka zaptuar tërë fytyrën, zemra i ngjet një djerrine që e ka rrahur pa mëshirë era dhe ka mbjellë shkretimin.

Unë u ngrita disi e sëkëlldisur, hapa mirë dritaren tjetër dhe puhiza ma përkëdheli fytyrën. Yjtë lart shkëlqenin. Ne njerëzit e tokës, në të vërtetë, nuk e kuptojmë mirë qiellin, as stinët hënore. Ndaj, duke mos dashur të bëhesha e mërzitshme me pyetje të kota: kur, si, qysh e gjeputa të tilla, me të cilat e popullojmë dhe e bëjmë të pakëndshëm planetin tonë, u ula e iu drejtova shkurt:

-Po ju dëgjoj.

Mendova se kështu ishte më mirë dhe e vura theksin te fjala *ju*. Desha të krijoja me të edhe njëfarë largësie psikologjike, sado që e pata aq zili, sa doja të isha unë hëna në dritare e të kisha të gjitha përparësitë dhe pikëllimin e saj. Dhe sidomos të kisha ndriçim, të isha e paarritshme. Qetë-qetë, si të ishte mësuar me biseda të këtij lloji, ajo m'u drejtua me *ti*:

-Të ka rënë në dorë një poezi e poetit kinez Su Dung Po, në të cilën flitet për mua?

Tunda vetëm kryet për të mos e pranuar hapur paditurinë time. Sepse tundja e kokës është shenjë tepër e paqartë. Mohimi që shpreh një pjesë e planetit, është pohim në pjesën tjetër.

-Ai shkruan: "Hëna është varur në degët e shelgut si një merimangë".

E recitoi këtë varg, pa dëshirë, duke e këngëzuar dhe m'u nguli sytë e kaltër, në të cilët shquhej drita e zgjuarsisë. Zëri i kaloi nga tonet romantike, në një ton të ri patetik:

-Duke e imituar, shumë poetë të tjerë kanë shkruar se hëna qëndron e varur në qiell në një

fije merimangë; ose thjesht: hëna varet. Dikush tjetër shkruan se hënen e mban një kolltuk i argjenditë, që ndërron vend nëpër qiell. Leopardi më shëmbëllen me një të varur sipër pyllit: *E tu pendevi allor su quella selva*, thotë ai. Mund të sjell plot shembuj. Ata m'u kujtuan, ndërsa përmas dritares së hapur shihja një libër. Kur u afrova edhe më, dora që mbante librin m'u duk se drithërohej. Kjo ndodh me shpirtat e trazuar. Paskam një mike, mendova. Ja, pra, përse erdha. Që të flisja me dikë. Isha tepër e pikëlluar. Në disa krahina te ju përdoret shprehja: *Si pika e lisit kur pikon*. Kështu isha.

Unë u mahnitua nga përdorimi i shprehjes, por nuk dita as si t'i thurja lëvdatë dhe as si ta pyesja. Gjithsesi, qëllimin e vizitës së saj nuk e kuptova, ndaj iu përgjigja thjesht:

-Ti je hënë, mund të futesh lehtë nga dritarja dhe mund të thuash çfarë të dojë e bardha zemër.

Pasi shqiptova rrokjen e fundit, më tromaksi ideja e dritares së hapur nëpër natë. Një lloj ankthi, që nuk e kisha provuar më parë, u ul këmbëkryq në një kënd të dhomës si lakuriq i zi. Ajo e hetoi ngurrimin tim dhe foli:

-Një poet i dinastisë kineze të Sungëve të Jugut, në mes të një varke në liqen, përzien qiellin me liqenin e më krahason me një rrotëz akulli që ka mbetur mbi degët e pishave, apo me një pjatë nefriti që pluskon mbi ujë. Ai shkruan: "Hëna e ndritshme më shtyu të pija / I dehur prehem midis luleve / Për mbulesë qiellin / Tokën për nënkresë". Këto qëmtime i ka bërë një poet francez në poezinë *Shtegtimi i metaforave*.

Duke shqiptuar fjalën poet, ajo i mbylli paksa sytë dhe një mallëngjim i pangushëllueshëm e hodhi në greminën e harrimit. Unë rrija si e shtangur. Ajri jashtë kishte filluar të lëvizte përsëri. Ndihej shushurima e gjetheve të pemëve që vinte në atë dhomë si frymë paqësore e gjithësisë. Por, megjithatë, bashkë me idenë e qetësisë së hapësirave pa anë, jo rrallë është e pranishme edhe lemeria e një fundi të papritur. Unë ruheshja të mos e dëfteja me fytyrën time se më kishte mbërthyer frika e natës.

Mes heshtjes, si të zgjohej nga një gjumë i rëndë, hëna tha:

-Në poemën *Duke ëndërruar poetin Li-Bo*, shkruhet se *Hëna po vdiste mbi çati*. Ngjyrën time e kanë krahasuar edhe me ngjyrën e rërës në shkretëtirën e pafundme. Ka shumë raste të tjera që nuk dua t'i rikujtoj, se ligështohem.

-Mua më pëlqejnë këto metafora dhe krahasime, - thashë.

Fola dhe zëri m'u duk ndryshe, gati si i një fëmije. Është e pabesueshme, por jo më larg se atë pasdite, kisha kopjuar nga një revistë letrare: "Në vjeshhtë, kur pluhur drite derdh hëna", shkruar në vitin 1220 nga një murg. Po aty ishin disa vargje të një murgu tjetër, që, duke shpjeguar zanafillën e një poezie, shkruante se "hëna e lau borën me dritë e bardhësi" dhe se "shpirti është i mbushur me dritë". Ai e mbyllte poemën me fjalët: "O hënë e ndritshme!" Fjalën e ndritshme e përsëriste njëmbëdhjetë herë. Gjithsesi, nuk gjeta guxim të flisja për këtë rastësi fatlumur. Ajo i kuptonte mirë këto gjendje, sepse tha:

-Te *Balada e Kostandinit*, Kostandini i

vdekur kalëron me Doruntinën nën dritën time. Por unë ndriçoj edhe të gjallët. Gjergji, princi i Kastriotëve nën dritën time kapërceu fusha e male me trimat e tij, si të fluturonte për t'u kthyer në Krujë. Gjithçka tjetër flinte. Dëgjohej vetëm troku i kuajve nëpër natë. Ishte si një ëndërr e bukur dhe si një zgjim që vazhdon bukurinë e ëndrës. Ai duhet të jetë për ju drita dhe koha që bashkohen në një. E sjell ndër mend si tani atë natë të largët. Fytyra e hijshme e Gjergjit ishte pushtuar nga magjia e lirisë!

Unë mbeta gojëkrycur. Ajo bisedë po më joshte. Përmendja e princit Gjergj më ndolli një krenari të pamasë për të lidhur fort të tashmen dhe të shkruar. Befas u përtëriua me një vrull dhe forcë rinore. E kundrova hënë pa folur. Ajo e ruante në mënyrë të saktë fillin e mendimit të saj të mëhershëm:

-Poezitë më të bukura nën dritën time janë shkruar. Serenadat nën hënë këndohen. Dashuritë e mëdha netëve me hënë janë shpallur. Zhënievra nën dritën time e detyron Lansëlotin të kalojë provat e dashurisë, që, sipas kodit kalorsiak janë mizore. Tristani dhe Izolta të ndriçuar nga rrezet e mia, e kuptojnë se sytë e tyre fshehin dashurinë më të kobshme dhe duke shikuar nga unë, e japin frymën e tyre të fundit...

Kur pushoi, një psherëtimë e thellë ia lëkundti trupin mjegullor. Fjalët e saj ngjasonin si perla gjerdani në sfondin e zi të natës. Unë nuk po e ftilloja dot: isha e mrekulluar apo e tmerruar nga gjithë ajo stuhi dijesh? Sidoqoftë, në ato që thoshte hëna, më bëri përshtypje një vuajtje e rëndë. Dhe në mënyrë të vetëdijshme iu drejtova me ti, dhembshurisht, por guximtare:

-Përse je kaq e pikëlluar? Kur je lart në qiell ti vetëm rrezëllon. *Atlasi i hënës* të tregon sikur lahesha në dritë të kaltëreme. Fytyra jote shfaqet gjithnjë mospëfillëse, madhështore, si e dalë drejt e nga bota nistore.

-Është iluzion optik, - tha. - Po të më soditësh me kujdes, unë kam male dhimbjesh në trup. Të gjithë pishtarët janë fikur në shpirtin tim. Horizontet e mia i ka mbuluar vetmia. Më duket se jetoj gjithnjë mes mureve të larta të heshtjes. Dua të dal nga errësira e të hyj në dritë, por s'mundem. Shpesh herë më pushton një dëshirë për të vdekur.

Hëna ra në mendime, ndërsa unë mora zemër e fola:

-Poeti Naim Frashëri te libri *Tehajulat*, që shkroi në persisht, e që përkthehet *Ëndërrimet*, një poemë të gjatë ta kushton ty. Ai shkruan se mendja e njeriut gjen kthjelltësi nga drita që hedh hëna. Të quan "vashë të qiellit plot nur e stoli", frymëzim për vjershëtorët. Edhe në poemën *Qielli* të këtij libri, shumë vargje ty të kushtohen.

Këtë e dija saktë, por vura dorën në ballë për t'u siguruar. Në mënyrë që t'ia largoja sa më shpejt arsyetimet e zymta, shtova:

-Një legjendë jona për princin Gjergj thotë: "Në qiell kishin dalë në mes të ditës tri hëna që ndrinin më fort se dielli".

Pasi dëgjoi këto, mund të thoshe se sytë e saj u shndërruan në dy burime të fuqishme drite. Ishte tepër narsisik si veprim, por përligjeje me rëniën e saj psikologjike. E menduar, ajo tha:

-Mirë, por në disa këngë folklorike "hënë e përgjakur", shqiptohet sikur kjo të jetë cilësi e qenësishme imja. Ky nuk është portreti im i vërtetë. Ndërsa «hëna e plagosur» e zbut paksa këtë ide...

Unë doja të shtoja diçka, por ajo foli:

-Ndërsa një roman i Mesjetës më ka detyruar ta përqeshja pa keqardhje. Një nga personazhet e tij kujton se është duke fluturuar në ajër e ndodhet aq afër me trupin tim, sa po të zgjaste dorën, mund të më prekte. Një tjetër personazh aty trillon haptazi duke thënë: "Unë jam Kalorësi i Hënës së Bardhë". Madje rrëfimet për mua shkojnë deri atje, sa dikush shkruan se djalli e vodhi hënë dhe e futi në xhep si hajdut. Mbase e ke lexuar një tregim, në të cilin një personazh thotë: "Unë i qesha hënës". Është një njeri që ka mbetur në mes të borës në kërkim të dashurisë së humbur dhe ironizon, sikur unë të isha shkaktare e tragjedisë së tij.

\*

Hëna e kishte ndalur rrëfimin. E pikasja kur mbushej me frymë në mënyrë jo ritmike, megjithatë kujtesa e saj punonte vërtet si ndonjë aparat astronomik. Ktheva kryet për t'u parë në qelqin e dritares dhe vetja m'u duk e shpërfytyruar. Nuk e di përse më zaptoi një ligështim i madh. Nga sa tha hëna, u binda se jeta jonë e tokës, ishte errësirë. A kisha unë të kaluar, apo e gjithë jeta ime ishte pa kuptim?



-Hënë, të lutem vazhdo, - i thashë me një zë që shprehte përunjësi, sepse ajo mund të largohej papritur, ashtu si kishte ardhur.

- Rendi i gjërave është i lidhur me gjithçka që e përfiton gjallërinë nga lëvizjet në gjithësi. Mua më përdorin shumë sidomos në ëndrra. Ja si thuhet në njëren prej tyre: *“Një mace e zezë vraponte me një hënë midis dhëmbëve.”*

Ajo heshti pak, si të kërkonte fakte të tjera, pastaj shtoi:

-Edhe shën Antonit i dukem si një copë akulli përsosurisht e rrrumbullakët, mbushur me dritë të ngurtë. Dante Alighieri thotë: *«Hana ngjante si kovë e ndezun flakë ndër qiejt...»*

Kur nisi të citonte emra, vargje e fraza që i dëgjoja për herë të parë, unë mora qëndrimin e njeriut që nuk ka si të mbrohet nga padituria e vet. Mos po i ngjaja letrës së bardhë, në të cilën nis të shkruhet nga e para? Relievi malor tutje në largësi që pasqyrohej në qelqin e dritares si pikturë me bojëra uji, herë zmadhohej e herë zvogëlohej. Nata po mbruhej me heshtje.

-Ka edhe më, - vazhdoi. - Fëmijët e tokës më pandehin balonë. Është njëlloj si të mos ekzistosh. Njerëzit më kanë quajtur edhe *Flamuri i bardhë i natës*, kinse më kanë përkëdhelur.

Tunda kokën disi e pezmatuar. Ajo më drejtoi një buzëqeshje të mezidukshme, nga ato që shprehin mirëkuptim.

-Këtë gjë nuk e kam dashur, sepse flamuri i bardhë është shenjë dorëzimi.

Biseda e hënës sa vinte dhe bëhej prekëse.

-Por mund të tregoj edhe një gjë që më ka lënë mbresa të pashlyeshme. Para ca kohësh, në një muzg fluror bjeshkësh, një djalth me emër ylli i thoshte mëmës që t'ia jepte hënë në dorë si dhuratë. Kërkesa vinte gjer tek unë në formë lutjeje. Fjala e atij fëmije ishte si zgjimi i një shpirti profetik. Sytë i kishte të mëdhenj, plot shkëlqim dhe zërin e kishte shpirtëror. “Do të bëhet artist”, mendova. Ishte tepër mallëngjyese.

Hëna më hodhi një vështrim pyetës. Unë doja të mësoja se çfarë kishte parasysh ajo kur thoshte *“para ca kohësh”*, por hoqa dorë nga një pyetje që mund të përfundonte në grackë sofiste. Pastaj ajo mund të rrefente pjesë të jetëve mbi tokë. Dhe pjesë të jetës sime. Pikërisht këtë gjë nuk e pëlqoja. Ndërkohë bëra gati për të recituar tri vargje popullore, që të fshehura diku në një qoshe të trurit tim, ia behën në kohën e duhur. Duke nxituar, ata u futën nëpër labirintet e ndërlikuara të kujtesës. Mezi e mbërtheva njërin prej tyre:

*-Ndrinin si bora nën hënë!*

-Sa bukur! Ka ritëm. Ka melodi, - tha.

Kënaqësia e saj më nixti t'i drejtohesha sërishmi me ti.

-Këtu në tokë emrin tënd ua vënë vajzave. *Hëna, Hane, Hanë.*

Ajo më pa e çmeritur. Me siguri nuk e dinte. Desha t'i thosha se edhe mëmën time Hëna e quajnë, por mund të tingëllonte si e qëllimshme, prandaj vazhdova qetë-qetë idenë e nisur:

-Edhe dita e hënë prej teje quhet e tillë. Kam lexuar se tërheqja jote shkakton fenomene të jashtëzakonshme në oqean. Ti përtërihesh çdo 28 ditë dhe kjo kohë është masë e veçantë për gratë e sidomos për çupëlinat që kapërcejnë fëmijërinë dhe nisin moshën e dhimbshme të pjekurisë. Mëpastaj ato quhen detyrimisht zonjusha.

Këto ishin disa njohuri nga leximet, por mua m'u rrit besimi dhe shtova:

-Shkencëtarët të quajnë satelit të Tokës që e merr dritën nga Dielli. E vërtetë është?

Mirë që nuk thashë: *që ia vjedh dritën diellit*. Fjalën «vjedh» e përdorte një shkencëtar i ri amerikan, në një revistë të kohëve të fundit.

Në fytyrën e saj u vizatua një shprehje ngurrimi:

-Si mund ta di të vërtetën time? Askush s'ia ka arritur.

-Këtu në tokë ekzistojnë shprehjet: *Disku i hënës. Hënë e plotë. Hënë e re. Drapri i hënës. Hënëza. Dritë hëne* dhe shumë të tjera.

E shmanga me kujdes shprehjen *Hënë e ngrënë*, se m'u ngjeth mishtë, por kur e diktova se hëna po më vëzhgonte me një kureshtje të sinqertë, fola pa drojë:

-Nuk mungojnë as shprehjet: *Është i përhënur*, domethënë i paqëndrueshëm, tekanjoz. Kërkon apo *Premton hënë*, pra të pamundurën. Ose: *Është me hënë të keqe*, domethënë, i zemëruar pa shkak.

Për shprehjen *Është i përhënur*, unë i fsheha shpjegimin që thotë se njeriu, i cili bie nën ndikimet e hënës, është përgjithësisht jashtë realitetit dhe ka faza çmendurie.

-Njerëzit e kohës tënde janë të lirë të mendojnë ç'të duan, por sufistët persianë

kanë shkruar se prej hënës gjaku i njeriut merr freskinë, - tha ajo me ton paksa të mëritur.

-Pa hënë s'do të kishte jetë mbi tokë, - nxitova unë të ndreqja gabimin duke menduar se e kisha tepruar me ngjyrimet negative. Dhe m'u kujtua një shprehje me ton pozitiv:

*-Fytyra si hënë*, thonë për një fytyrë të bukur që shkëlqen nga rinia.

Unë përqipsha ta sillja në humor që të vazhdonte bisedën e nisur dhe i rrëfeva një përrallëz të moçme:

*-Në një kohë shumë të largët nuk ekzistonin as hëna dhe as yjtë. Kishte vetëm një diell të madh, tepër të madh, aq afër Tokës sa nxehtësia që lëshonte, ishte e padurueshme. Atëherë një gjahtar trim rrëmbëu harkun, vuri shigjetën më të fortë dhe e gjuajti diellin me një fuqi të atillë, sa ai shpërtheu menjëherë. Xixat fluturuan në të katër anët dhe u transformuan në cifla: më e madhja u bë hënë, të tjerat u bënë yj.*

Pas kësaj fytyra e hënës përftoi sërish magji. Ajo po jetonte një nga ato përpunimet e brendshme, që përmes një mrekullie të errët flasin për ekzistencën dhe për elementet e vëzhgimit të përrjetshëm...

\*

Duke e lënë hënë në botën e saj hënore, e hodha vështrimin jashtë. Në hapësirën e pafundme ndihej hapi i shpejtë i natës që binte mbi gjysmëbotë. Me sytë e mendjes po shihja një agim të largët, zjarrin e tij që përhapej i furishëm e gazmor. Një korije dhe hijet e saj të freskëta. Dëgjoja zhurmërimën e një lumi malor që rrjedh për te poshtë sikur këndon. Pastaj, në mes të një lëndine u lartësua një altar në formën e një libri. Çfarë bote ishte ajo që shfaqej para syve të mi?

Kur e ktheva kryet sërish nga hëna, ajo e ruante ende ngazëllimin. Duke besuar se bashkëbisedimi ynë duhej ushqyer, unë citova një fjalë të urtë:

*-Fëmija pa nënë, si nata pa hënë.*

-Oh, qenka e rrallë, - ma preu fjalën ajo.

Nga balli i lëmuar, gjer te mjekra e vogël, që e kishte si një figurinë rrethore gjeometrike, filloi t'i binte një nur i jashtëzakonshëm. Kur buzëqeshi, përngjasonte me ato lulet e natës që çelin para dritares së një shtëpie të vogël fshati duke dëshmuar heshturazi për atë që është njëkohësisht e thjeshtë dhe e hirshme.

-Thuhet edhe *Vit hënor*, sipas kalendarit arab. *Peizazh hënor*. Apo *Fytyrë e zbehtë hënore* për një foshnjë që jep shpirt...

Këto, merret vesh, i lexoja në një fjalor, por ajo befasi nxori një pasthirmë mospëlqimi:

-Oh, joo!

Pastaj mbështeti kokën mbi dorën e majtë dhe humbi në mendime. Brenda syve i rridhte një hidhërim i pashërueshëm si krojet e turbullta të dimrit. Melankolia, të cilën nuk i kisha vënë aq rëndësi në fillim, po nderej tani kudo si një cipëz e hirtë. E kisha parë sa herë në rininë time hënë dhe e krahasoja me një pasqyrëz argjendi midis yjeve. Duke ndritur horizontin, ajo e bënte mjedisin të njohur, të afërt, frymëzues. Ishte vërtet diçka e pashpjegueshme. Doje t'i drejtohesha, t'i flisje, t'i tregojë sekretet. Mistikët thonë se këtë veti e kanë gjërat sublime.

Tani e kuptova se edhe ajo kishte brengat e saj.

-Zambakëve të bardhë u thonë edhe *hënë uji*, - thashë për ta gjallëruar bisedën.

-Hënë uji?!

Ajo e përsëriti pas meje, me një ton që

shprehte mahnitje, pastaj priti që të më dëgjonte sërish. Mua më erdhën papritmas në kokë disa mendime të kthjellëta:

-Vasha bukurinë hënës ia zbulon. Madje një këngë popullore e hershme thotë: *Vasha hënë e djali yll*. Ose: *E kishte ballin si hënë*. Ose: *Hëna i kish mbirë në faqe*. Ose edhe: *Si hëna që shndrit në pyll...* Ju e dini që nën hënë këndon bilbili, - e përfundova unë frazën dhe pata një ngurrim të beftë duke menduar se kisha folur shumë.

-Bilbili vdes duke kënduar për dashurinë. Një poet i ka kushtuar një odë dramatike, - tha ajo.

Ndërkohë që përqipsha të gjeja emrin e poetit, hëna foli sërish:

*-Rêveur lunaire*. Të pëlqen? Në gjuhën tuaj do të thotë *Ëndërrues hënor*. Ndërsa *coeur lunaire* në shqip është një fjalë e vetme: *zemërhënor*.

-Mund t'i përsëritni pak njëherë shqip dhe pastaj frëngjisht? - i thashë.

Ajo i përsëriti ato fjalë në të dyja gjuhët, me një shqipe dhe një frëngjishte aq të kulluar e melodioze, sa mund të thoshe se kishte ardhur njëkohësisht nga *Tirana e Re* dhe nga *Lagjja Latine* e Parisit.

Në fytyrën time mund të shihje lumturim të çastit, por zhgënjimi i njeriut që e kupton se në çfarë cektine është zvarritur mendja e tij deri atë çast, ishte i madh. Pastaj me një zë që luhatej, si të kisha dhimbje, e pyeta:

-Ku i keni mësuar të gjitha këto?

Hënës mbase iu duk pa vend kjo pyetje, por u përgjigj:

-Kam filluar që në Greqinë e lashtë me studimet në “Akademinë e hënës”, themeluar nga Platoni. Por, fillimisht u njoha me mitologjinë. Grekët e lashtë më kanë shenjtëruar. Kisha tempuj të panumërt. Ata më kanë mishëruar me emrin e perëndeshës Artemis. Edhe romakët më mishëruan pastaj te perëndesha Dianë. Të pashpjegueshme jepen marrëdhëniet e këtyre perëndeshave të gjahut me mua. Ato paraqiten me hark e me shigjetë, të rrethuara me nimfa dhe me dritë, ku krahas dëshirës së virgjërisë, shprehet hakmarrja dhe mizoria. Drurët e pyjeve ku shkojnë për gjah Artemisi dhe Diana, qarkohen nga bishat. Përse e lidhin njerëzit praninë e këtyre egërsirave me ekzistencën time?

Nuk dija ç'të thosha. Diku pata lexuar se hëna i vjen ndonjëherë dheut më pranë e i bën njerëzit të marrë. Madje një legjendë orientale thotë se hëna i tremb nënat e reja aq shumë kur i gjen natën të përgjumura, sa u ikën qumështi. Në mitologji thuhet se Moirat, hyjneshat që tjerin fatin, janë hyjni hënore. Doemos, këto m'u dukën të ashpra për një bisedë miqësore. Pranda doja ta befasoja me titullin *Histori komike e shteteve dhe e perandorive të Hënës* dhe përsëri hoqa dorë. Fjala *komike* nuk shkante. Duke qenë se hëna ishte perëndesha më e rëndësishme e popujve paganë, i kujtova:

-Popujt paganë ishin adhuruesit e tu të mëdhenj.

Ajo tha disa gjëra që ishin fare të panjohura për mua. Dijet e saj ishin kozmike. Pikërisht atë çast ndodhi diçka e paimagjinueshme. Në të djathtë time, u shfaq një ekran i kaltër, si iris i zmadhuar. Fillimisht në sipërfaqen e tij u ravijëzuan një seri njollash të errëta, të cilat u zhdukën. Pastaj doli një ngjyrë e verdhë, në portokalli, mbi të cilën ishte shkruar diçka me bojë të zezë, të shndritshme. U përqendrova dhe pashë pika, vija, numra.

Kur ula kokën, figurat e ekranit ishin

stampuar edhe në faqen e fletores së hapur. Ekranu i shua pas një çasti dhe unë mbeta e çoroditur. Hëna më sqaroi se ishin numrat *maya*. Mesa duket edhe nga ana e hënës ekranu punonte po njësoj. Kur u ndez sërish, ai zuri të pasqyronte shkronja që duke u kryqëzuar në mënyrë vertikale dhe horizontale, përfundonin në fjalë të shumëkuptimshme, në vargje poetikë, në sentenca që lëviznin pa pushim. Kështu mbase shfaqet krijimi, në forma ikanake e të stuhishme. Duke e menduar atë dhomë që ndodhej në një kënd të zakonshëm e të parëndësishëm të asaj që quhet botë, unë ndjeva marramendje. Dhe i ngula sytë në një pikë të pacaktuar. Hëna, mes këtyre çasteve shumë vendimtare për jetën time, vazhdoi:

- Në Peru njoha qyetërimin inkas dhe një qendër të famshme arkeologjike parainkase. Pashë qytetin me tarraca në mal. Arkitektura inkase është e madhërishme. Inka është emri i njërit prej themeluesve të perandorisë. Feja e tyre ishte dielli. Në sytë e inkas majat e maleve me borë nuk ishin thjesht male, por zota diellorë. Sipas tyre, ai që udhëton, mund të hyjë në kontakt me hyjnitë.

Ekranu u ndriçua dhe në të u shkrua me shkronja shtypi:

FAC SAPIAS ET LIBER ERIS

Përkthimi në gjuhën shqipe nuk u vendos menjëherë pas thënies latine, por unë u lehtësova. Dihet se në gjuhën e bukur të mëmës, fjala peshon më shumë. Edhe hëna shqip fliste. Por si? Ku e kishte mësuar? Ajo që thoshte, nganjëherë merre trajat e një leksioni, ndaj gjeta rastin të përhumbesha sërish në përfytyrimet e mia.

“Gilgameshi në kërkim të pavdekësisë i falet hënës.”

Kjo frazë u shkrua në ekran dhe në fletoren time me shkronja të stilizuara. Hëna vazhdonte kuvendin. Duke e dëgjuar, bindeshe përherë e më tepër se ajo kishte një aftësi të rrallë të ishte e shpenguar dhe pa paragjykime, sikur të gjendej në strehën më të sigurt të ligjërimit. Ajo ma hodhi shikimin për të kuptuar nëse po e dëgjoja...

\*

Ekranu shkëlqeu nga një dritë e blertë dhe pastaj u shfaqën numra, formula dhe simbole që rrezatonin bukuri me format e tyre të përkryera e me rrënjët katrore magjike. Ato ndenjën gjatë në ekran, dhe unë për herë të parë gjatë asaj nate, dremita. Kur hapa sytë, për çudi fletët e fletores ishin gjithë formula e simbole si ekranu.

Unë vështroja fletët e fletores si e topitur ndërkohë që në ekran doli një aktor. Nuk mund të mendoja ndryshe, se ai kishte veshje skenike, u vendos në qendër dhe recitoi:

“Vargu i ditëve të hirta sjell mjerim në botë. « Lègue-nous de ne pas mourir désespéré ». Dashuria është balonë që ngjitet në qiell. Një zog fluturon tej qelqit të dritares si përfytyrim. *Go 1 v.i.* (past went; *p.p. gone / gon/), walk, travel, proced ...* Bota merr ngjyrimin e asaj që themi. Frymëzimi është burim i shenjtë. *Sous le pont Mirabeau coule la Seine*. Ujërat e thella janë të kthjellëta. *Im Anfang war die Tat. To a child dancing in the wind. El madrigal triste de los ojos azules...* Pasqyrimet ngjyrë vjollcë sjellin fatkeqësi. Fytyra e butë ka vështrim ëndërrues. Übersetzerhaus Looren. Lopët i hanë lulet. *Ombra odorata*. Mbi tokë ka zbritur errësira. Sa keq që njeriu shmanget nga qëllimet e mira. Puna e imët është e mundimshme. *Se questo è un uomo*. Sa më i lartë të jetë lisi, aq më shumë e rrahin erërat...”

Ekranu e rrotullua e dha portrete grash, të pikturuara me stile të ndryshme. Poshtë tyre shkruhej sipas përkatësisë: grua e bukur, grua fatale, grua e fortë, grua e padukshme... Kishte pastaj trupa me forma të pakuptueshme, që sa shfaqeshin, zhdukeshin. Kishte odaliska. Një kimerë ishte e tëra në dritëhije, i dallohej vetëm koka dhe gjoksi si e një luani. Pas kësaj, ca ravijëzime tregonin për historinë e ngathët të metamorfozave. Sirenat që donin të rrëmbenin të folurën e Uliksit, dilnin e futeshin në një oqean që bëhej kristalor nga çdo lëvizje.

Në mënyrë të beftë unë recitova një varg ku përmendej hëna:

*-Kudo është Bukuria / në qiej, në dhe, në hënë.*

Në ekran u shkrua: *Guri i hënës; Moonstone; Pierre de lune; Mons lunae; Luneville...*

Pjesë e shkëputur nga romani *Vetëvrasia e hënës*, Botimet Erik, 2015.



Zonjusha e dobët flokëthinjur kishte zshytyrë mënjanë vazot prej qelqi me zymbylë, kishte mbështetur bërrylin e majtë mbi parvazin e dritares dhe e përkulur po qëndronte atje e ulur në dritën e dëborës. Jashtë në kopshtin e vogël përpara shtëpisë shkrihej një bardhësi verbuese, e ndërprerë nga gjurmët e këmbëve, ngadalë nën diellin e mesditës; rreth pemëve rridhnin rrëke të imta të zeza. Dhe ndërsa zonjusha e përkulur po ndiqte me sy rrëketë e zeza, ajo befasi e dinte se do të vdiste së shpejti.

E hoqi bërrylin e majtë nga parvazi i dritares, kryqëzoi duart e vogla të imëta, e mbështeti kurrizin në shpinoren e karrigës. Zonjusha qëndroi e mpirë e ulur prapa vazove prej qelqi të zymbylave. Kur ra këmbana, ajo eci drejt tryezës, mori një kafshatë dhe vendosi pirunin. Doli nga mensa. U ul në dhomën e saj. Ajo qëndroi e ulur gjatë tërë ditës në dhomën e saj, me fytyrën e tretur nga muri. Shkëlqimi që vinte nga dëborë e rënë, që hynte brenda në dhomë, u zbeh; mbi letrën e murit ngjyrat u fashitën. Dy duar që dridheshin ngritën në errësirë qelqin e llambës prej vajguri; llamba u shua sërisht furishëm. Fustanet ranë përtokë. E shtrirë në krevat ajo mori frymë, duke ndaluar, herë shpejt e herë thellë. Gjatë tërë natës qëndroi e shtrirë atje me sy të hapur. Fytyra e saj nuk lëvizi në errësirë. Hëna u shfaq përpara dritares së saj të vogël rreth mesnatës. Ajo qëndroi atje e bardhë gjatë gjysmës së natës, dhe vetëm kur ora shënoi katër e gjysmë, ajo u largua.

Paradite, e veshur me fustanin e saj të zi me mëngë të ngushta, eci e përkulur me hap të njëjtë nëpër parkun prapa manastirit. Poshtë pemëve të zhveshura zonjusha eci pranë shoqes së saj shtathedhur. Ajo fliste herë pas here, ngrinte qepallat e rrudhura nga sytë që tashmë ishin veshur me një mjegull të hollë. Përsëriteshin fjali të parëndësishme.

Kur hëna u shfaq përpara dritares së saj të mbyllur me perde, shtrati i lëneshës u lëkund. Gishtërinjtë e saj u mblodhën fort në të dyja cepat e tij; ajo u drodh, u ngjesh fort në shtrat, aty nga mëngjesi rënkoj shpesh. Oh, lëmshi i mbledhur, qante në heshtje, futur poshtë batanijes, dhe fjeti vetëm kur ishte zbardhur.

Të nesërmen në veprimet e saj kishte një shqetësim. Ajo e kapërdiu vaktin, shpeshherë hidhej përpjetë, dërdëlliste, siç nuk e kish bërë kurrë ndonjëherë, ndërpriste bisedat e tyre dhe përkëdhelte veten. Qëndroi e ulur për një kohë të gjatë në mensë, me supe të lëshuara, e përkulur. Ditën ajo nuk shkoi në dhomën e saj. Në mbrëmje më kot u lut shoqes së saj të flinte tek ajo. Pastaj u duk sikur dikush po e shtynte lëneshën përtej pragut të derës. Ajo e vuri shpejt llozin prapa vetes, mbylli dritaren, spërkati muret me kolonjë, vendosi mbi tryezë dhe sobë, poshtë portretit të Shën Mërisë në qoshe, lule, lule që lulëzonin, aq shumë sa mundi të gjente; edhe mbulesa të bardha dhe të kaltra, të cilat i kishte në raftin e saj, dhe i shtrio sipër karrigeve. Pastaj befasi u ul të qante gjatë, me marrëzi dhe kokëfortësi.

Natën orët në dhomë bënin tiktak. Dy orë të varura atje; njëra po e gëlltiste kohën në mënyrë të plogët dhe blegërinte çdo gjysmë ore, pastaj ishte e ngopur, por vazhdonte të përtypej; pranë saj qeshte mbyturazi ora e Shvarcvaldit, ajo lëkundej, nuk merrte frymë dhe thua një rrokullisej kur lëshonte klithmën e mjerë. Zonjusha kërceu nga shtrati dhe i kapi lavjerrësit fort. Teksa qëndroi sërisht pa lëvizur, brenda orës së vogël vezulloi një dritë, fytyra e orës së madhe u shtrembërua në një ngërdheshje. Atëherë ajo hodhi fustanet përreth, doli me vrap nga dera, drejt e në park. Sytë e saj u ngulën te shkurret e zeza të shpupurishura: "Duhet të vdes, unë duhet të vdes." Duke qëndruar pranë përroit që po avullonte në zbardhëllim, vështroi përpara vetes ngultas me shikime vezulluese. Eci duke u fundosur



## LËNESHA DHE VDEKJA

Nga Bruno Alfred Döblin

Përktheu nga gjermanishtja: Dr. Elda GJANA-BORIÇI

brenda me gulçim me zë të lartë, me sytë e mbyllur me pahir, në ujë bëri pllaj-plluq me duart e vogla, të thata, befasi u rrotullua, u kthye mespërmas pemëve të zeza në shtëpi. Zonjusha plakë qëndroi përpara dritares së saj. Kur zbardhi më shumë, buzët iu drodhën edhe një herë, sërisht iu drodh tërë trupi, buzët iu puthitën me njëra-tjetrën, ra me shpinë mbi shtrat. U ngjesh si një trung në mes të shtratit. Nofullat i ishin shtrënguar, ajo po rënkonte. Sytë herë i shkëlqenin nga dritarja e herë nga dera. E heshtur tërhoqi mbulesën sipër vetes.

Ditët e ardhshme ajo kalonte e heshtur, spërkaste edhe një herë në

mbrëmje dhomëzën e saj me ujëra erëmira, por filloi përsëri veprimet e saj të vjetra. Lutjen, qëndisjen, lojën me letra. Ajo gjithashtu ulej sërisht për një kohë të gjatë prapa vazove prej qelqi me zymbylë. Atje ajo qeshte herë pas here me vete duke u dridhur. Fliste gjithnjë e më pak nga ç'e kishte bërë zakonisht, me zonjat e tjera, aq sa midis tyre lindi një thashethem për natyrën e saj mendjemadhe. Vështrimi me të cilin ajo fshikullonte tryezën, në fakt herë kishte diçka të çuditshme e herë diçka therëse mendjemadhe.

Tanimë ditët u bënë më të ngrohta. Shëtiste për orë të tëra në rrugët e parkut të ngjitura ngushtësisht; aty ku ajo ecte dhe qëndronte, përreth vërtitej një ëndërr. Qante herë pas here, në një mënyrë të butë, vërshuese, e cila tingëllonte si një këngë e re. Pastaj vajza plakë vështroi rrudhat e duarve të saj, fshinte përpara pasqyrës lëkurën e thatë e të flashkët të fytyrës, prekte gjoksin e thatë dhe gërmonte rreth tij. Ajo

qëndronte atje pa lëvizur teksa zhishej thua një gjysmë ore kështu. Pastaj shtrihet, rrëqethet nga të ftohtët si më parë, gishtërinjtë e saj donin të kapeshin fort te cepat e shtratit, por shpejt ajo mbështetej te muri, linte një vend të vogël pranë vetes, që e mbulonte me krahun, pastaj e hiqte krahun përsëri, e vendoste sërisht përsipër. Ishte një lojë. Krahët e shtrënguar në gjoks, fytyrën e nxehtë e thatanike të kthyer nga vendi i zbrastë i jastëkut, qafën të zgjatur. Trupi i saj i dobët tundej si në netët e parë, shpejt gishtërinjtë e saj kërkuan sipër jastëkut, buzët e saj u zgjatën.

Kur në tërë rrugët kishte gjetheza të gjelbra, ajo u zburkua për shëtitjet e saj, veshi një bluzë të kaltëreme; në duart me doreza të bardha mbante lule, shukulla, që i kish prerë, trëndafilë kërcellgjatë. Ecte në gjelbërim në mënyrë më elastike dhe më drejt. Kur nuk përgjohej në shkurret e dendura, atëherë ajo përkulej me mirësjellje, zgërdhihej brenda luleve të saj, ecte si duke kërcyer me gojëzën e saj të ëmbël. Po, ajo shkruante letra të thjeshta mbi trëndafilat prej letre, ato fillonin kështu: "zonjës sime të dashur strikte, vdekjes", letra plot me aludime të druajtura, me shakara; ajo i tregonte ato përballë dritares së saj të hapur, natën i vendoste poshtë parvazit të saj, i fshihte në kaçube. Lëneshat e ndiqnin shpesh me sy nga shtëpia; njeriun, për të cilin zonjusha flokëthinjur zburkurohej, nuk e gjeti askush. Atë e shikoje gjithmonë vetëm duke u vërdallosur diku dhe duke qëndruar në këmbë; me një shprehje të krekosur fytyre ajo kalonte pranë zonjave që vëngëronin me kureshtje; zonjat i thonin njëra – tjetrës

nga dita në ditë e më të bindura se zonjusha barte dëshira me mëkate, herë pas here diskutonin që ta përjashtonin nga shoqëria e tyre.

Ndërkaq pranvera afro, u bë gjithnjë e më ngrohtë. Dhe një mbrëmje lëneshë plakë u kthye nga shëtitja e saj në dhomën e vet, me tërfillin e kuq që kish këputur, me shumë thupra e kotele maji. Fytyra e saj shkëlqente. Ajo këndonte me zë të ulët; hapi dyer e dritare. Lulet i vuri poshtë portretit të Shën Mërisë. Pasi i kishte vendosur lulet, u tremb nga figura e Shën Mërisë, ra në gjunjë dhe u lut. Por me një buzëqeshje hokatare ajo vari degët dhe gjetet mbi portret, kështu që fytyra e Shën Mërisë ishte fshehur plotësisht.

Ajo këndoi ende nën zë me fytyrën që i shkëlqente në natën e ngrohtë pranverore, u shtri.

Dremiti. U zgjua në errësirë. Në dhomë u dëgjua hapa të rëndë. Shtrati kërciti. Me një kërcim vdekja u hodh pranë saj në shtrat. Atje ishte një vend i lirë. Vdekja e kapi nga gjunjët. Ajo gulçoi. Vdekja e goditi me pëllëmbë mbi shpatulla si një fshatar harbut. Atëherë grushti i mbledhur i ra mbi gjoks, mbi trup, mbi trup, dhe sërisht mbi trup. Buzët e saj u përgjyruan. I erdhi një mbytyje. Gjuha i zuri grykën. Ajo u shtri.

Atëherë vdekja u ngrit, e tërhoqi lëneshën pas vetes nga duart e vogla të ftohta dhe e nxori nga dritarja jashtë.

**Bruno Alfred Döblin** (lindur më 10 gusht 1878 në Stettin, † 26 qershor 1957 në Emmendingen) mjek psikiatër dhe shkrimtar gjerman.

Vepra e tij epike përfshin shumë romane, novela dhe tregime, krahas tyre ai shkroi ese satirike dhe polemika me pseudonimin Linke Poot. Si një ekspresionist udhëheqës dhe pionier i modernizmit letrar në Gjermani, Döblin-i bashkoi herët shfaqjet radiofonike dhe skenarët në veprën e tij. Në vitin 1920 botoi romanin historik Valenshtajn.

Döblin si një teoricien avangard romantik me shkrimet "Për romancierët dhe kritikët e tyre", "Programi i Berlinit", "Vërejtje mbi romanin" dhe "Ndërtimi i veprës epike" çliroi impulse të shumta në prozën narrative. Deri tani, romani i tij më i mirëpritur është "Berlin Alexanderplatz".

Alfred Döblin vinte nga një familje hebrejsh të asimiluar. Kur ishte dhjetë vjeç, babai i tij u nda, largimi i papritur i babait e traumatizoi djalin. Në vitin e tij të fundit në shkollë, Döblin shkroi disa tregime dhe një roman të shkurtër. Pas mbarimit të shkollës së mesme, ai studioi mjekësi, mbrojtiti doktoraturën në vitin 1905 dhe u bë ndihmës-mjek në një institucionin psikiatrik për të sëmurët mendorë në Regensburg. Në vitin 1912 u martua me studenten e mjekësisë Erna Rajsin.

Metropoli i Berlinit u bë shtëpia e vërtetë e Döblinit. Ai u bashkua me Rrethin e Stuhisë. Döblin u bë një nga eksponentët kryesorë të letërsisë ekspresioniste me përmbledhjen e tregimeve "Vrasja e një lule lëndine dhe tregime të tjera të shkurtra" (vëllim me tregime), si dhe romanet "Tre kërcimet e Vang-lun" dhe "Malet, detet dhe gjigantët".

Döblin është një nga romancierët më të rëndësishëm të ekspresionizmit.

Në Luftën e Parë Botërore ai shkoi si mjek spitali në frontin perëndimor. Në Republikën e Vajmarit, Döblin u bë një nga intelektualët kryesorë të krahut të majtë.

Në vitin 1933, hebreu dhe socialisti Döblin u largua nga Gjermania dhe u kthye pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, vetëm për t'u larguar sërisht në vitin 1953. Pjesë të mëdha të veprës së tij letrare, duk përfshirë "Tetralogjinë e nëntorit" dhe romanin e fundit "Hamleti ose Nata e gjatë e ka një fund", janë pjesë e letërsisë së mërgimit.

Shkëputur nga vëllimi me tregime "Die Ermordung einer Butterblume und andere Erzählungen"

Kur isha rreth dhjetë vjeç, më kujtohet, babai më kapi për dore një të diel pasdite dhe dolëm në pyll për ta dëgjuar këngën e zogjve. U përshëndetëm me nënën, e cila duhej të qëndronte në shtëpi për ta gatuar darkën, prandaj nuk na u bashkua. Dielli po shkëlqente ngrohtë dhe ne ishim në rrugë të mbarë. Nuk e morëm aq solemnisht këtë me këngën e zogjve, sikur diçka veçanërisht e këndshme apo e çuditshme, ne ishim njerëz të arsyeshëm, si babai, ashtu edhe unë, të edukuar dhe të mësuar me natyrën. Kjo nuk bënte ndonjë bujë të madhe për ne. Ishte vetëm sepse ishte e diel pasdite dhe babai ishte i lirë. Po ecnim në linjën hekurudhore, ku askush tjetër nuk lejohej të shkonte, por babai ishte mësuar me rrugën pranë hekurudhës dhe e zotëronte atë. Në këtë mënyrë edhe ne u futëm në pyll. Nuk u desh të bënim asnjë kthesë. Së shpejti filloi edhe kënga e shpendëve dhe gjithçka tjetër; cicërima brenda shkurreve të fokave dhe zogjve këngëtarë, harabelave dhe mëllenjave, gjithë zhurma e tyre që të rrethon sapo hyni në pyll. Toka ishte e trashë me lulebore, mështeknat tani kishin bleruar dhe bredhat ishin lëshuar lastarë të freskët. Vinte erë nga të gjitha anët dhe skutat. Në anën e poshtme shtrihej fundi i pyllit që avullonte nga dielli sipër. Kudo ku kishte jetë dhe zhurmë, nga vrimat e tyre fluturonin grerëzat, mushkonjat vërshonin nga qielli dhe nga shkurret zogjtë lëshoheshin si fishekë për t'i kapur dhe zhyteshin përsëri shpejt. Papritur erdhi një tren duke zhurmuar dhe ne zbritëm në argjinaturë. Babai e përshëndeti lokomotivistin me dy gishta ngritur mbi kapelë, edhe lokomotivisti e përshëndeti babanë me dorë. E tëra ndodhte shpejt. Më pas u nisëm drejt shinave që ishin djersitur në katranin e tyre nën rrezet e diellit. Mbante erë gjithfarë, vaj vagonësh dhe lule bajame, katrani dhe shqope dhe gjithçka tjetër. Ne bëmë hapa të mëdhenj në hekurudhë dhe jo në zhavorr, që ishte i ashpër për të ecur dhe na i griste këpucët. Binarët shkëlqenin në diell. Në të dyja anët e linjës kishte shtylla të telefonit që këndonin derisa kalonim pranë tyre. Po, ishte një ditë e bukur. Qielli ishte mjaft i kthjellët, nuk dukej asnjë re, as nuk mund të kishte ndonjë re në këtë ditë, sipas asaj që tha babai. Pas ca çastesh ne erdhëm te një arë me tërshërë në të djathtë të linjës, ku një bujk që e njihnim kishte një luadh. Tërshëra ishte e dendur dhe kallinjtë ishin rritur në mënyrë të barabartë. Babai i largonte me dorë dhe dukej se ishte i kënaqur.

Thjesht nuk kuptoja shumë gjëra nga këto, sepse kam lindur në qytet. Kështu ne erdhëm tek ura mbi një përrua ku zakonisht nuk ka shumë ujë, por tani rrjedha ishte e plotë. I mbanim dorën njëri-tjetrit që të mos binim mes binarëve. Më pas nuk kaloi shumë kohë para se të arrinim në shtëpizën e rojeve, e cila është tërësisht e mbuluar me gjelbërim, me mollë dhe shkurre. Aty hymë dhe vizituam. Na qerasën me qumësht. I pamë derrat e tyre, pulat dhe pemët në lulëzim, pastaj e vazhduam rrugën tonë.



## UNË DHE BABAI

### Nga Pär Lagerkvist

(fitues i Çmimit Nobel për Letërsi më 1951)

Përktheu: Qerim Raqi

Ne donim të shkonim te përroi i madh, sepse ishte më i bukuri se kudo tjetër, kishte diçka të veçantë, sepse atje më lart në fshat kalonte kah shtëpia e fëmijërisë së babait tim. Nuk na pëlqente të ktheheshim derisa arrinim deri këtu. Madje edhe sot mbërritëm këtu pas një shëtitjeje të mirë. Ishte afër stacionit tjetër, por nuk shkuam deri aty. Babi vetëm donte të sigurohej që semafori ishte mirë. Ai i mendonte të gjitha. Ndalua buzë përroit. Rrjedha zhurmonte miqësisht me rrezen e diellit. Përgjatë brigjeve varej pylli i harlisur gjetherënës dhe reflektohej në ujin e levës. Gjithçka ishte e ndritshme dhe e freskët këtu. Nga liqenet e vegjël më lart vinte një erë e vogël. Ne zbritëm nga shpati dhe ecëm pak përgjatë bregut.

Babai tregoi vendet ku kishte qëndruar më parë. Këtu ishte ulur si çun, në shkëmbinj, duke pritur me purtekë gjithë ditën. Shpesh nuk kishte ardhur asnjë gjallesë, por kishte qenë një realitet i bekuar. Tani ai nuk kishte kohë. Kështu që ne shkonim përreth duke fërshëllirë për një kohë të mirë nëpër vijën bregdetare, nxirrim copa lëvoresh të halorëve që rryma i merrte me vete dhe hidhnim guralecë në ujë për të parë se kush gjuante më larg. Ne për nga natyra, si babai ashtu edhe unë, ishim të lumtur dhe të hareshëm. Më në fund, u lodhëm dhe menduam se

kishim qëndruar mjaft aty dhe u nisëm për në shtëpi. Pastaj filloi të errësohej. Pylli kishte ndryshuar. Nuk ishte ende errësirë, por nxituam. Nëna duhet të ketë qenë e shqetësuar derisa na priste për të ngrënë. Ajo gjithmonë kishte frikë se diçka do të ndodhte. Por, për ne ishte një ditë e mrekullueshme. Asgjë nuk na ndodhi. U kënaqëm me gjithçka.

Po errësohej edhe më. Pemët ishin shumë të çuditshme. Ato qëndronin dhe i bindeshin çdo hapi që hidhnim, sikur të mos dinin se kush ishim. Një pemë aty kishte një xixëllonjë brenda trungut. Qëndronte duke na i ngulur sytë poshtë në errësirë. Unë i shtrëngova dorën babait, por ai nuk e pa atë shkëlqim të çuditshëm, vetëm vazhdoi të ecte. Ndërkohë arritëm tek ura mbi përrua. Nga thellësia aty dëgjohej zhurma e përroit. E frikshme, që sikur donte të na gllabëronte, që sikur do të hapej një humnerë poshtë nesh. Shkelnim me kujdes traversat, duke ia mbajtur njëri-tjetrit fort dorën që të mos rrëzoheshim. Unë mendova se babi do të më mbante në shpinë, por nuk tha asgjë, mbase donte që unë të isha si ai dhe të mos mendoja se kishte ndonjë rrezik. Vazhduam. Babai kalonte urën aq i qetë, me hapa të sigurt, në errësirë, i qëndrueshëm, pa folur, mendonte me vete. Nuk mund ta kuptoja se si mund të ishte kaq i qetë kur ishte aq errët. Shikoja përreth i frikësuar. Kudo

mbretëronte vetëm errësirë. Mezi guxoja të merrja frymë thellë, sepse atëherë mund ta fusja brenda meje errësirën dhe kjo ishte e rrezikshme. Mendoja se së shpejti do të vdisja. Më kujtohet mirë se këtë e besoja në atë kohë.

Argjinatura zbriste pjerrtas, si në humnerat e zeza të natës. Shtyllat e telefonit ngriheshin fantazma deri në qiell, gjëmonin lehtë brenda tyre, sikur dikush të fliste thellë në tokë. Plisat e bardhë prej porcelani qëndronin tmerrësisht të strukur dhe i bindeshin kësaj. Gjithçka ishte e tmerrshme. Asgjë nuk ishte e vërtetë. Gjithçka ishte si një mrekulli. Iu afrova babait dhe i pëshpërita:

– Babi, pse është kaq tmerrshëm në errësirë?

– Jo, biri im i dashur, errësira nuk është e tmerrshme, tha dhe ma shtrëngoi dorën.

– Po baba, është.

– Jo bir, nuk është mirë të mendosh kështu. Ne e dimë se ekziston Zoti. Ndihesha kaq i vetmuar, i braktisur. Ishte shumë e çuditshme se vetëm unë kisha frikë, jo babai. Nuk mendonim njësoj. Dhe e çuditshme ishte se atë që e tha babai nuk më ndihmoi, kështu që nuk duhej të kisha më frikë. As ajo që tha për Zotin nuk më ndihmoi. Edhe unë mendoj se ishte e tmerrshme. Ishte e tmerrshme që ai ishte kudo në errësirë, poshtë trenit, në shtyllat e telefonit që gjëmonin – me siguri ishte ai – kudo. Megjithatë, nuk mund ta shihje kurrë. Ecnim në heshtje. Secili mendonte për të vetën. Zemra ime tkurrej sikur errësira të kishte hyrë brenda saj dhe ka filluar ta përfaqonte. Pastaj, kur ishim në një kthesë, papritmas dëgjuam një bubullimë të madhe pas nesh! Ne u befasuam nga mendimet tona. Babi më tërhoqi poshtë argjinaturës, poshtë në humnerë, më mbajti atje. Më pas kaloi treni. Një tren i zi kaloi me shpejtësi marramendëse. Çfarë ishte ky tren. Nuk duhej të kishte tren tani. Shikuam të frikësuar njëri-tjetrin. Zjarri u ndez në lokomotivën e madhe ku hidhnim qymyr me lopata. Shkëndijat gjëmuar egërsisht nëpër natë. Ishte e tmerrshme. Shoferi qëndronte aty i zbehtë, i palëvizshëm, me tipare si të ngurtësuar, i ndriçuar nga zjarri. Babai nuk e dinte se kush ishte, vetëm shikonte përpara, sikur po shkonte brenda errësirës, e cila nuk kishte fund. I ndjekur, i gulçuar nga ankthi, unë qëndrova duke vrojtuar pamjen e egër. Imazhin e përpiu nata. Babai më mori në pistë, nxituam për në shtëpi. Më tha: – E çuditshme çfarë lloj treni ishte! Nuk e njoha shoferin.

Pastaj eci në heshtje. Unë po dridhesha i tëri. Kjo e tëra ishte bërë për mua, për dëshirën time. E mora me mend se çfarë do të thoshte. Ishte ankthi që do të vinte, tërë e panjohura, ajo për të cilën babai nuk dinte asgjë, nga e cila nuk do të mund të më mbronte. Kështu do të ishte kjo botë për mua, kjo jetë, jo si e babait, ku gjithçka ishte e sigurt dhe e njohur. Nuk ishte një botë e vërtetë, një jetë e vërtetë. Vetëm depërtonte djegshëm brenda errësirë që nuk kishte fund.

## TË DASHUR LIBRA!

Të dashur Libra! – Kështu do të doja ta filloja fjalën time në këtë Panair të Librit Shqip, 2024, këtu në Stamford, në shtetin Connecticut, në bibliotekën e madhe dhe të bukur, "Ferguson".

Të dashur lexues dhe autorë, gjithë të pranishmit, na mblodhi ky panair i vogël, i organizuar në Amerikën e madhe, prandaj dhe kuptimi i tij, vlerat janë të mëdha.

## PANAIRI NË SHTËPI, SHTËPIA NË PANAIR:

Për ne panairi filloi më përpara se të vinim këtu. Bashkë me time shoqe ishim ndanë librave në shtëpinë e një mikeshës tonë në New York, e Aidës, nga familja Balaj, e shquar për patriotizëm dhe dashuri ndaj kulturës. Pranë dritares nga ku dukej liqeni dhe porti i varkave, e gjithë faqja e murit ishte biblioteka e saj. I hapa raftet dhe e pashë, krahas librave të shumtë anglisht, kishte shumë e shumë libra shqip, klasikët tanë, At Fishta, Dom Ndre Mjeda, "Shkodra e Rrethuemë", Kadare, Orwell, bashkëkohësit, gjeta dhe nga librat e mi, "Valixhja e shqyer"... kështu është vallixhja e atij që ikën, e shqyer... dhe m'u duk sikur panairi i librit kishte hyrë në shtëpi, ndërkaq po vazhdon këtu, te kjo sallë e madhe e Bibliotekës së qytetit, te të gjitha tryezat përreth përplot me libra, shoh familjarë me fëmijë dhe them se dhe shtëpa ka ardhur në Panair.

Dhe ky është dhe qëllimi...

Ne këtu jemi autorë shqiptarë, që nuk kemi mërguar nga gjuha amë dhe gjuha është atdheu i shkrimtarit.

Ne jemi dhe lexues të librit shqip dhe libri është emocion jete, shpirt i një populli dhe kujtesë, estetika e saj, etj.

Me librin jetën tonë e mbushim edhe më, i japim dhe atë që s'e jetuam dot apo nuk e jetuam vetë, libri kështu na bën me shumë jetë të tjera, kështu thoshte dhe semiologu dhe shkrimtari Umberto Eco, ndër më të mëdhenjtë e shkullit XX.

Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-amerikanë me këtë veprimtarë, "Panairin e Librit Shqip", po kryen një akt kulturor me më rëndësi se aq, po sjell librin shqip të anëtareve të saj nga një vend i vogël dhe i përvuajtur i Ballkanit në vendin e madh dhe më të fuqishëm, në SHBA, superfuqi edhe kulturor. Ato jetët tona, që rrjedhin nga jeta e një populli, - të lashtë, do të thosha tani sipas zakonit të fjalimeve, që..., por nuk po zgjatem, - po i mbartim dhe janë derdh në kombin modern amerikan, plot dije dhe liri, pra po bashkohen me jetët e botës së madhe.

Ky bashkëveprim, do të shtoja, është dhe mirëkuptim, miqësi, mbështetje, liri më shumë, zgjerim i atdheut me dije. *Dhe dritë e diturisë* përpara do na shpjerë, thoshte Naimi ynë.

Shumë nga librat në këtë Panair a të gjithë mbase, janë shkruar në SHBA, ky është vendi i madh që ta jep këtë mundësi, sepse i çmon dhe i do dhe gjuhët e çdo diasporë këtu dhe shqipja jonë ndjehet e nderuar.

Besoj se librat këtu janë shtypur në Shqipëri dhe janë sjellë nga përtej oqeanit dhe unë shoh dhe një oqean tjetër dashurie, atë të të gjithë shqiptarëve.

Ne e duan gjuhën amë, ka që e mbiçmojnë, por unë s'mund të rri pa thënë se shqipja jonë është dhe martire, në shekujt e pushtimit ka qenë e ndaluar, poezitë tona të para janë shkruar me gjak.

Pikërisht letërsia e ktheu gjakun në bojë shkrimi, sipas Thomas Eliot, që është dhe poet amerikan.

Në Panairin e Librit Shqip 2024, në SHBA

# GJUHA – ATDHEU I SHKRIMTARIT

Nga Visar Zhiti

Në SHBA në shtetin Connecticut, në qytetin Stamford, në Bibliotekën "Ferguson" u hap Panairit i Librit Shqip,

Ishte Edicioni i tretë i tij, mbas mbas 14 vitesh nga edicioni i dytë, që u mbajt në New York në vitin 2010.

Median e shkruar dhe ato televizive njoftuan:

"Panairi i Librit Shqip në Amerikë numëroi pjesëmarrjen e mbi 30 autorëve: Visar Zhiti, Adnan Mehmeti, Mëhill Velaj, Yllka Filipi, Bexhet Asani, Daisy Elbasani, Tushe Saliaj (Rrapaj), Lufti Brami, Premisa Muca Kerthi, Erlinda Pysqyli, Demir Rusi, Rukiana Kasemi, Lela Qejvani, Suzana Vangjeli, Majlinda Pajaj, Bora Balaj, Merita Prenga, Gjon Fran Ivezaj, Gjeta Turmalaj, Sami Mulaj, Kastriot Fetahu, Selman Dervishi, Luigj Çekaj (përfaqësuar nga e bija), Nexhmedin Sylja, Azgan Berbat, Arjana Fetahu Gaba, Ramiz Mujaj, Pal Ndrecaj, Nosh Mernacaj, Sergio Bitiçi, Idriz Lamaj, Arjeta Ferlushkaj, Simon Dervishi Mani, Hamid Alaj, Age Ivezaj Gjokaj..."

Panairin do ta përshëndesnin drejtuesit e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-amerikanë, Prsidenti Adi Memeti, Kryetari Mhill Velaj, etj, përfaqësues të Bashkisë së Stamford-it, amerikani z. Aaron Miller, i cila tha: "Jemi krenarë që kemi në qytetin tonë një komunitet shqiptar kaq të suksesshëm" dhe u uroi të gjithë shkrimtarët.

Gjatë veprimtarisë u shpërndanë dhe çertifikata mirënjohje, gazetarit të palodhur të gazetës "Dielli", në New York, Dalip Greca, poetit të njohur nga Kosova, Xhevdet Bajraj, në Meksiko, të cilët nuk janë më...

Me çertifikatë mirënjohjeje u nderuan edhe tre Anëtarët e Nderit të Shoqatës, z. Visar Zhiti, Sami Repishti, Carrie Hooper, gjithashtu edhe anëtarët: dr. Bexhet Asani dhe Arjeta Ferlushkaj Kotrri,

Në panair u hap edhe një ekspozitë me piktura dhe punime dore të Ramiz Mujaj.

Në fund të veprimtarisë u mblodh këshilli i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-amerikanë dhe bëri zgjedhjet e reja: Kryetare u zgjodh Dr. Yllka Filipi, Nën/kryetare: Arjeta Ferlushkaj dhe Sekretar: Bexhet Asani

Ky panair, u mor vendimi, që të bëhet një traditë, të hapen në çdo tre vjet..

Nga SHSHSHA

Po a mund ta rikthejmë të shkruarit dhe në gjak të jetës?

Po të flasim për panairin tonë. Jemi së bashku, një pjesë jona, aq sa mundej, autorë dhe lexues dhe libra, edhe të atyre që s'janë, që s'vinin dot, miq tanët dhe unë prapë s'mund të rri pa kujtuar që vijmë nga një vend dhe një kohë që dënonte autorë, libra dhe lexues, përndiqeshim dhe nga ata që kishim pranë dhe kjo, e projektuar në realizëm socialist, në entuziazëm absurd, shpesh ishte vepra e tyre më e arrirë. Edhe ata kanë mbërritur deri këtu...

I them këto se ndjej dhe shoh përreth dhe përballë praninë e autorëve të rinj, ata shkruajnë dhe në anglisht, forcë e aftësive të tyre dhe i tërheq po aq dhe i përkushtohen dhe gjuhës amë.

Dhe në gjuhë janë dhe dashuria dhe vuajtja, edhe humbjet, që vetëm gjuha, edhe

ajo e brendshme, i kthen në përvojë dhe në poezi, dua të them në letërsi.

## THEMELTARËT DHE VAZHDIME:

Të rinj ishin këtu dhe Imzot Fan Noli dhe Faik Konica- "biblioteka lëvizëse" sipas Apollinaire, që themeluan "Vatrën" e përbashkët të shqiptarëve dhe "Diellin"-gazetë të saj, ata me bashkëpunëtorë krijuan këtu një qeveri në mërgim, kur s'kishte një të tillë në Shqipërinë që ende nuk ishte pavarësuar dhe i dhanë letrave të çoroditura shqipe vepra të pavdekshme.

Motrat e famshme Qiriazi, mësuese të dritës, që do të kërkonte t'i shqyente me kthetra errësira...

Kur atje pas Luftës II Botërore po vendosej një diktaturë gjakatare, erdhën

këtu për të vazhduar përpjekjet për atdhe shumë shqiptarë, edhe nga kërret kryesorë, si shkrimtarët Mit'hat Frashëri, - bir i Abdylit të "Lidhjes së Prizrenit" dhe nip i Naimit, Mustafa Kruja, - gjuhëtar dhe stilist i historisë, por edhe kryeministër, shkrimtari e filozofi Isuf Luzaj, - mik dhe me Jorge Luis Borges, Baba Rexhepi, - mistik shpirtëror i fuqishëm, për të cilin janë shkruar libra, historiani Ago Agaj, antropolog luftëtar, por dhe Abaz kupi, - luftëtar i parë i rezistencës me armë në Europë kundër fashizmit... dhe do të vazhdonin me komunizmin...

Kur në atdhe burgoseshin dhe pushkatoheshin poetë, do të arratiseshin për këtej pas burgut poeti e filozofi Arshi Pipa, duke marrë me vete dhe sonetet infernale, humanisti e studiuesi sorbonas Sami Repishti, nga internimet dhe përndjekja do të vinte dhe poeti i dufit çam, Bilal Xhaferri e deri te poeti Gjokë Marinaj, që kërcënohej me burg edhe për një metaforë; ky i fundit do të ishte dhe Kryetari i parë i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-amerikanë, themelues.

Ata mbeten përherë të rinj me idetë e tyre për një Shqipëri të lirë, të hapur, euroatlantike, duke ikur ata kishin atdheun me vete, pra veç e zgjeruan...

Për ata, Konicën dhe Nolin, etj, po tregon shkëlqyer duke e sjellë përvojën e tyre si përvojë të kombit, historiani Ilir Ikononi, që erdhi këtej pas rënies së perandorisë komuniste dhe punoi në "Zërin e Amerikës", zëri që i flet gjithmonë pranë Shqipërisë duke i treguar dhe rrugët e lirisë dhe të demokracisë, ku ishte në drejtim dhe gazetari i shquar, familjemërguari Elez Biberaj.

Enciklopedinë e shqiptarëve të Amerikës na e ka dhënë në një vepër madhore z. Vehbi Bajrami, ndërkohë dhe botues i gazetës së mirenjohur "Illyria".

Këtej erdhën dhe shkrimtarët si Naum Prifti, Betim Muço, që s'janë më midis nesh, poeti Roland Gjoza, gjuhëtar dhe shkrimtari Ardian Vehbiu, drejtor dhe i revistës kulturore elitare, me shumë rëndësi për estetikën e mendimit sot, "Peizazhet e Fjalës".

Këtej kam dhe bashkëvuajtës të mi, që kanë ardhur në Amerikë, te ëndrra, që me punë kanë arritur atë mirëqenien, që s'do të mundnin kurrë në vend tjetër, por mbi të gjitha këtu kanë prekur atë liri të vërtetë dhe demokracia është dhe realitet i tyre...

Një pjesë e bashkëvuajtësve të mi shkruajnë, është këtu libri me poezi, postume i Luigj Çekajt, me titullin kuptimplotë, që ka shtegtimin si të vetë panairit, "Një shkrelas në Manhattan", po a kanë mbërritur poezia e Pëllumb Lamajt, e Ilir Spatës, etj, etj.

Unë kam shkruar për një liber tjetër me poezi, të Artan Kafexhiut, që është dhe këtu.



Poezia dhe mërgimi kanë të përbashkët një lloj mallëngjimi, kanë ikjen si një kthim dhe kthimin si një tjetër ikje...

Po miqtë e mi, Dine Dine e Hasan Bajo, që shkruajnë prozën e gjatë? Memuaristikë kanë botuar dhe Kaso Hoxha, Muharrem Xhutollari, Memisha Gjonzeneli, persiatje nga aktualiteti nxjerrin shpesh Lekë Mirakaj, Ilirjan Blloshmit, etj.

Po hulumtimet dhe studimet e veçanta të Ing. Mërgim Korça, a jan: e këtu? Vëllai i tij, Genci, ka shkruar në anglisht memuaristikë tronditëse. Janë djemtë e Xhevat Korçës, studiues dhe ministër i arsimit, që vdiq me të parën grevë urie në burgun e Burrelit. Luftoi dhe me vdekjen e tij vdekjen...

Dua të kujtoj Makensen Bungo që na ka dhënë romanin "Kënetë e vdekjes", vuajtjet e tmerrshme të të burgosurve dhe të vetes, një sfidë dhe ndaj "Kënetës" së realizmit socialist...

Nga kujtesa dramatike ka tërhequr vëmendjen sot me tregimet e tij Muç Xhepa, me ato realitetet e tij të përziara shqiptare dhe amerikane, po kështu dhe Sami Milloshi me prozën e shkurtër, ndërsa në Kanada vazhdon të përmbushë veprën e tij shkrimtari Faruk Myrtaj. Ndjek mendimin kritik të Minella Aleksit. Gëzim Bashës.

Takoj Kastriot Fetahun, njihemi që në Çikago, edhe të tjerë, janë emrat e tyre në gazette...

Në Amerikë ka shkruar dhe Lazër Radi, i dalë nga burgjet dhe internimet, vinte si visitor, po në Amerikë ka ardhur dhe shkrimtari Ernest Koliqi, i dënuar me vdekje në atdhe nga diktatura, ai themeloi Katedrën e Albalogjisë në Romë, ndërsa romani i tij i vetëm, "Shija e bukë së mbrumë" personazhet i ka shqiptaro-amerikanë dhe ngjarjet zhvillohen në Amerikë.

Është në Universitetin Ann Arbor në Miçigan pedagogu Lisandri Kola, poet dhe studiues i shkëlqyer, që ka arritur vetë të krijojë dhe të japë lëndën e Letërsisë shqipe në mërgim në katedrën ku punoi dhe poeti nobelist, kundërshtar i sovjetëve, ruso-hebreu Josip Brodsky. Iku, e pëzunë pas burgut...

Të kthehemi te librat e Panairit. Z. Mhill Velaj, që sot ka ditën e fundit si kryetar, shkon tryezë më tryezë dhe shpjegon për autorët dhe librat për kamerat e televizionit.

E pse të mos tregoj dhe unë që një përmbledhje timen me poezi "Si shkohet në Kosovë", ia kam dhënë këtu në SHBA, në Çikago në një takim me të, kryeministrit të Kosovës, z. Albin Kurti

Po vite më parë, më thotë një shqiptar se këtë libër ia kam pas dhuruar me autograf dhe vëllait të tij në një takim letrar vite më parë në rrethina e Çikagos, pikërisht atij, që la me testament pasurinë e tij për t'u ngritur katedra e albanologjisë në Universitetin DePaul. Unë nuk e mbaj mend, por rëndësi ka, që pikërisht mes atyre njerëzve, që bëjnë një jetë të pabujë, mbase dhe spartane, fshihen akte kulturore me rëndësi kombëtare, të ndjeshme dhe në SHBA.

Ka vërtet një testament të madh shpirtëror i gjeneratave të mëparshme këtu, që do atë dashuri e përgjegjësi të bukur, sakrificë e talent për të arritur lartësinë e tyre, që na mësojnë si shkohet tek e mira, që ta duam vazhdimisht dhe pa kushte atdheun.

Duajë atdheun dhe kur të vret, ua la porosi fëmijëve te tij shkrimtari Mitrush Kuteli. Mos pyet ç'bën atdheu për ty, pot ti ç'bën për atdheun, na mëson Presidenti Xhon Kenedi.

Si një atdhe të vogël shqiptarët këtu kishin "Vatrën" e tyre shekullore, duhet mbajtur. Na dhimbet çdo çarje e saj si çarje plage. Zjarri i Vatrës do të duhej dhe në kohët më moderne...

## VËSHTRIMI I GRUAS NË PANAIR

Këtëj erdhi dhe vajza e Stalin si kundërshtarë e të atit, - thashë me vete, - afër ku unë jam. Më afër kam shtëpinë e fëminisë së Heminguejtit, - po thoshim, - dhe sa i donte gratë ai... por, që të shijojnë në pleqëri të mirat e kapitalizmit, e kush s'ka ardhur, nga Shqipëria, e kam fjalën, edhe heronj, edhe t: e panjohur, edhe komandantë burgjesh, që mbanin brenda telave me gjemba të dënuar që donin të arratiseshin për në Amerikë, edhe artistë, letërnxirës të Realizmit Socialist, që tani të nxijnë letrat e realizmit demokratik, bashkë, paqja qoftë me ne, - lutet ime shoqe! Që të bëhemi si Amerika apo me gjakimin donkishotesk, të bëjmë amerikanët si veten? - pyes unë, jo pa ironi.

Letërsia s'duhet të ketë mure si ai i SHBA me Meksikën, le të vazhdojë të na futë pa doganë në faqet e veta...

Në këtë panair edhe unë kam sjellë romanin tim, "Këpuca e aktorit", i shkruar në SHBA - metaforë e ecjes së vështirë në skenat e jetës, ka dashuri dhe grua, - më thonë.

Po ne kemi të ekspozuar dhe libra të tjerë, edhe "Dita e Shenjtes Nënë Tereza" i Edës time, botuar në Vatikan, edhe "Për atë që dua(m)" i Atjonit", që Eda ia ka dhuruar dhe Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, si një nënë një nënë, si zonja zonjës...

Afrohem te grupi i zonjave në panair, ku është dhe ime shoqe, u pëlqejnë kostumet kombëtare, pozojnë me to si të "veshuna me diell, mbathun me hanë", prin Eva Dori me "Bijtë e shqipes", nënkuptohen dhe bijat patjetër, ja dhe shkrimtaret Yllka Filipi dhe Arjeta Ferlushkaj, Majlinda Pajaj, Suzana Vangjeli, Arjana Gabaj etj, po mikja jonë Ilirjana Sulkuqi, ku është, s'është kthyer nga Shqipëria?

Po këtu ka ardhur dhe një poete koreano-jogore, tashmë amerikane, Tonia (HounHye) Ko Hung, mike me poetët shqiptarë, ajo ka dhe një libër të përkthyer në shqip.

Unë pëlqej shumë shkrimet e Profesoresh Eda Dehremi, kanë forcë të bukur gruajë. Dhe statutet e psikologes Silvana Kola-Loka. Flas për ç'njoh këtëj përreth.

Në Tiranë Ambasada Amerikane jepte një çmim për gratë e shquara me emrin e shkrimatresh së persekutuar, disidentes së parë grua në perandorinë komuniste, "Musine Kokalari". Studiuesja shqiptare në Angli, Nashi Brooker, sa shumë i është përkushtuar asaj, shkëmbejme letra me të...

Poezia e zonjave i ka dhënë qumësht Rozafë poezisë shqipe, them unë.

Po Nënë Tereza - është poete dhe Ajo me lutjet e saj. Dhe m'u ndërmend që kështu quhet dhe Qendra kulturore shqiptare në Miçigan. Shkruan për Shenjten tonë dhe Prefosorja në universitetet amerikane, Ines Murzaku.

Kujtoj emra të tjerë shoqatash e institutesh e akademish e bibliotekash dhe më duket sikur i sintetizon emri prekës i organizatës së Dr. Sonila Sejdaras, "Care for Albania", ngjan me "Medicare", aq e njohur në SHBA. Kujdesi për shëndetin, Kujdesi për Shqipërinë.

Edhe nëpërmjet librit. Është e rëndësishme sa të gjitha dhe më e bukura.

Prandaj është dhe Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro Amerikanë. Drejtimi këtë radhë do t'u besohej zonjave

Janë tre volume këtu në panair që përmbledhin jetën dhe bëmat dhe veprat e anëtarëve-shkrimtarë të grupimit të tyre, që nga themelimi, i ka qëmtuar me pasion Presidenti i tyre, Adnan Mehmeti. Ja, dhe revista "Pena" e SHSHSHA...

Ky panair na përcjell gjallërueshëm, po aq dhe lavdishëm, të shkuarën që është dhe e tashme, që do të donim që kjo e tashme të ishte dhe pjesë e së ardhmes. Patjetër, kur është kujtesë dhe Kulturë dhe krijimtari patjetër.

Në intervistën e parë televizive që nga sulmi, shkrimtari tregon sesi agresori ishte "gjëja e fundit që syri im i djathtë do të shihte ndonjëherë"

## "TI PRA QENKE! JA, JE KËTU!": SALMAN RUSHDIE PËRSH-KRUIAN ÇASTIN E SULMIT

Nga Ella Creamer

Salman Rushdie ka thënë se mendimi i parë teksa shihte burrin që do ta sulmonte në Skenë në gusht të 2022 ishte: "Ti pra qenke! Ja, je këtu."

"Dukej si diçka që po vinte nga një e shkuar e largët dhe përpiquej të më kthente pas në kohë, madje po deshe, pas në të shkuarën e largët, e kështu, të më vriste" tha britaniko-amerikani i lindur në Indi, autor i librave si "Vargjet Satanike" dhe "Fëmijët e Mesnatës".

Ai po përgatitej për një bashkëbisedim në Institutin Chatauqua të New York-ut më 12 gusht 2022 kur një burrë vrapoi në skenë dhe e theri rreth dhjetë herë.

"Isha ulur në skenë," - tha Rushdie, duke lexuar nga memuari i tij rreth sulmit, titulluar "Knife: Meditations Afer an Attempted Murder" (*Thikë: Meditime pas një vrasjeje në tentativë*) - "Kur me cepin e syrit të djathtë, gjëja e fundit që ai sy do të shihte ndonjëherë, pashë një burrë me të zeza duke vrapuar drejt meje poshtë në anën e djathtë të ulëseve. Me rroba dhe një maskë të zezë. Po më vinte përballë, i vendosur dhe pa zë. Tamam porsirakatet tokësore.

Të them të vërtetën, e kisha imagjinuar vrasësin tim të ngrihej nga publiku ose nga njerëzit përballë dhe të nxitonte nga unë në këtë mënyrë. Kështu, kur pashë këtë trajtë vrasare të vraponte drejt meje, mendimi im i parë ishte "Ti pra qenke! Ja, je këtu"

Pas sulmit, Rushdie qendroi për gjashtë javë në spital. Ai humbi shikimin në njërin sy dhe aftësinë për të ndjerë në disa prej gishtave të tij. "Një nga kirurgët që më shpëtoi jetën më tha 'Më së pari ishte shumë pafat dhe shumë me fat.'" I thashë "Cila është pjesa e fatit?" dhe ai më tha "Epo, pjesa e fatit është se ai që të sulmoi as që ia kishte idenë si vritet dikush me thikë." i tha ai Anderson Cooper-it në emisionin *60 Minutes* në CBS, gjatë daljes së parë televizive pas sulmit.

Sulmi ndodhi 33 vjet pasi lideri i Iranit në atëkohë, Ajatollah Ruhollah Khomeini lëshoi një fatva për vrasjen e Rushdie-s si përgjigje e botimit të "Vargjet Satanike" e cila ishte parë is blasfemi.

Hadi Matar, agresori i dyshuar, u shpall i pafajshëm për akuzat e tentativës së gradës së dytë për vrasje si dhe plagosje e gradës së dytë dhe mbahet në paraburgim që pas arrestimit, menjëherë pas sulmit.

Në janar, gjyqi i tij u shty për shkak të memuarit që do të botohej, i cili doli të martën. Një avokat që përfaqëson Matar-in tha se donin të shihnin memuarin dhe ndonjë material që mund të kishte lidhje, para se klienti i tij të dilte në gjyq.

Në qershorin e shkuar, Rushdie tha se po punonte me memuarin në një dalje të pararegjistruar në Zoom gjatë festivalit Hay. *Knife*, botuar nga *Penguin*, ka 224 faqe dhe është libri i parë që Rushdie ka shkruar qysh nga sulmi. "Ishte e domosdoshme për mua që ta shkruaja këtë libër: Një mënyrë për t'u marrë përgjegjësi rreth asaj që ndodhi dhe për t'u përgjigjur dhunës me art", tha ai.

Në 2012, ai botoi një memuar tjetër rreth periudhës së fshehtë pas botimit të "Vargjet Satanike" me titull "Joseph Anton".

Rushdie ka shkruar 15 romane dhe shumë vepra të tjera *non-fiction*. Ka qenë pesë herë në listën e ngushtë për Booker Prize, çmim të cilin e fitoi më 1981 me "Fëmijët e mesnatës". Libri, po ashtu, fitoi edhe Booker of Bookers në 1994 dhe Best of the Booker në 2008, duke shenjuar 25 dhe 40 vjetoret e çmimeve.

Përktheu A. Dushi



# NOSTALGJI PËR VDEKJEN E G. G. MÁRQUEZ-IT

Nga Fernando Ramos

Në përvjetorin e García Márquez-it, kujtojmë se si atij i pëlqente gjithmonë të njihet dhe të kujtohej si djali i telegrafistit nga Aracataca, gjë që zbulon një pjesë të karakterit, përunjësisë dhe madhështisë së tij.

Prindërit, Gabriel Eligio García dhe, Luisa Santiaga Márquez, e lanë që në moshë shumë të vogël nën kujdesin e gjyshit, kolonelit Nicolás Márquez dhe gruas së tij Tranquilina Iguarán. Veterani i luftës ishte një nga të parët që zgjoi në Gabo pasionin për tregimet, gazetarinë dhe letërsinë. Doña Tranquilina Iguarán kishte probleme me shikimin, por historitë, fabulat dhe legjendat e mrekullueshme që i tregoi nipit, shumë prej tyre imagjinare, frymëzuan disa nga veprat e autorit më universal kolumbian.

Fëmijëria e Gabriel García Márquez-it kaloi në bregun verior, në Karaiben kolumbiane, mes nevojave të një familjeje me të ardhura të pakëta që bëri gjithë çka ishte e mundur për t'i siguruar atij një arsimim të mirë. Nga ato toka festive e të nxehta plot hijeshi tropikale, falë një burse, ai vazhdoi studimet në vitin 1940 në qytetin e ftohtë të Andeve, Zipaquirá, në qendër të vendit.

Në vitin 1947, erdhi në Bogota për të studiuar Drejtësi në Universitetin Kombëtar. Qe ajo koha kur Gabo botoi tregimin e tij të parë në gazetën *El Espectador*: "Dorëheqja e tretë". Aty do të fillonte karrierën si reporter, pa dyshim një nga më të mirët në historinë e Kolumbisë. Ai nuk u diplomua kurrë si jurist; më pas filloi si kolumnist në gazetën *El Universal* të Kartagjenës.

Qe e njëjta kohë kur Gabriel García Márquez-i takoi disa nga ata që do të bëheshin miqtë e tij më të mirë, në të ashtuquajturin Grupi Barranquilla. Ata ishin gllabërues të rinj të letërsisë, asaj klasike e së resë, që takoheshin për të

folur rreth asaj çka më së shumti pëlqenin: Librat.

Jetuan në diskutime të pashtershme rreth veprës së William Faulkner-it, Virginia Woolf-it dhe Albert Camus, mes sa e sa të tjerëve, në një bar të quajtur *La Cueva*, i cili ekziston ende në Barranquilla. Ajo periudhë do ta shenjonte edhe si dashnor bohem të muzikës së mirë, vizitor të shpeshtë të klubeve të lagjeve dhe hoteleve me pak yje. Shumë nga këto vende janë referenca të zakonshme në veprën e tij letrare.

Pas një dekade, në fillim të vitit 1950, filloi të shkruante romanin e tij të parë, i cili në krye të krye të titullua *La Casa* dhe më vonë e ndryshoi titullin në *La Hojarasca*. Të gjitha të frymëzuara nga vendlindja e tij Aracataca, e cila pak nga pak po kthehej në Macondo.

Por Gabo me të vërtetë e arriti kulmin në vitin 1967 me *Njëqind vjet vetmi*, kryevepra e tij e përkthyer në 50 gjuhë dhe e shitur në më shumë se 50 milionë kopje. Në vitin 2007, gjatë një vlerësimi nga Akademia Mbretërore e Gjuhës Spanjolle, García Márquez-i lexoi paragrafin e parë të romanit dhe tregoi një anekdotë se si e shkroi atë.

"Shumë vjet më vonë, përballë togës së pushkatimit, kolonel Aureliano Buendía-s do t'i kujtohej ajo pasdite e largët kur i ati e çoi të shihte akullin. Nuk e kisha idenë për kuptimin dhe origjinën e asaj fraze ose se ku duhet të më çonte. Çfarë di sot është se nuk ndalova së shkruari asnjë ditë të vetme për 18 ditë derisa mbarova librin."

Romancieri, gazetari dhe krijuesi i lëvizjes letrare të njohur si realizmi magjik, udhëtoi nëpër botë dhe mësoi për shumë kultura, çka shërbeu si limfë shkrimeve të tij me histori të mrekullueshme.

Duke iu referuar një prej kryeveprave të García Márquez-it, ish-presidenti Álvaro Uribe tha se "rrëfimi i ngjarjeve

historike, zakoneve dhe përshkrimi i mënyrës sonë të të qenit mori një përmasë epike në *Njëqind vjet vetmi*. Vepra e García Márquez lindi sepse 'aty është populli i madh i Kolumbisë që frymëzoi krijimin e saj.'"

Gabo ishte mik i shumë njerëzve të fuqishëm, ama e urrente pushtetin. Marrëdhënia e tij e ngushtë me udhëheqësin kuban Fidel Castro i solli shumë kritika. Por ai ishte i afërt edhe me presidentët e 6 dekadave të fundit në Kolumbi, me ish-presidentët e Shteteve të Bashkuara dhe Amerikës Latine, me mbretër dhe biznesmenë. Veçanërisht, ishte mik i kolegëve të tij romancierë. Binte në sy afërsia me meksikanin Carlos Fuentes dhe gjithashtu mosmarrëveshjet me shkrimtarin peruan Mario Vargas Llosa, të cilat kurrë nuk depërtuan edhe në nivel letrar.

Mbreti Juan Carlos i Spanjës tha për Gabo-n se "ai është në vetvete, në karrierën e tij krijuese, një shembull i gjallë i unitetit të spanjishtes në diversitetin e saj. Një nga figurat më të shquara të letërsisë spanjolle. Të tija janë këto fjalë: 'Le të mos flasim më veçmas për letërsinë latino-amerikane dhe veçmas për atë letërsinë spanjolle. Thjesht letërsi në spanjisht.'"

Gabos i pëlqente muzika vallenato, të cilën e shijonte në festa të paharrueshme sa herë që kthehej në Kolumbi. Aty ku nuk i pëlqente vërtet të kthehej ishte Aracataca, qyteti i tij. Ndoshta për shkak të nostalgjisë që i shkaktonin kujtimet e fëmijërisë. Po ashtu, kishte gjithmonë një vend të veçantë për vendin e vet, megjithëse e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Meksikë.

"Këto ditë kam menduar një gjë, do të doja që Kolumbia të ishte një vend tjetër: Kolumbia që është sot pa të këqijat e saja." tha ai më 1992.


Gabriel García Márquez jepte pak intervista. Në vitin 2004 botoi veprën e tij të fundit, *Kujtim kurvash të trishta*. Pështja e viteve dhe sëmundjet tipike të moshës e penguan të vazhdonte të botonte romane. Megjithatë, janë të shumta shkrimet e tij të pabotuara që i mbante me vete shoqëruësja dhe bashkëpunëtorja e përjetshme, Mercedes Barcha, bashkëshortja që e shoqëronte përherë në të gjitha vendet e botës që vizitonte. Që e njohu në mungesë dhe në lavdi. Dhe që i ishte pranë deri në ditët e fundit si një tjetër protagoniste e romaneve të tij. Gjashtë vjet më vonë, më 15 gusht 2020, Mercedesi i tij i dashur vdiq në moshën 87-vjeçare në Mexico City.

Më 6 mars, si pjesë e homazhe për dhjetëvjetorin e vdekjes, u botua *post mortum* romani i tij *Shihemi në gusht*. Një veprë që fituesi i çmimit Nobel në Letërsi nuk e mbaroi kurrë dhe që sipas djalit të tij Rodrigo García "nuk është aq i lëmuar sa kryeveprat e tij". Por është një mënyrë për ta mbajtur gjallë kujtimin e një prej shkrimtarëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave.



# DHJETË VJET VETMI: BOTA LETRARE NJË DEKADË PA G. G. MARQUEZ

Nga Livia Iannotta



Akoma dhe sot, dhjetë vjet pas vdekjes së shkrimtarit Gabriel García Márquez, laureat i Çmimit Nobel për Letërsinë në 1982, veprat e tij, klasike të përjetshme, vazhdojnë të na kujtojnë se Karaibet, Kolumbia dhe në njëfarë mënyre e gjithë bota jonë janë korniza magjike që përtej sipërfaqes bartin dimensione të tjera, jo më pak të jashtëzakonshme, që pa shkrimtarë si Márquez-i rrezikojnë të mbeten të fshehura.

Kur mendoj për Gabriel García Márquez-in, më vjen në mendje muzgu i një oborri. Një nga ato oborret e brendshme të rrethuar nga ndërtesa me aromë koloniale, i zburuar me hamak, ndenjese kashte, pemë dhe shtretër lulesh, ku mund të gjesh kollaj shpëtim nga vapa mbytëse e Karaibeve.

Kjo bashkëjetesë e diellit dhe e hijes te Gabo ekziston me të vërtetë te ai dhe mund të shihet në mënyrën e tij të krijimit; në historitë që kanë ushqyer imagjinatën e brezave të Amerikës Latine dhe më pas të të gjithë botës. Duket sikur në atmosferën tipike tropikale të librave të tij fshiheshin demonët e lashtë dhe vetë melankolia.

Pra, nëse pyes veten për arsien pse Márquez është në krye të shkrimtarëve të mi të zemrës, përgjigjem se ka të bëjë, por vetëm pjesërisht, me bukurinë e fletës: ajo gjuhë e harlisur ku mu rrit dëshira për intimitet mes meje dhe fjalëve. Dhe pastaj, sigurisht ka të bëjë me imazhet: Rebeka duke mbërritur në Buendía me eshtrat e prindërve të saj në një thes; aroma e bajameve të hidhura; koloneli që ka pesëmbëdhjetë vjet që pret pensionin në postë çdo mëngjes; Sierva Maria e kafshuar nga një qen i tërbuar; një dashuri e paprekur që mbijetoi "pesëdhjetë e një vjet, nëntë muaj e katër ditë".

Megjithatë, dy arsyeve të para duhet t'u shtoj edhe një të tretë, të lidhur me muzgun për të cilën po flisja: është një shtresë e hollë hidhërimi që mbështjell vendet; parandjenja gjatë përditshmërisë së fundi po afron, vetmitë e njerëzve, pamundësia që të lidhesh me të tjerët.

"Besoj se e gjithë jeta dhe letërsia ime kanë shërbyer për t'iu përgjigjur një pyetjeje të vetme: çfarë është vetmia? (...) E vërteta është se nëse do të mund ta deshifroja, ndoshta nuk do të shkruaja më."

Ndoshta për këtë arsye shkrimet e tija janë magjepsëse. Të lidhura ngushtë me të kaluarën, me komplotet e vendeve mitike, me gjenealogjitë që në çaste kyçe të kohës tregojnë ritet dhe folklorin e një populli. Ruajtja e kujtesës është qëllimi pas çdo rreshti të romaneve të tij. Aq sa në autobiografinë e vet *Jeto për ta treguar* ai shkron aq larg sa thotë se "Jeta nuk është ajo që ke jetuar, është ajo që të kujtohet dhe ashtu siç të kujtohet për ta rrëfyer."

Në këtë mënyrë Aracataca, një qytet në Kolumbinë Atlantike ku Márquez-i lindi më 6 mars 1927, i pari nga

gjashtëmbëdhjetë fëmijët e telegrafistit Gabriel Eligio García dhe largpamëses Luisa Márquez Iguarán, përfundon duke u rishfaqur në Macondo, fshati që nuk ekziston, sfondi i *Njëqind vjet vetmi* dhe që më pas, duke dalë nga imagjinata, bëhet territor i shpirtit, gjeografi fantastike e njeriut, një qytet-botë.

Kështu, dita në të cilën gjyshi i tij, koloneli liberal Nicolás Ricardo Márquez Mejía, e shoqëron atë në fabrikën e një kompanie shumëkombëshe për të mësuar rreth akullit, jehon në fillimin e paharrueshëm të *Njëqind vjet vetmi*.

Dhe mbi të gjitha, historitë, besimet, besëtytnitë me të cilat gjyshja Tranquilina – gjithmonë e veshur në zi dhe në kontakt të pandërprerë me të vdekurit - rrëfente fëmijërinë e saj, dalin nga streha e kujtesës për të banuar ndër faqet e librave më të dashur: nga *Dashuria në kohërat e kolerës* te *Vjeshta e patriarkut*, nga *Gjethurinat te Për dashurinë dhe demonët të tjerë*, nga *Kujtim kurvash të trishta*, deri te *Shihemi në gusht*.

Fituesi i çmimit Nobel për letërsinë në vitin 1982, Márquez-i na kujtoi se Karaibet, Kolumbia dhe në një farë mënyre e gjithë bota janë plot magji; se përtej sipërfaqes së gjërave ka edhe të tjera, jo më pak të jashtëzakonshme, që kanë mbetur të fshehura.

Për të, të shkruarit ishte edhe një akt politik. Në vitin 1973, kur demokracia kiliane u shtyp nga grushti i shtetit i Pinochet-it, ai deklaroi se nuk do të shkruante më derisa të binte diktatura. Pinochet-i e mbajti pushtetin për njëzet vjet. Márquez, për fat të mirë, iu kthye shkrimit shumë më herët. Në një intervistë në vitin 1987 ai rrëfeu:

Jeta e një shkrimtari është po ashtu e mbushur me beteja të humbura; unë e humba timen. Arrita në përfundimin se do të bëja më shumë kundër Pinochet-it duke shkruar libra të mirë sesa duke mos i shkruar. Ia kisha nënshtruar veten, pa e kuptuar, censurës së tij parandaluese që më la në heshtje për gati pesë vjet

Edhe pse, në fund të fundit, ideologjia e tij e vërtetë mbetej dashuria, e perceptuar si një ndjenjë përbashkuese, që prek gjithçka, përmbyset gjithçka dhe, po, revolucionarizon gjithçka.

Dhjetë vjet më parë, në Mexico City, në shtëpinë ku ai jetonte me të shoqen Mercedes, që e imagjinoj si të ishte ndërtuar përreth një prej atyre oborreve të qeta që përmenda që në krye, vdiq Gabriel García Márquez. Në të njëjtën intervistë të vitit 1987, kur gazetari e pyet nëse ka frikë nga vdekja, Márquez përgjigjet: "Nga vdekja jo, nga të vdekurit po. Më shqetëson, si shkrimtar, që ngjarja më e rëndësishme në jetën time, vdekja, është e vetmja për të cilën nuk do të mund të shkruaj kurrë." Çfarë magjie e pabesueshme do të ishte të lexoje për të.

## Dhjetë vjet pas vdekjes së Gabriel García Márquez, lulet e verdha mbulojnë shtëpinë e tij

(Shënime për përkujtimin e  
Gabos në vendin e tij)

Lulet e verdha, aq të pranishme në veprën dhe jetën Le nobelistit kolumbian Gabriel García Márquez, i dhanë ngjyrë këtë të mërkurë atmosferës në shtëpinë e tij në Mexico City.

Në heshtje, pothuajse shpirtëror si ndonjë personazh i dalë nga veprat e të atit, Rodrigo García Barcha, djali i madh i patriarkut të letërsisë kolumbiane, mbërriti pak para orës 10 të mëngjesit në shtëpi në Jardines del Pedregal, në jug të kryeqytetit meksikan, ku disa të afërm të familjes kujtuan maestron.

Menjëherë pas kësaj, shoferi i Gabos, Genovevo Quiroz doli nga kamioni me një buqetë me lule të verdha, të parapëlqyerat e romancierit më të madh të gjuhës spanjolle të shekullit XX.

Quiroz është një njeri i matur, bashkëpunëtor i García Márquez-it në vitet e fundit të jetës së tij. Si shofer e çonte në takime, homazhe dhe në spital, kur maestroja kishte probleme shëndetësore.

"Atij i pëlqente të dëgjonte vallenato, e luante në radio kur ishim në makinë", tha meksikani në një deklaratë të shkurtër për EFE.

Nuk është rastësi fakti se një nga kujtimet e njerëzve të afërt me Gabos lidhet me muzikën. Dhjetë vjet pas largimit të tij, tregimtari dhe kolumnisti po ashtu i klasit të parë mbahet mend si zëri kryesor i një kori pothuajse fetar: atij të bumit të Amerikës Latine.

Proza poetike e autorit të "Dashuria në kohërat e kolerës" ishte muzikore, diçka e logjikshme, sepse në të rinjtë e tyre, e ëma, Luisa Santiaga, studioonte piano dhe i ati, Gabriel Eligio, ishte një violinist pa ndonjë talent të madh.

"Nuk ka lumturi më të pastër se lumturia e të kënduarit," tha García Márquez-i në hyrjen e një albumi të kantautorit kuban Pablo Milanés duke e përmbledhur në një fjali lidhjen e tij me muzikën.

E dalluar nga proza poetike, vepra e García Márquez-it ka muzikë, diçka e njohur nga studiuesit, kolegët dhe lexuesit e tij.

Ku është Macondo?

"Kur lexova 'Njëqind vjet vetmi', diçka po këndonte gjatë gjithë kohës. Macondo u bë një paradigmë për shumë qytete të Amerikës Latine. Sa më thellë futeni në Kubë, Meksikë apo Argjentinë, gjeni një vend të bllokuar në kohë," tha për EFE Cristian Lagunas, një nga shkrimtarët e rinj më të shquar në Meksikë, i njohur me veprën e García Márquez-it.

Në fillim të veprës, Macondo është një vend me 20 shtëpi me baltë dhe kallamishte të ndërtuara në brigjet e një lumi me ujëra të pastër që vërshojnë nëpër një shtrat gurësh të lëmuar, të bardhë dhe të mëdhenj si vezë prehistorike. Më pas është diçka tjetër, një faqe e lëvizshme, gjeografia e të cilit varet nga imagjinata e lexuesit.

"Në Amerikën Latine, rajoni nuk ka qenë më i njëjtë që kur García Márquez-i krijoi komunitetin e Macondo-s," tha Gerald Martin, biografi i García Márquez-it, duke përmbledhur madhësitë e çmimit Nobel të vitit 1982, pasi shkroi "Njëqind vjet vetmi", romani më i fuqishëm në gjuhën spanjolle pas "Don Kishotit".

Macondo-ja mund të gjendet në Meksikë me historinë e "La Llorona" që u bërtet për fëmijët e saj, pranë qytetit kuban të Matanzas, ku një plakë e mbytur në një përrua u shfaqet shoferëve të autobusit; në Santo Domingo me "La Ciguapa": një grua që magjeps burrat; ose vetë në Kolumbi me legjendën e "El dorado-s".

Me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes së romancierit, Fondacioni i krijuar prej tij njoftoi se po përgatit disa veprimtari për të festuar njëqindvjetorin e maestros në 2027, ndërsa Netflix bëri me dije se do të transmetojë një serial të bazuar në romanin më të famshëm të autorit, "Njëqind vjet vetmi".

An oil painting of a landscape. The top half shows a range of mountains with soft, blended colors of pink, purple, and blue. Below the mountains is a wide valley with rolling hills in shades of yellow, green, and blue. In the foreground, there are dark, textured brushstrokes in green and brown, suggesting a field or a path. The overall style is expressive and atmospheric.

NASILERA

vit pa pranverë

OnufriRoman